

Revistë edukative-kulturore

ETIKA

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den
Europa: 2 Euro

Mars 2010 • Numri: 24 • E përmuajshme



Një ditë pa mëkate

EDITORIAL

*T*ë zhytesh në pellgun e hirit bashkë me ujët e zymtë, është si të kesh para vetes një fletë të nxirë po nga ky hi!

Por të notosh në një ujë që pastrohet rregullisht me paisje filtruese, ndoshta veç një fletë do të lagej, ndërsa ngjyra e saj do të mbetet origjinale...

Por të thellohesh çdo ditë në shtratin e thellësirave edhe po ta ndrydhësh një letër për të mos marrë ngjyrë nga kjo papastërti, do të duhej një dorë e fuqishme!

Të jetosh çdo ditë dhe të thithësh të njëjtin ajër, të vishesh me petkat e zymtë ngjyrë hiri, që nuk kanë qepje origjinale por shthurje e moralit tënd! Ti thjesht vetëm i pranon gjërat si të servuara, pa shikuar në ambalazh nëse u ka skaduar afati, apo nëse ke të drejtë të konsumosh diçka të tillë, por noton dhe vetëm noton, pa pasur diçka në fund të detit, sikur kërkon margaritarë, që si duket janë edhe të rremë! Edhe nga një margaritar i mundshëm, sikur do të mund ta merrje, do të shihje një përthyeshmëri të fortë të dritës, e veç kësaj do ta shihje diku në fund të detit, ose thënë ndryshe në thellësi ku uji është më i pastërt dhe jo i ndotur nga hiri që të përcëllon ty, prandaj kuptoje se në këtë ujë s'ka margaritarë për ty. Ai margaritar do të ishte i mbështjellë me dekoratë, e cila të njofton ty se ke punë me një gur të çmuar, andaj bëj kujdes kur e hap!

Një pellg në të cilin hidhen hirat e drunjve të djegur dhe nga ti kërkohet të gjesh diçka të vlefshme aty, qoftë edhe një copë letër më së paku...

Imagjinoje sikur po flasim për ty dhe po flasim për pamjen tënde, dmth diçka që ka të bëjë me ty. Këtë pellg plehrash mund ta konsiderosh edhe si një dyqan rrobaqepësie, ndërsa petkat të cilat ndodhen aty janë veshur nga njerëz të modës dhe yje të muzikës; kësajsoj edhe nga ti kërkohet të shohesh diçka të vlefshme, sipas shijes dhe asaj që ty të përshtatet!

Nuk është se një herë në jetë të erdhi rasti të zgjedhësh disa lecka me fije peri te prodhuesve të huaj dhe të nxitosh t'i kapësh ato! Janë të shpeshta sezonet e përhitura kur vjen dallga dhe na lëshon pluhur syve! Janë çdo ditë pantallonat e ngushta që na bëjnë të ngelim të ndikuar nga dikush, nën hijen e dikujt, nën oqeanin e thellë të modës së huaj...

Do të lexoni:



- Ahmet Tashgetiren /4** Një ditë pa gjynahe
- Medet Bala /9** Shfryzimi i kohës
- Harold Bloom /10** Muhamedi
- Murat Kaja /14** 7 njerëz të mirë
- Hasan Kamil Jëllmaz /18** Psikologjia e mëkatit dhe pendimit
- Jashar Kandemir /21** Pendimi
- Rrustem Spahiu /24** I sinqerti është edhe i ndershëm
- Fatmir Hadri / 26** Këmbimi i jetës së pastajme me jetën e kësaj bote
- Majlinda Hyseni / 28** Shkëputet edhe një fletë nga kalendari yt, të paktën le të jetë pa "gjynah"
- / 30** Një Ajet


Ahmet Tashgetiren /
Një ditë pa gjynahe

4



Hasan Kamil Jëllmaz /
Psikologjia e mëkatit dhe pendimit

18



Rrustem Spahiu /
I sinqerti është edhe i ndershëm

24



Viti: V | Numri: 24 | Mars 2010

Administrator i Progresi botime:
Shuajip Bashhan
bashan43@hotmail.com
+355 69 20 76768

Kryeredaktor:
Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23989

Përkthyesit:
Arjan Ymeri
Evans Drishti
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

Redaktor:
Shpëtim Kelmendi

Dizajn - Grafik:
Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj
e-mail: revistaetika@progresibotime.com
e-mail: kosova@progresibotime.com

Mars 2010

32

Osman Nuri Topbash /
Të jesh vazhdimisht me Zotin



46

Ymit Shimshek /
Fatihaja e jetës



48

Ma. Artur Tagani /
Ebu Hamid El-Gazzali



/ 31 Një Hadith

Osman Nuri Topbash /32 Të jesh vazhdimisht me Zotin

Mr. sci. Flamur Sofiu /40 Financat dhe shpenzimet e arkës shtetërore - thesarit të shtetit sipas të drejtës Islame

Ymit Shimshek /46 Fatihaja e jetës

Ma. Artur Tagani /48 Ebu Hamid El-Gazzali

Mag. Ermal Nurja /50 Xhami në vilajetin e Janinës

Familja / 52 Gruaja në Islam të drejtat dhe përgjegjësitë e saj

Shëndeti / 56 Studimi: për lindje pa dhimbje hani shegë

Aktualiet / 58 Asnjë rrezik për sigurinë në Kosovë

Teknologji / 60 Rusët testojnë avionin që i shpëton radarëve

PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania
Tel: +355 22 254 534
Fax: +355 22 254 533

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 441 63 651


Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë
Abonim (një vjetor) : 1500 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Abonim (një vjetor): 10 Euro
Maqedoni: 60 DEN
Abonim (një vjetor): 600 DEN
Europë: 2 Euro
Abonim (një vjetor): 24 Euro



Një ditë pa gjynahë

Ahmet Tashgetiren



Gjynahu është një term fetar dhe në çdo fe ka një term i cili e shpreh këtë sipas mënyrës së saj.

Kuptimi i këtij termi është moskryerja e urdhrave të shenjta, ose kryerja e ndalesave të cilat rregullojnë marrdhëniet ndërmjet njeriut dhe Krijuesit, njerëzve të tjerë, njeriut me vetveten dhe me të gjitha krijesat e tjera.

A ka njeri pa gjynah?

Profetët kanë cilësinë "Ismet", e cila do të thotë se "janë të ruajtur nga gjynahet". Mirëpo megjithë këtë, është pranuar se edhe Profetët mund të gabojnë në jetën e kësaj bote të vështirë. Në lidhje me këtë, Kur'ani i Madhëruar na kujton fjalët e Jusufit (a.s); **"Unë nuk e shfajësoj veten time, sepse epshi është shumë nxitës për të keqen, përveç atë që ka mëshiruar Zoti im..."** (Jusuf, 53)

Ndërsa Resulullahu (s.a.s) urdhëron e thotë: **"Unë bëj istigfar (lutje për falje) njëqind herë në ditë, lutem që Zoti im të më falë."** Mund të li-

ndë pyetja se; "Për çfarë bëhet ky istigfar?". Pra, do të thotë se edhe Profeti i Allahut e ndjen këtë nevojë shpirtërore. P.sh, kur u zbrit ajeti **"Abese ue teuella en xhaehu'l ama (Ai vrenjti (fytyrën) dhe u kthye sepse atij i erdhi i verbëri. (Abese,1-2)"** çfarë ka ndjerë zemra e Profetit (s.a.s)? Nuk mund ta dijmë. Sepse ndjesia e zemrës së Tij nuk mund të krahasohet me ndjesinë e zemrës së çdo lloj njeriu. Kështu që edhe ndjesia e gabimit është shumë më e ndryshme se e njerëzve të tjerë. Pra, si rrjedhojë, shprehja **"Unë bëj istigfar njëqind herë në ditë"** padyshim që ka kuptimin e vet shpirtëror. Mbase ky shembull i **"gabimit"** dhe **"istigfarit"** i cili jepet nga Ai, njeriu i dërguar si mëshirë për botët, është vetëm e vetëm që të na mësojë neve kuptimin e vërtetë të marrëdhënieve ndërmjet njeriut dhe Allahut brenda dimensioneve të gjynahut dhe pendimit.

Përveç kësaj, Resulullahu (s.a.s) ka udhëruar edhe kështu : **"Nëse ju nuk do bënit gjynahë, Allahu do të krijonte një popull që do të bënte gjynahë, do**

të pendohej, do të bënte istigfar dhe Ai do ta falte atë.” (Muslim, Teube, 10) Marrëdhënia gjynahpendim, të cilat zhvillohen si një dimension i natyrshëm i personalitetit njerëzor, duket si një element që e mban gjithmonë gjallë lidhjen e njeriut me Zotin e tij.

Rregullat e mbarëvajtjes së kësaj bote, janë këto:

Për njeriun janë vënë rregulla.

Njeriu nuk do t'i shkelë këto rregulla.

Mirëpo, njeriut i është dhënë një ndjenjë e brendshme imponuese (ego apo nefis) që e shtyn atë të shkelë këto rregulla. Kjo ndjenjë imponuese, në një farë momenti mund ta mposhtë njeriun. Ja pra, në atë moment njeriu duhet të kujtojë Zotin e tij dhe të thotë: “Çfarë bëra?”.

Kështu që jeta e njeriut duhet të shihet brenda këtij ekuacioni...

Këtë mund ta quajmë ndjesi e gjynahut dhe pendimit.

Për njeriun, të mos bërit gjynah është një panoramë e vëshitirë për t'u imagjinuar. Mirëpo, mosanimi nga gjynahu është një detyrë njerëzore që e kërkon marrdhënia me Allahun.

Kështu që njeriu duhet të gjejë një harmoni. Dhe kjo harmoni duhet të jetë e tillë:

Të mos mësohesh me gjynahun dhe të mos e nënvlerësosh atë, të mos humbësh ndjenjën ndaj gjynahut dhe të mos i harrosh rregullat, të mos harrosh vënësin e këtyre rregullave dhe t'i njohësh këto rregulla, të mos mundohemi që t'i zëvendësojmë këto rregulla me të reja. Nëse i kemi shkelur këto rregulla, duke marrë për bazë marrëdhënien e ligjëvënësit me ne, pra që ne ekzistojmë me urdhërin e Tij “KUN” dhe që këtë ekzistencë ia kemi për borxh vullnetit të Tij, pra duke menduar që edhe damarët e qafës tonë janë në dorën e Tij dhe se mund ta kemi fyer Atë,

le të mundohemi të ndërtojmë fushën e respektit (ndjenjën e devotshmërisë) me Atë...

Me një këmbëngulje të fortë, Resulullahu (s.a.v.s) e sheh çështjen e gjynahut brenda një kornize shpirtërore...

Çfarë është gjynahu?

Është ajo gjë të cilën zemra jote nuk e pranon.

Konsultohu me zemrën!

Shiko, a ndjen ndonjë shkatërrim, papastërti, rrëshqitje, plagë apo gërrvishtje zemre...?

Ç'është ajo që është shkatërruar? Ç'plagë është? Çfarë ka rrëshqitur? Çfarë është shtypur? Ç'është ajo që ta djeg zemrën? Çfarë është ajo që është zhytur aty? Ajo që të thotë “Ah sikur”? Ç'është ajo gjë që gjithmonë të zgjon ndjenjën “sikur të mos e veproj?”

Në marrdhënien me Krijuesin ndodh diçka kur i kalon caqet...

Duart e tua humbasin kupimin, gjuha, syri, veshi, zemra dhe mendja jote bien larg qëllimit të krijimit. Ashtu sikur tregon edhe Mevlana i nderuar për padishahun që kishte dalë për gjah dhe në grykën e armës


së tij qëndronte një dre i cili i thoshte:

-Allahu nuk të ka krijuar për të më gjuajtur mua...

I Dërguari i Allahut thotë; “**njeriu nuk bën zina, nuk gënjen dhe nuk vjedh duke qënë besimtar**”

Këto janë gjynahe të mëdha...

Këto fjalë të bekuara nënkuptojnë se, nuk mund t'i kryeni këto veprime duke qënë bashkë me Allahun. Kështu që, kur i veproni këto punë, keni harruar, kujtoni se marrdhëniet me Allahun i keni vënë në





një vend ku nuk i shihni.

I nderuari Ibrahim Edhem i përgjigjet kështu një njeriu që i vjen dhe i thotë, **“Më jep një këshillë që ta kem vath në vesh”**:

“Nëse bën gjynah, mos ha nga mirësitë e Allahut!

Njeriu: - Çdo e mirë në këtë botë është prej Allahut.

Ibrahim Edhem thotë: - Atëherë, a është mirë të hash prej të mirave që të ka dhënë Allahu dhe më vonë të bësh gjynah? Kjo nuk është një cilësi njerëzore.

Ibrahim Edhem vazhdon: - Mos bëj gjynah kur të jesh në tokën e Allahut, largohu!...

Njeriu thotë: - Kjo është më e vështira. Çdo vend është i Allahut, ku të shkoj?

Ibrahim Edhem thotë: - Atëherë, a është mirë të qëndrosh në pronën e Tij dhe të bësh gjynah? Kjo nuk është cilësi njerëzore.

Ibrahim Edhem përsëri thotë: - Kur të bësh gjynah, fshihe atë prej Allahut !

Njeriu thotë: - Allahu e di dhe e sheh të fshehtën dhe të hapurën. Si ta fsheh unë atë prej Tij?

Ibrahim Edhem thotë: - Atëherë, a nuk ke turp që ushqehesh me të mirat e Tij, qëndron në pronën e Tij dhe kryen gjynahe aty ku e di se Ai të sheh! Ky nuk është nderi njerëzor.

Ibrahim Edhem vazhdon: - Kur të afrohet vdekja, kërko pak kohë prej engjëllit të vdekjes, në mënyrë që të pendohesh.

Njeriu thotë: - Ai që merr shpirtat nuk i jep kohë askujt. Jeta është e shkruar, pastaj unë do të jem duke lënguar nga dhimbjet, ku ta gjej kohën?

Ibrahim Edhemi thotë: - Atëherë pendohu pa ardhur marrësi i shpirtit! Mos humb kohë! Si të jetosh, ashtu do të shkosh dhe sipas teje koha e shkruarjes nuk dihet! A është mirë pra, t'i dish këto të vërteta dhe të mos marrësh masat? A nuk është kjo një pakujdesi njerëzore?

Ibrahim Edhem vazhdon e thotë: - Mos iu përgjigj pyetjeve të Munkerit dhe Nekirit (engjëjt e varrit) në varr.

Njeriu thotë: - Si mundet? Ata janë të ngarkuar me këtë detyrë dhe nuk shkojnë pa marrë përgjigje.

Ibrahim Edhem thotë: - Atëherë, a është mirë të rrih e të mos e përgatitësh që këtu përgjigjen e vërtetë që duhet t'u japësh? Ky nuk është botëkuptim njerëzor.

Ibrahim Edhemi vazhdon e thotë: - Në ditën e kiametit, nëse duan të të çojnë në xhehennem, u thuaj “nuk vij”!

Njeriu: - A është e mundur kjo? Se mos më pyesin mua ata! Më kapin për krahu dhe më hedhin drejt e në zjarr.

Ibrahim Edhemi thotë: - Atëherë, duke qënë se i di këto gjëra, përse bën gjynahe? Ai që do xhennetin në botën tjetër, përgatitet që këtu për xhennetin, ndërsa ai që e ka hak xhehennemin, bën gjynahe këtu. Cili nga këta të jesh, ashtu vepron!” (Këshilla të

arta, Ahmet Tashgetiren, fq.392, Bot.Erkam)

.....

Edhe Imam Gazaliu, në veprën e tij **“Kimia e Lumturisë”**, psikologjinë njerëzore të **“animit nga gjynahu dhe mosshkëputjes prej tij”** e analizon brenda kufinjve shpirtëror. Sipas Imam Gazaliut, arsyet njerëzore për vazhdimin e gjynaheve janë këto:

1. Nuk beson ose dyshon për botën tjetër

2. Epshi i tij është forcuar aq shumë, sa që nuk nuk ka fuqi që t’i braktisë ato dëshira. Kënaqësia e ka mbështjellë aq shumë, sa e bën atë të pakujdesshëm ndaj rrezikut të botës tjetër.

3. Bota tjetër duket si një këst borxhi, ndërsa kjo botë ngjan me paratë e thata në dorë. Natyrës njerëzore i duket më e lehtë paraja, ndërsa këstin e borxhit e shikon shumë larg. Pra, kur syrit i duket larg, edhe zemrës i duket larg.

4. Ai që është besimtar mundohet që çdo ditë të pendohet, mirëpo e lë edhe për të nesërmen. Për çdo dëshirë që i vjen, thotë, të bëj këtë dhe nuk bëj më.

5. Nuk është e thënë që gjynahu do të na çoj në zjarr, mbase edhe falemi. Në përgjithësi njeriu shpreson vetëm për mirë, kur e kap ndonjë epsh, thotë “Allahu Teala fal” dhe shpreson për mëshirë.

Me këto gjëra njeriu thjesht gënjen vetveten.

Gazaliu, duke marrë për bazë hadithin e Profetit (s.a.s) **“Besimtari e sheh gjynahun si një mal që i rri mbi krye dhe friksohet se mos i bie në kokë. Ndërsa dyftytrëshi e sheh si një mizë që ka ndaluar mbi hundën e tij dhe kujton se do të largohet.”**, në rradhë të parë paralajmëron nga **“gjynahet e vogla”**. Dëshiron që njeriu të krijojë një ndjesi ndaj tyre. Duke bërë pyetjen **“Me çfarë rritet gjyna-**

hu i vogël?”, analizon dobësitë themelore të njeriut dhe thotë:

“Njeriu duke vazhduar me gjynahe të vogla, e nxin zemrën e tij. Kjo i ngjan pikës së ujit që gërryen gurin. Dhe një kohë më vonë, zemra e humb ndjeshmërinë e saj.

Arsyeja e dytë që e shpie njeriun drejt gjynaheve, është nënvlerësimi i gjynahut. Ta shohësh gjynahun e vogël si të madh, është prej besimit, ndërsa ta shohësh të vogël është prej pakujdesisë. Kjo pra është dobësia e zemrës. Zemërimi i Allahut Teala është i fshehur në një gjynah. Dhe mbase është ai gjynah që ti e sheh për të vogël.


Të kënaqurit e njeriut me gjynahun që bën dhe të kuptuarit e tij si një fitim, si p.sh; “e mashtrova atë, ia mora mallin, e shava atë” dhe të tjera si këto ndjenja, janë elemente të cilat e thellojnë dobësinë e zemrës.


Ta shohësh gjynahun si fitim që nuk e di njeri, është një anë tjetër e dobësisë së zemrës.

Ta bësh të ditur gjynahun dhe të pengosh Allahun që ta mbulojë këtë gjynah, është një hap tjetër për kalimin e caqeve në kryerjen e gjynahut. Sepse ky veprim i stimulon edhe të tjerët për gjynahe. Të moçmit thoshin: **“E keqja më e madhe**

që një musliman mund t’i bëjë një muslimani tjetër, është ta tregojë gjynahun si të vogël në sytë e tij.”

Kryerja e gjynaheve prej dikujt që është dijetar ose prijës, në pikën e stimulimit të gjynahut është një gjynah edhe më madh. Është thënë : **“Sa me fat është njeriu që kur vdes, i vdesin edhe gjynahet.”** Dijetarët dhe prijësit janë njerëz të cilëve kur vdesin nuk u vdesin edhe gjynahet, por përkundrazi vazhdohen nga njerëzit e tjerë në emër të tyre. Si rrejdhojë, dijetarët dhe prijësit e çojnë në humbje një qytet apo një popull. Dijetarët rrojnë me frikë:





Një gynah i tyre bëhet njëmijë, por edhe një e mirë bëhet njëmijë.

Për këtë arsye, Imam Gazaliu thotë: **“Të tregosh punët e gabuara të dijetarëve, konsiderohet si vrasje”**. Gjithashtu thotë: **“Të mbulosh gynahun e të tjerëve është vaxhib (detyrë), por të mbulosh gynahun e dijetarëve është vaxhib edhe më i rëndësishëm.”**

Jetojmë në një kohë kur gynahu është bërë i lehtë dhe shumë përhapur, kur gynahet e mëdha i kapin njerëzit dhe popujt dhe i shkundin ashtu siç bën furtuna, kur njeriu e ka humbur rrugën e tij brenda perdeve të pakujdesisë së gjynaheve të vogla, të cilat as që e kuptojnë se i veprojnë, pra në kohën kur kanë harruar lidhjen me Zotin e tyre. Jetojmë në kohën kur rregullat nuk njihen dhe ato që njihen kanë humbur, kohë ku njeriut i ofrohen rregulla të reja të paketuara në ambalazhe të shndritshme, kur është harruar lidhja e këtyre rregullave me Mëshiruesin, Krijuesin dhe Furnizuesin. Jetojmë në një kohë ku aftësia ndiesore e zemrës është atrofizuar.

Kur zemrat ndyhen me gjynahe, nuk ndjejnë dhimbje e nuk rënkojnë.

Kjo është një gjëndje shumë e keqe. Në brendësi të njeriut duhet të ketë një vend që të thotë **“pyet zemrën”**. Duhet të ketë një pikë e cila nuk është ndotur, e cila mund ta ndajë dritën nga errësira.

Sot, duhet t'i kontrollojmë zemrat tona. A ndien ndonjë djegie kur kalojmë caqet? A kërkohet me përmallim pendimi? A ndiejmë dhimbje kur mërzitim Zotin tonë?

A mendojmë për çështjen **“Të frikësohesh prej gynahut”**?

A kemi njohur diçka si **“Një ditë pa gynah”**? A do të mund t'i çojmë Zotit tonë një ditë të pastër e të shndritshme, ashtu sikundër na i ka dhënë Ai të gjitha ditët në formën e jetës?

Këtë ndjenjë Islami e ngre dhe e lartëson...

E lartëson pendimin si një strehim tek Zoti.


Shikoni si e tregon Muhjiddin ibn Arabiu lidhjen e **“një besimtari të vërtetë”** me gynahun:

“ Nuk shfaqet ndonjë gynah prej besimtarit të vërtetë, pa patur në të ndonjë pjesë të adhurimit. Sepse ti e ke besuar që ai gynah është kryeneçësi. Atëherë, meqënëse e di mirë se gynahu që ke kryer është gynah dhe kryeneçësi, shtoi edhe bindjen.

Nëse bindjes që i shtove i shton edhe istigfar dhe pendim, bindja bëhet edhe më e fuqishme dhe afrimi me Allahun është më i ndjeshëm. Nëse kësaj bindjeje i shtohet një vepër e keqe, mjafton një pjesë e kësaj bindjeje për ta mposhtur atë gynah. Ajo që të afron më tepër te Allahu, është padyshim besimi. Është gjëja më e vlefshme dhe më e madhe pranë Allahut.”

(Këshilla të arta, Ahmet Tashgetiren, fq. 348, Bot. Erkam)

Ah sikur të ishim të afërt me besimin, pendimin dhe istigfarin, ashtu sikur jemi me gynahun... Ah! Sikur ta dinim se sa të pakujdesshëm jemi.



Shfrytëzimi i kohës

Medet Bala

Pasuria më me vlerë që ne e humbasim pa vënë re, është jeta. Ajo rrjedh si uji. Zoti betohet në kohën, pikërisht për të vlerësuar këtë të vërtetë, duke theksuar se jemi në humbje në lidhje me këtë aspekt. Pejgamberi (a.s), si shembull në këtë drejtim thotë:

- Ka dy mirësi që njerëzit nuk ua dinë vlerën ashtu siç duhet. Këta janë shëndeti dhe koha e lirë.

Kjo ndodh sepse ne e kuptojmë vlerën e kohës vetëm kur e humbasim atë dhe më pas pendohemi, por në asnjë rast nuk mund ta kthejmë kohën mbrapa. Le të sjellim një rast konkret:

Në një universitet të njohur, në një orë mësimi me temë “Shfrytëzimi i kohës”, pedagogu, pasi hyn në klasë, u hedh një vështrim studentëve dhe u thotë:

- Sot do të bëjmë një provë në lidhje me shfrytëzimin e kohës.

Shkoi te tryeza e tij dhe nga poshtë saj nxorri një kavanoz të madh. Më pas, mori disa gurë të formave dhe përmasave të ndryshme dhe filloi t’i vendoste brenda kavanozit. Pasi u sigurua se kavanozi nuk zinte më gurë, u kthye tek nxënësit dhe i pyeti:

- Si mendoni? A u mbush kavanozi?

- U mbush... - iu përgjigjen studentët njëzëri.

- Ashtu? – reagoi i habitur profesori. Pastaj, duke u përkulur nxorri nga poshtë tavolinës një kovë me gurë të vegjël. I hodhi lehtë në kavanoz. Më pas e tundi atë disa herë, në mënyrë që copat të zinin vend mirë. U kthye sërish kah studentët dhe i pyeti:

- A u mbush kavanozi?

- Me sa duket akoma nuk është mbushur, - iu përgjigj një student nga larg.

- E drejtë, - ia ktheu profesori dhe duke u përkulur përsëri poshtë tryezës mori një kovë me rërë e ia hodhi kavanozit, derisa e mbushi plotësisht gjer në grykë. U kthye prapë nga studentët dhe i pyeti:

- Po këtë here, a u mbush kavanozi?

Të gjithë studentët thanë *jo* njëzëri.

- Bukur - tha profesori dhe përsëri nxorri nga poshtë tavolinës një kovë me ujë dhe e hodhi në kavanoz, duke e mbushur atë deri në grykë.

Pastaj iu drejtua studentëve:

- Cili ishte qëllimi i kësaj prove?

Një student i mençur e mori menjëherë fjalën dhe u përgjigj:

- Sado e plotësuar të duket koha jonë, ka ende vend për t’u plotësuar.

- Jo! - tha profesori, - domethënia e kësaj prove është kjo:

- Nëse gurët e mëdhenj nuk i vendos në fillim, pasi të jenë vendosur gurët e vegjël, gurët e mëdhenj nuk do mund t’i vësh dot.

Studentët panë njëri – tjetrin me habi dhe ndërkaq profesori vijoi:

- Çfarë janë gurët e mëdhenj në jetën tonë? Janë fëmijët tuaj, njeriu i jetës (burri apo gruaja), të dashurit, shokët, arsimimi, ëndrrat, shëndeti, një vepër e juaja, të jesh i dobishëm për të tjerët, t’u mësosh diçka atyre! Gurët tuaj të mëdhenj ndoshta janë vetëm disa prej tyre, ndoshta një pjesë e tyre, ndoshta edhe të gjitha. Sonte, përpara se të flini mendoni mirë se cilët janë gurët tuaj të mëdhenj, merrni një vendim të mirë. Ta dini se nëse gurët e mëdhenj nuk i vendosni që në fillim në kavanoz, nuk do të keni mundësi t’i vini më vonë. Atëherë nuk do të jeni i dobishëm as për veten tuaj, as për vendin ku punoni dhe jetoni. Kjo tregon se në të vërtetë nuk do të mund të bëheni një biznesmen i mirë apo dhe më shumë.

Si përfundim, ata të cilët e shfrytëzojnë kohën ashtu siç duhet, do të dinë t’i zgjedhin dhe t’i vendosin mirë gurët e mëdhenj qysh në vitet e rinisë. Kështu vlerësohet denjësisht edhe vetë jeta. Në të kundërt, jeta do të jetë me humbje dhe me pendime të shumta. Ata që nuk dinë ta shfrytëzojnë kohën, duhet të kuptojnë se jeta nuk të pret



MUHAMEDI

Muhammedi (a.s.) dhe Kurani parë me syrin e një perëndimori

Harold Bloom

Nga pikëpamja spirituale bota perëndimore u formua prej tre shkrimeve të shenjta: Bibla Hebraike (ose Dhjata e Vjetër), Dhjata e Re greke dhe Kur’ani arab. Shumica prej nesh i ka lexuar dy tekstet e parë, ose mbase i ka studiuar, natyrisht në përkthimin e gjuhës përkatëse të vendit. Por shumë pak vetë kanë marrë mundimin ta lexojnë Kur’anin. Edhe sot e kësaj dite ka studiues, të cilët e cilësojnë atë si variant të papërpunuar të shkrimeve hebraike dhe të krishtera – megjithëse ata duhet ta dinë më mirë. Por edhe një përkthim i saktë (për ata që lexojnë anglisht do ishte ai i Ahmed Ali i vitit 1988) mund ta bëjë të qartë, që Kur’ani është një vepër më vete dhe konkurrent i padiskutueshëm i atyre shkrimeve të fuqishme, për të cilat ai e din që është pasardhës i tyre dhe që i riinterpreton në një formë të mahnitshme.

Muhamedi, i dërguari i Zotit dhe “Vula e Profetëve” pati ndikimin e tij në shekullin e shtatë të e.s. dhe vdiq në vitin 632, pak a shumë në moshën gjashtëdhjetëvjeçare. Që në moshën 40 vjeçare zëri i Zotit

foli përmes tij, i ndërmjetësuar nga engjëlli Gabriel. Shprehjet dhe fjalët e tij, të cilat u shkruan dhe u mësuan përmendsh nga ithtarët e vet, formuan në fund Kur'anin, "Librin që recitohet shpesh". Nëse Muhamedi nuk dinte vërtetë shkrim e këndim, atëherë duhet ta konsiderojmë patjetër si një ndër krijuesit më të rëndësishëm të prozës nga trashëgimia e teksteve që na kanë ardhur gojë më gojë. Islami ("Bindje ndaj Zotit" ose "nënshtrim" ndaj Tij) përqendrohet më shumë te Kur'ani se sa Krishtërimi te Testamenti i Ri, apo Hebraizmi te Bibla hebraike. Kësisoj, Kur'ani duket ndryshe nga shkrimet e shenjta paraardhëse, sepse nuk ka asnjë kontekst të brendshëm. Hebrejtë dhe studiues të tjerë të Biblës janë në gjendje që, shumicën e teksteve të shenjta t'i vendosin në një kontekst historik të caktuar. Kurse Kur'ani, përkundrazi, është (të paktën nga pikëpamja e aspekteve "hebraiko-kristiane) një vepër absolutisht origjinale dhe krejt më vete. Ashtu siç duket i çuditshëm konstrukti i dy shkrimeve të tjera të shenjta, ashtu duken ato edhe në krahasim të parë me Kur'anin; që vërtet karakteri i modelit ka lidhje me koherencën. Kur'ani përbëhet nga 114 Sure, që quhen kapituj ose seksione, të cilat janë pa asnjë kontekst dhe parë nga e përgjithshmja, madje edhe nga e veçanta, ato nuk lejojnë për një vijueshmëri të brendshme. Gjatësia e tyre varion fuqishëm, struktura e tyre nuk lejon të dallosh kronologjinë, dhe përveç sures së parë, duket se i vetmi princip i organizimit të saj është se duhet të lexohet nga surja më e gjatë deri tek ajo më e shkurtër. Asnjë libër tjetër nuk duket kaq i çuditshëm dhe aq arbitrar në strukturë sa ky – gjë që sigurisht duhet të kemi parasysh, kur zëri, që na drejtohet neve, është ai i Zotit - , se ndryshe, kush do ta kishte pasur guximin t'i përcaktonte ndonjë formë shprehjeve të Zotit.

Nga pikëpamja e jashtme Kur'ani përbëhet nga thëniet profetike, të cilat Muhamedi i shprehu ndërmjet moshës 40-vjeçare, kur atij iu bë shpallja, dhe 62-vjeçare, kur ai vdiq papritur. Gati njëzet vjet pas vdekjes së profetit, Utmani, i treti nga kalifët e Muhamedit, urdhëroi që Kur'anin ta hartonin prej të gjitha teksteve të zbritura, si me gojë ashtu edhe me shkrim. Nuk ka asnjë arsye të mirëfilltë të dyshojmë në autenticitetin e tekstit apo në përmbledhjen e tij (të paktën në pjesën më të madhe) përmes vetë Muhamedit. Ekuivalenca më e afërt amerika-



ne do të ishte *Doctrines and Covenants* të profetit mormon Joseph Smith, shpallja e të cilit tregon të njëjtat veçori në lidhje me Hebraizmin dhe Krishtërimin, ashtu si vizionet e Muhamedit në lidhje me burimet hebraike dhe të krishtera. Por Smith-i as që i afrohej forcës retorike të Muhamedit, megjithëse edhe ai ishte një gjeni fetar. Forca shprehëse e Muhamedit i ka kapërcyer më shumë se thjesht mangësitë tipike strukturore të Kur'anit. Në disa fragmente më shkon ndërmend, që struktura konfuzë e Kur'anit (ose mungesa e stukturës) e thekson më tepër elokuencën e Muhamedit: Mungesa e një konteksti narrativ dhe e një njësie formale e shtyn lexuesin të përqendrohet në fuqinë e drejtëpërdrejtë dhe të pamasë të Zërit, brenda së cilës – sado që të karakterizohet përmes gjuhës së të dërguarit – është një autoritet me plot bindje. Ai nuk na kujton vetëm fjalën e drejtëpërdrejtë të Zotit në Bibël, por edhe mbështetet mbi të.

John Eansbrough, në librin e tij *Qur'anic Studies: Sources and Methods of Scriptural Interpretation*



(Oxford, 1977), vëren se mesa duket, në kohën e tyre ithtarët e Muhamedit nuk kanë pasur asnjë lloj vështirësie t'i kuptonin aludimet e tij shumë të zbutura për shkrimet biblike. Është më se e qartë që auditori i Profetit në Mekë dhe në Medinë kishte njohuri të konsiderueshme për historinë biblike – shpesh nga ato variante të vona çifute, të cilat mbase kanë humbur përgjithmonë – , madje edhe kur çifutët (apo kristiano-çifutët antipaulian të mbijetuar?) ishin nën sundimin e tyre. Arabët, të cilëve Muhamedi u dha profecitë e tij, jetonin bashkë me fise çifute (apo arabë të çifutizuar), edhe me të krishterë, madje kishin kontakte edhe me murgj. Një çifut apo i krishterë, që në ditët e sotme e merr Kur'anin në dorë për herë të parë, do të ndjehet me siguri pak i shqetësuar, sepse idetë dhe historitë që përmban ai, tingëllojnë aq të njohura dhe njëkohësisht më se të huaja. Se Islami, mund të jetë me të vërtetë si feja e Abrahamit, ashtu edhe mund të përmbajë besimin e Jezusit, siç na siguron ai; por me “Abrahamin”, sipas fjalëve të Muhamedit, kuptojmë këtu besimin arkaik çifut, ndërsa me “Jezusin” jepet krejt

i qartë ai Krishtërim çifut i cili u përfaqësua nga vëllai i Jezuit, Jakobi, si dhe nga ithtarët e Jezuit që u mposhtën nga shën Pali në Jeruzalem, e të cilët, mbas shkatërrimit të tempullit të Jeruzalemit kaluan nëpër Jordani dhe u tërhoqën në treva të tjera arabe. Jezusi i Muhamedit është njeri dhe jo Zot. Veç kësaj, ai nuk vdes i kryqëzuar. Në vendin e tij vdes dikush tjetër, ashtu siç pretendojnë edhe disa shkrime gnostike, të cilat mund të lidhen me buri-me çifuto-kristiane.

Shumë prej nesh janë mësuar ta lexojnë “Biblën si letërsi”, gjë që për besimtarët çifutë apo të krishterë është njësoj e papranueshme. Tani dua t’ju prezantoj këtu “Kur’anin si letërsi”, megjithëse besimtarëve myslimanë do t’u duket edhe më e papranueshme. Por, myslimanët shprehen madje më shumë për një Kur’an “rrezatues” sesa për një Kur’an “të shenjtë”, gjë që sipas këndvështrimit të tyre shpjegon se Kur’ani është një libër “i pakrijuar” nga njeriu, ngaqë ai është besnik edhe ndaj gërmave të fjalës së Zotit. Sado elokumente të jetë edhe një pjesë e madhe e Biblës Hebraike (aq më pak do thosha për Leviticus, si edhe për fragmente të caktuara të Numeri) dhe sigurisht, sado prekës dhe mallëngjyes të jetë Ungjilli i Markut, është po aq e sigurt se asnjë shkrim tjetër nuk i referohet autoritetit të zërit të Zotit në atë formë absolute si Kur’ani. Është e qartë se rimat e vargjeve të tij nuk mund të përshtaten në gjuhë të huaja, por madje edhe përkthimet janë në gjendje ta transmetojnë forcën e tij letrare (të paktën për këtë jam i bindur nga disa përkthime në anglisht). Lexuesi duhet të dëshmojë durim dhe të mos i përfillë të gjitha përsëritjet dhe paqartësitë, nëse do që të ketë një shans për ta dëgjuar atë zë që ka mundur t’i kthejë dhe t’i forcojë qindra miliona njerëz, të cilët gjatë trembëdhjetë shekujve janë kthyer në Islam, ose i kanë qëndruar besnik atij. Ne duhet ta shohim Kur’anin si një vepër, që edhe për ne të jetë me kuptim thelbësor, sepse Islami nuk do qëndrojë larg nesh: Ai do ndikojë gjithnjë e më shumë në jetën e vendeve tona.

Kur’ani më mahnit mbi të gjitha, sepse e mbaj si shembullin më të fuqishëm të asaj “frike që ndikon”, të cilën e kam trajtuar në një shkrim tjetër,

duke pasur parasysh çerek-shekullin e kaluar. Meqë Muhamedi ishte një profet i fuqishëm, manifestohet edhe në Kur'an një luftë *enorme* (dhe e paraqitur qartë, e fituar) kundër Torës dhe shtojcave rabini-ke për pesë librat e Musait. Përcaktimi “Populli i librit”, në Kur'an, lidhet si me çifutët ashtu edhe me të krishterët, por për Muhamedin duket se ka pasur vetëm një Ungjill, dhe kjo gjë mezi mund të krahasohet me kulturën tonë. Muhamedi e shikon Jezuin si një profet të vërtetë brenda një vargu profetësh, i cili fillon me Adamin dhe mbaron me vetë Muhamedin. Mirëpo ky Jezus është në të njëjtën kohë më shumë se një profet dhe më pak se sa biri i Zotit. Kur'ani e pranon paraqitjen e shtatzanisë së virgjëreshës dhe e shikon Jezusin si Mesian legjitim çifut, të cilin ai pastaj natyrisht e kupton si një dëshmi t'mëtejshme të besimit të Abrahamit: Goditja më e guximshme e Kur'anit, në aspektin e krahasimit me Torën, është këmbëngulja e tij se Abrahami nuk ishte as çifut, as i krishterë, por ishte shfaqja e parë e Islamit, pra ishte nënshtrimi ndaj “një Zoti të vetëm”, Allahut. Me këtë interpretim, Muhamedi përmbledh historinë e shenjtë të popullit çifut dhe me Magd Hagar-in egjiptian të Sarës i jep Jishmailit, birit të Abrahamit, autoritet të njëjtë si Isakut dhe Jakobit, të cilët paraqiten edhe në Kur'an si bijtë e Abrahamit. Si reformator profetik, Muhamedi donte të mposhte paganizmin në qytetin e tij të lindjes, në Mekë, dhe t'i largonte “tradhtarët e besimit të pastër” të Abrahamit dhe Jishmailit: si dhe ithtarët e Judaizmit rablinik dhe Krishtërimin që vijoi në Jeruzalem më shumë nga shën Pali se sa nga njeriu i drejtë, Jakobi.


Kjo luftë për “pronën” e Abrahamit është në qendër dhe përçon forcën mjeshtërore të Kur'anit të lavdishëm, që autoritetin e tij spiritual e lidh si me Abrahamin ashtu edhe me Muhamedin. Madje Kur'ani arab e thekson autoritetin si princip zotë-

ruet më shumë sesa Bibla Hebraike dhe Dhjata e Re. Disa pjesë në Biblën Hebraike dhe shumë fragmente në Dhjatën e Re janë polemike, por ama i gjithë Kur'ani është një polemikë e fuqishme: kundër mosbesimtarëve të Mekës, kundër çifutëve të Medinës dhe kundër atyre kristianëve të Arabisë (por mbase nuk ka patur shumë), të cilët nuk ishin as Ebionitë, as kristiano-çifutë. Ky ton polemik nuk e zvogëlon aspak forcën e poezisë prozaike të Kur'anit, por padyshim ndihmon të na shpjegojë pse spiritualiteti i këtij shkrimi, në përshtypje të parë, është më pak profund për lexues jomysliman, se sa spiritualiteti i shkrimeve të shenjta, me të cilat

matet Kur'ani dhe me të cilat njëkohësisht mundohet të ketë marrëdhënie. Recitali i Muhamedit përgatitet gati fund e krye për betejë, dhe kjo retorikë na kujton rolet e shkrimit të Detit të Vdekur, në të cilat lexohet se sa shumë ishte armatosur populli i bashkimit, që t'i dilte kundër gjithë botës dhe që të mund të dëshmonte. Mbase Profeti i Islamit nuk e përballoi kurrë gjithë tronditjen dhe zemërimin e tij ndaj faktit që çifutët e Arabisë nuk e pranuan si atë të dërguarin e Zotit, i cili u ishte premtuar nga trashëgimia e tyre me shkrim dhe me gojë. Aq sa ndjehen çifutët të shqetësuar nga e keqja, kur lexojnë Dhjatën e Re – sidomos Ungjillin e Gjonit – po

aq i druhen edhe Kur'anit kur lexojnë se si Muhamedi i paraqet çifutët si hipokritë dhe tradhtarë në misionin e tyre. Po tekefundit zemërimi i tij është i kuptueshëm, mendohet që vizioni i nënshtrimit ndaj Zotit në Kur'an – nga këndvështrimi teologjik – na shpaloska një herezi rrënjësisht më të rëndë nga pikëpamja e Krishtërimin të Sh.Palit sesa nga pikëpamja e besimit çifut arkaik. Kur'ani ka pak të përbashkëta me Talmudin, por më duket më se bindës si një riinterpretim i patriarkëve hebraik dhe profetëve.

vijon...





njerëz të mirë

Murat Kaja

1. Kryetari i shtetit i cili punon me drejtësi.
2. I riu që edukohet me dashuri dhe respekt ndaj adhurimit të Allahut.
3. Njeriu, zemra e të cilit është e lidhur mbas xhamisë.
4. Ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut.
5. Ai që ruan nderin dhe namusin.
6. Mirëbërësi, i cili atë që jep me dorën e djathtë nuk ia di e majta.
7. Ai që e përmend Allahun kur është i vetmuar.

Profeti ynë (s.a.u.s), ka ndjekur metoda të shumta për t'ia mësuar njerëzve këtë fe. Përveç urdhërave dhe ndalesave, ndonjëherë ka rregulluar gabimin ose ka miratuar edhe punën e mirë të ndokujt. Ndonjëherë u ka drejtuar pyetje shokëve të tij dhe përgjigjen përsëri e ka dhënë vetë. Pyetjeve që i bëheshin, ndonjëherë u përgjigjej ashtu sikur ishte, por ndonjëherë duke dhënë edhe më tepër detaje nga ç'kërkohej.

Ka qëlluar t'i mësonte edhe duke e vepruar, ose duke u larguar vetë nga një vepër. Ndonjëherë ka folur pak dhe saktë, arsye për të cilën e kanë quajtur edhe **“xhevamiu'l-kelim”**, që do të thotë, “tregon shumë, me pak fjalë”. Këto fjalë ai i ka gëdhendur në mendjen e njerëzve, duke i përmendur nga tri herë. Ndonjëherë, çështjen e ka shpjeguar gjërë e gjatë, ka treguar ndodhi dhe ka portretizuar çështje të ndryshme. Dhe ndonjëherë, i shpjegonte të ndara në kategori...

Është e mundur që këto t'i japim një nga një, me shembuj, sepse librat e haditheve janë të mbushur me mijëra nga këto shembuj. Mirëpo, këtu duam të marrim në dorë një hadith që na tregon se si i Dërguari i Allahut u ka mësuar njerëzve fenë, moralin e lartë, urtësinë dhe vlerat, duke ua dhënë diturinë të ndarë në kategori dhe grupe.

I Dërguari i Allahut na e përkujton shpesh botën tjetër dhe i portretizon në një mënyrë të gjallë ato që do të ndodhin atje, gjëndjen dhe veprimet e njerëzve. Ja pra, hadithi ynë fillon duke treguar gjëndjen e njerëzve në botën tjetër: **“Atë ditë Allahu do të marrë nën hijen e (arshit të) vet shtatë persona. Atë ditë nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së (arshit të) Tij.”** (Buhari, Xhemaat dhe Imamet, 8; Muslim,

Zekat, 91) Me këtë, Profeti ynë (s.a.u.s) na sjell para syve edhe gjëndjen e asaj dite në botën tjetër, por na bën edhe kureshtar për të ditur se cilët janë këta persona. Cilët janë këta shtatë persona fatlumë? Ç'është ajo që i bën ata të përgëzohen me këtë mirësi?

Në fillim Resulullahu (s.a.u.s) tregon për kryetarin e shtetit që punon me drejtësi. Pra këtu na jepet një stimulim drejt fushës materiale të kësaj bote. Që në fillim, ai sikur na jep mesazhin se në këtë fe materialja dhe shpirtërorja janë të lidhura si mishi me thoin. Resulullahu (s.a.u.s) i jep shumë rëndësi sigurisë dhe mirëqënies ekonomike të njerëzve dhe dëshiron që populli të jetojë i qetë dhe i sigurtë. Për këtë arsye, nuk e lë bosh këtë fushë. Ai vë në dukje një vlerë universale: Drejtësinë. Ky është edhe një princip i cili theksohet shumë në Kur'anin Famëllartë. (Nisa 4/58; Maide 5/8; Nahl 16/90) Madje Kur'ani na tregon për Davudin (a.s), i cili gjendet në kulmin e fuqisë shpirtërore dhe materiale. Allahu e urdhëron edhe atë, që të prijë me drejtësi dhe me barazi. (Sad 38/26). Në një farë mënyre, edhe Omeri (r.a) halifja i dytë i Profetit (s.a.u.s) e përforcon këtë princip. Me veprimtaritë që zhvilloi, me institucionet që formoi dhe me vendimet që mori, ai u bë njeriu i parë që përfitoi nga ky përgëzim që solli Profeti ynë (s.a.u.s). Ai përbën shembullin konkret të këtij principi që stabilizoi Islami. Për këtë arsye, ai është quajtur “Umeru adlun”, që do të thotë, “Omeri (r.a) është vetë drejtësia”.

Së dyti, Profeti ynë (s.a.u.s) bën fjalë për të riun që edukohet me dashuri dhe respekt ndaj adhurimit. Këta janë kategoria e dytë e njerëzve që do të strehohen nën hijen e arshit të Allahut. Të rinjtë që eduko-





hen prej vegjëlisë me vetëdijen e besimit, të cilët ecin me kokën lart dhe pa u ndarë nga rruga e drejtë, në kohën kur iu zjen gjaku dhe kur mjedisi përreth tyre është mbushur përplot me qendra joshëse. Të rinjtë që përkushtohen me kujdes, me dashuri, me energji dhe dinamizmin në këtë rrugë...

Në Kur'anin Famëlartë kemi shembullin e "Shokëve të shpellës". Allahu shprehet me lëvdata për këta të rinj sakrifikues! Që në fillim, përreth Resulullahut ka patur gjithmonë të rinj. Çështja e shenjtë e Islamit është lartësuar mbi supet e këtyre të rinjve të devotshëm. Janë ata që mundohen dhe punojnë për t'ia mësuar vets dhe të tjerëve Kur'anin në Mekke. Janë përsëri ata që qëndrojnë në krye të luftës në Medine dhe në përhapjen e Islamit në vënde të ndryshme. Aliu (r.a) është shembulli më i mirë i atyre që e kanë kushtuar jetën e tyre në rrugën e Allahut. I pari që besoi, i pari që rrezikoi jetën në kohën e hixhretit, Luani i Allahut në Bedir dhe Uhud, Aliu (r.a).

Së treti, vjen ai zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë. Pra, besimtari në zemrën e të cilit ndodhet

një dashuri e pashoqe për xhaminë. Një vakt namaz e ka falur dhe pret me padurim të vijë vakti tjetër. Një njeri shumë i përkushtuar në faljen e namazit në xhami dhe në ripërtëritjen e sunnetit. Xhamia ujë dhe besimtarët peshq! Si mos ta dojë xhaminë besimtari? Në kohën kur Resulullahu (s.a.u.s) emigroi për në Medine, puna e parë që bëri ishte ndërtimi i një xhamie dhe ai vetë mbajti gurë në supet e tij. Zemra e muslimanëve dhe pulsi i bashkësisë Islame rreh gjithmonë nëpër xhamia. Bashkimi, vëllazëria është aty. Ndihma dhe solidariteti janë aty. Libri i Allahut lexohet aty, emri i Tij përmendet aty dhe njerëzit po prej aty thirren për në shpëtim. Xhamitë janë projektimi i mëshirës që zbret nga Qabja. Mëshira gurgullon në xhami, qetësia zbret në xhami. Ja pra, për këtë arsye besimtarët që kanë dashuri për xhaminë dhe xhematin dhe që ndjejnë dëshirën për shërbim ndaj xhamisë, do të jenë nën hijen e arshit në ditën e kiametit.

Së katërti, Profeti ynë (s.a.u.s) na tregon për **ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut**. Midis tyre nuk ka ndonjë interes të kësaj bote por ka vetëm një miqësi të pastër dhe pa pretendime. Kur bashkohen, bashkohen për hir të Allahut duke shpresuar kënaqësinë e Tij. Madje, edhe kur ndahen, ndahen për hir të Tij dhe shpresojnë kënaqësinë e Tij. Dhe kjo dashuri midis tyre vazhdon deri në fund të jetës. Çfarë ka më me vlerë në jetë se sa një mik i sinqertë? Të dimë që kemi një mik të sinqert dhe besnik, që e duam dhe e duan, na jep një qetësi të madhe shpirtërore. Një pjesë e bukurisë së jetës përbëhet nga miqësia e ngrohtë, nga ajo miqësi që nuk bazohet në interesa...

Në Kur'anin Famëlartë flitet për miq që do të jenë armiq në ditën e kiametit. Mirëpo, miqtë e vërtetë do të jenë larg kësaj. (Zuhruf 43/67) Në një vend tjetër tregohet për dikë që meriton dënimin dhe ky me një pendim të thellë thotë: **"Ah sikur të mos isha mik i filanit!"** (Furkan 25/28) Sa miqësi e bukur është ajo e të Dërguarit të Allahut (s.a.u.s) me sahabët e Tij si Ebu Bekri dhe Omeri (r.a)! Përfytyroni për pak çaste tabllon e sinqertë që ekspozojnë këta miq të ngrohtë, të cilët bisedojnë të ulur pranë një pusi!

I pesti është ai që i jep një rëndësi të veçantë, nderit dhe namusit. **Një grua me pushtet i propozon këtij marrëdhënie të pamoralshme dhe ky e refuzon atë duke thënë, "unë i friksohem Allahut"**. Sa virtut i

madh është nderi! Për çfarë virtytësh mund të bëhet fjalë, nëse në një popull ka humbur ndjenjat e nderit dhe namusit!? Ja pra, ajo që na e siguron këtë ndjenjë është devotshmëria. Pra të jesh i vetëdijshëm kundrejt përgjegjësive që ke ndaj Allahut.


Ato që ka jetuar Jusufi (a.s) janë të njëjta me ato që na ka treguar Resulullahu (s.a.u.s). Të gjithë e dimë ndodhinë. Në suren Jusuf ajo jepet me detaje. Mirëpo, përgjigja e atij njeriu të lartë ndaj një propozimi të pamoralshëm është shumë ndikuese: **“Allahu më ruajtë nga kjo gjë. Si mund të bëj këtë pasi që Allahu më ka dhuruar këto mirësi.”** (Jusuf 12/23) Në rrethin që jetonte Jusufi (a.s), edhe burrat edhe gratë ishin zhytur nga koka tek këmbët në imoralitet. Jusufi (a.s) e pa më të arsyeshme të qëndronte në burg, se sa të jetonte pa ndjenja në një rreth të tillë: **“Ai (Jusufi) tha: “O Zoti im, burgu është më i dashur për mua, se sa ajo që ma ofrojnë ato mua...”** (Jusuf 12/33) Lutja e Profetit tonë (s.a.u.s) do të na ndihmojë në këto raste: “Allahu im, dëshiroj prej teje që të jem në rrugë të drejtë, të përqafohem me devotshmërinë dhe të jetoj me nder.” Gjithashtu, edhe zotëruesi i dy dritave në kohën e Profetit, Osmani (r.a), na ndriçon rrugën me ndjesinë e tij të veçantë ndaj nderit dhe turpit!


Për sa i përket të gjashtit, Profeti ynë (s.a.u.s), me këtë nënvizon një pikë të rëndësishme. Pra, **dora e majtë e atij që bën mirë nuk duhet të dijë se ç'bën dora e djathtë.** Kështu që, ai njeri mirësinë e bën në mënyrë të fshehtë. Sepse qëllimi i tij është vetëm kënaqësia e Allahut. Ai nuk e bën këtë për sy e faqe. Në ajetin e ndershëm shprehet se të japësh haptas është mirë, por të japësh fshehtas është edhe më mirë, (Bakara 2/271). Profeti ynë i dashur, çështjen e fshehtësisë e ka shprehur në një mënyrë shumë interesante, për arsye që ai i cili merr lëmoshë të mos turpërohet midis të tjerëve. Atë që jep dora e djathtë të mos e dijë e majta! Sigurisht, edhe njerëzit që marrin lëmoshë kanë një ndjenjë

nderi dhe krenarie. Prandaj, kur të jepet, duhet të jepet pa i cënuar ndjenjat e tyre. Ja pra, edhe ata që e kanë këtë ndjesi, do të jenë nën hijen e arshit.

I shtati dhe i fundit është **ai që e përmend Allahun dhe të Dërguarin e Tij kur gjëndet i vetmuar.** Ky njeri është aq i mbushur me dashuri ndaj Allahut, sa që nga sytë e tij rrjedhin lot. Dashuria hyjnore ia djeg zemrën. Zemra e shuan zjarrin dhe shpirti e ujit tokën me lotët e tij. Kur e përmend Allahun dhe e lexon librin e Tij, zemra i rrënqethet dhe i mbushet me devotshmëri dhe mëshirë. Shpirti i tij fiton butësi dhe pastërti! Edhe Profeti ynë (s.a.u.s) i ka kaluar disa nga netët e Tij i mbytur në lot. Kryen adhurim, lexon Kur'an dhe derdh lot i Dërguari i Allahut (s.a.u.s). Edhe shoku i Tij më i ngushtë Ebu Bekri (r.a) kishte një zëmër të tillë. Në mesxhidin që ndërtoi përpara shtëpisë së tij në Mekke, lexonte Kur'an duke qarë. Vajza e tij Aishe (r.a) na e tregon atë si “një njeri me zëmër të butë dhe sylagur”. Mirëpo këtë nuk mund ta shpjegosh dot me fjalë, nëse nuk e jeton, nuk e kupton.

Hadithi ynë fillon me materialen dhe mbaron me shpirtëroren. Në këtë fe, rëndësia që i jepet rregullimit të jetës së kësaj bote është po aq e madhe sa edhe rëndësia që i jepet forcimit dhe pasurimit të botës shpirtërore të njeriut. Me këtë hadith, i Dërguari i Allahut (s.a.u.s) na ka paraqitur një manifestim të principeve universale të Islamit. Ky hadith është si një ylber që pasqyron shtatë ngjyrat themelore të diellit Islam. Ai nxjerr në pah ngjyrat që i jep Islami këtyre vlerave, që nga principi i lidhur me shtetin, marrëdhëniet shoqërore, kujdesi që duhet treguar në punë të mira dhe deri tek rëndësia që kanë marrëdhëniet e njeriut me Allahun. Nëse e marrim numrin shtatë si një kuptim figurativ të shumicës, pra simbolin që tregon një sasi të madhe, do të shikojmë se këto pika janë dimensione që zgjaten për tek principet e tjera.





Psikologjia e mëkatit dhe pendimit

Hasan Kamil Jellamz

*T*ë mëkatosh dhe pastaj të pendohesh, është një veti e njeriut. Ëngjëlli nuk ka nevojë të pendohet, për shkak se nuk bën mëkat. Kafsha është larg vetëdijes së mëkatit dhe pendimit, për shkak se është e privuar nga mendja. Ndërsa shejtani për shkak se nuk u pendua për mëkatin që bëri, edhe ai është i privuar nga nderimi për t'u penduar.

Allahu e ka krijuar njeriun me një status të ndryshëm nga ëngjëlli dhe djalli. Kështu që ai është i aftë të bëjë mirë dhe keq, sevap dhe mëkat, mirësi dhe ligësi. I Dërguari i Allahut s.a.v. e shpjegon kështu këtë të vërtetë: "Sikur ju të mos bënit asnjë mëkat, Allahu në vendin tuaj do të krijonte një popull mëkatar e pendues dhe pastaj do t'i falte ata."¹ Sikur aftësia e mëkatimit është një pjesë e personalitetit të njeriut. Faktikisht njeriu erdhi në këtë botë për shkak se mëkatoi. Cilësia e njerëzisë vazhdon me këtë.

Njeriut të cilin e krijoi të nderuar në ahsen-i takvim (mënyrën më të përsosur) me cilësinë e mëkëmbësit në tokë, Allahu i tërheq vëmendjen nga mëkati

1. Muslim, Teube, 10.

i hapur e i fshehtë, ashtu që ai të mos bierë në gropën e mëkatit dhe i fton në pendim ata që kanë rënë në mëkate, duke i lajmëruar se do t'ua mbulojë mëkatet e vogla atyre që largohen nga mëkatet e mëdha. Allahu i madhëruar thotë: "Mos bëni mëkate as haptas dhe as fshehtas, sepse ata që bëjnë mëkat do të ndëshkohen për mëkatin e bërë."² "Nëse largoheni prej mëkateve të mëdha të cilat ua kemi ndaluar, Ne ua mbulojmë mëkatet e vogla dhe ju fusim në një vend të ndershëm."³

Shpirti i njeriut i cili është i fryrë nga shpirti hyjnor, ashtu siç e shpreh Kur'ani, pasi të vijë në këtë botë duke hyrë në kafazin e trupit, siç e shpreh Mevlana, sëmuret me mosbindje ndaj Allahut dhe fillon të bierë në mëkate duke e harruar kështu fjalën që ia ka dhënë Atij. Sipas Mevlanës, mënyra për t'u mbrojtur dhe për t'u pastruar nga mëkati është kujtimi i premtimit dhe i betimit kur Allahu na ka pyetur elestu bi rabbikum. Mevlana thotë:

Vendos në vetvete një kusht dhe përpiqu që ta mbash premtimin!

2. el-En'am, 6/120.

3. en-Nisa, 4/31.

Nëse nuk e mban premtimin, dije se nuk mund të përparosh me sëmundje shpirtërore

Kur gjendja jote t'i përshtatet premtimit për të qëndruar i pastër, të cilin e ke dhënë në ezal

Atë çast lindin me mijëra kënaqësi që ka fituar shpirti yt

Në këtë mënyrë zemra jote bëhet si hekur

Dhe ty në çdo çast të shfaqet një pjekuri

Për shkak se ke marrë përsipër amanetin, ty shpirti në botën e dëshirave

Të bëhet edhe muzikant edhe shfaqës i gotës debëse të dashurisë

Pastaj të dhimbsen punët boshe të njerëzve të udhëzuar

Thesarin e fshehtë e gjen te vetvetja dhe e njeh atë.⁴

Takimi me Allahun, shpëtimi nga adhurimi i robit, nga adhurimi i vetes, i shejtanit, i epshit dhe nga adhurimi i mëkatit, mënyra e arritjes së kënaqësisë së Allahut duke pirë sherbetin e dashurisë në zemër, është mos'harrimi i premtimit dhe i betimit.

Psikologjia e mëkatit dhe fajit formon te njeriu reagime reflekse. Fajësia në ndërjegje sjell ngushtim të zemrës. Ndjenja e keqardhjes vë në lëvizje te njeriu psikologjinë e pendimit dhe gjendjen shpirtërore për t'u pastruar nga mëkati. Me pendimin që bëhet në mënyrë të përshtatshme me kushtet e tij, e ndalon veten nga njollosja me mëkat, nuk e lejon të nxihet dhe së fundi e mbron zemrën nga ngurtësimi. Ndërsa mëkati pa pendim e bën zemrën të papastër. Kështu që Allahu i madhëruar thotë: *"Jo! Përkundrazi (mëkatet) që bënëin ata ua mbuluan zemrat e tyre."*⁵ Pastrimi i njeriut nga papastërtitë e mëkatit ia ndriçon atij të dy botërat. Mevlana në *Divan* thotë:

Nëse e pakëson tymin në shtëpinë e zemrës dhe e pastron atë nga papastërtitë e mëkatit, drita jote ndriçon në të dy botët, në këtë botë dhe në botën tjetër.

Nëse shikon ujin e turbullt, aty nuk mund të shikosh as hënë dhe as qiellin! Kur bie mbrëmja fshihet dielli dhe hëna!⁶

Për t'u pastruar nga papastërtitë shpirtërore, për t'u pastruar nga mëkatet dhe për t'i sfiduar ato duke ecur hap pas hapi, duhet të takohemi me Allahun duke përparuar ashtu siç u ka hije të dashuruarve me Alla-

4. Shefik Xhan, Pjesë të Zgjedhura nga Divani Kebir, vëll. 1, fq. 251.

5. el-Mutaffifin, 83/14.

6. Pjesë të Zgjedhura nga Divani Kebir, vëll. 1, fq. 102.

Nëse e pakëson tymin në shtëpinë e zemrës dhe e pastron atë nga papastërtitë e mëkatit, drita jote ndriçon në të dy botët, në këtë botë dhe në botën tjetër.

hun. Në fakt, Allahu dëshiron që njerëzit t'i pastrojnë zemrat e tyre me lot e pendim, ashtu që të pastrohen nga mëkatet, të forcojnë vullnetin e tyre me adhurim e sexhde dhe njofton se *"Namazi e largon njeriun nga çdo ligësi dhe nga gjërat e shëmtuara."*⁷ Sepse është e pamundur që njeriu të bjerë në mëkat duke thënë Allah me gjithë zemër. Ai i cili i nënshtrohet epshit, mbytet në mëkate dhe papastërti shpirtërore.

Të gjitha vetitë e mira vijnë nga zemra, ndërsa burimi i të gjithë ligësive është trupi i cili është krijuar nga balta. Atij që ndjek veten dhe i nënshtrohet epshit, i trashet më shumë balta e trupit, i shtohet dhe ai mbytet më shumë në mëkate dhe papastërti shpirtërore. Ndërsa dembelizmi në çështjen e lënies së dëshirave vetjake e dobëson njeriun. Ndërkohë, ai i cili i mposht dëshirat dhe pasionet vetiake arrin qetësinë duke i kapërcyer të gjitha vështirësitë.

Njeriu, qoftë qafir, qoftë i prishur apo qoftë imoral, të gjithë i shqyejnë me duart e veta perdet e mëkateve të mbuluar ndërmjet të fshehtave shpirtërore dhe i shtrojnë ata përpara syve të njerëzve. Ai njeri i cili i ekspozon këto duke i shqyer perdet e mëkatit, sipas Mevlanës pothuajse thotë kështu: *"Më shikoni mua! Unë kam brirë. Shikojeni haptaz mëzatin e xhehennemit, domethënë banorin e xhehennemit! O njeri i padrejtë! Dora dhe këmba jote dëshmon edhe në këtë botë për atë gjë që ke të fshehtë në zemrën tënde dhe thotë: "Këtu ka një njeri të fshehtë. Mos e pandeh veten të vetmuar!"*. Veçanërisht kur je i zemëruar dhe kur përgojon, e fshehta dhe bota shpirtërore e nxjerrin këtë në shesh me të gjitha detajet.

7. el-Ankebut, 29/45.



Padrejtësitë që ke bërë e vuajtjet që u ke shkaktuar të tjerëve të vijnë te koka si një polic dhe të thonë: “O dorë e këmbë, nxirrini në pah ato që keni bërë e mos i fshihni!”⁸ dhe pastaj e brejnë zemrën e njeriut.

Edhe puna e ëngjëjve ‘Kiramen Katibin’ është që të shkruajnë veprat tona të mira dhe jo që të shkruajnë veprat e këqija, apo jo? Në të vërtetë, edhe zemra jonë, shpirti ynë dhe ndërgjegjja jonë, ashtu si dhe ëngjëjt kanë për detyrë të regjistrojnë ato gjëra që kemi bërë. Këto regjistrime qëndrojnë në zemrën tonë si qetësi e rehati, ose si diçka që na përvëlton nga brenda. Nëse këto ndjenja kontrollohen mirë, mund ta mbrojnë njeriun që të mos bierë në mëkat.

Njeriun që ka rënë në mëkat, Mevlana e përngjason me gomarit që ka rënë në baltë dhe thotë: Edhe një gomar, nëse ka rënë në baltë duke menduar që të ecë shpejt, mundohet të ngrihet për të shpëtuar. Ai nuk mundohet të qëndrojë aty dhe ta rregullojë vendin ku ka rënë, ashtu që të vendoset. Sepse e di që në atë vend nuk jetohet. A është ndjenja jote më poshtë se

8. Shefik Khan, Përkthimi i Mesnevisë, III-IV, fq. 130, rreshti nr: 2455.

ndjenja e gomarit që nuk ngrihet nga balta e vetive të këqija, e mëkateve dhe pasioneve të kësaj bote? Kur bën mëkat, bën edhe komente, përpiqesh ta nxjerrësh veten në të drejtë dhe nuk dëshiron ta nxjerrësh zemrën nga ndjenjat që të ulin ty. “Çfarë të bëj, nuk kam mundësi të bëj asgjë. Allahu është bujar. Nuk e shikon fajin e robit të paaftë”.⁹

Njeriu, ashtu sikundër ka thënë poeti, ka të drejtë të thotë:

*Sado që të jemë fajtor, nuk e pres shpresën
Nga bujaria e Tij e cila është sa deti dhe oqeani*

Ai që bën mëkate duke i neglizhuar, nuk duhet ta harrojë të vërtetën se do të hyjë në xhehennem duke u nënçmuar. Ndjenja e shpresës nuk duhet ta shpjerë njeriun që të bëjë mëkat pa kufi dhe pa përgjegjësi.

Amr bin Osmani, i cili ishte prej miqve të Allahut, ishte shumë i ndjeshëm në çështjen e pendimit. Çdo-kënd që bënte mëkat, e inkurajonte që të pendohej dhe thoshte: “Pendimi është farz (obligim) për këdo që bën mëkat të madh apo të vogël. Pasi të bësh një herë mëkat, askush nuk mund të justifikohet në çështjen e lënies së pendimit. Sepse Allahu i ka kërcënuar mëkatarët. Ky kërcënim hyjnor mund të shuhet vetëm me pendim.”

Muhammed b. Vasi, i cili ishte prej sulltanëve shpirtërorë, thotë: “Sikur çdo mëkat të kishte erë, ju nuk do të më afroheshit dot mua për shkak të erës së keqe. Ashtu sikundër është e habitshme të shikosh në xhennet një njeri që qan, po aq e habitshme është të shikosh edhe në këtë botë një njeri që qesh dhe që nuk qan.”

Kur e pyesnin “Si je?” përgjigjej:

–“Siç mund të jetë ai njeri që i pakësohet jeta, i shtohen mëkatet dhe që çdo ditë i afrohet një shkallë vdekjes, ashtu jam edhe unë”. Dhe i këshillonte që të mos e harronin vdekjen dhe botën botën tjetër.

Pikëllimi për mëkatin dhe shpresa e pendimit formon te njeriu përpjekjen për t’i bërë veprat me ndjenjën e mirësisë dhe njëkohësisht psikologjinë e mëkatin dhe pendimit.

9. Shefik Khan, I-II, fq. 512, rreshti nr: 3355.

PENDIMI

Jashar Kandemir

Djalli e mashtron njeriun dhe e orienton për të bërë mëkat.

Sepse djalli është armiku i njeriut.

Edhe njerëzit me besim të fortë gabojnë nga shkaku i joshjeve të shejtanit.

Shkurtimisht, të gjithë mund të mëkatojnë përveç atyre që i mbron Allahu.

Çdo mëkat që bëhet, lë gjurmë në zemër, si një pikë e zezë. Nëse robi i largohet mëkatit që ka bërë, i drejtohet Allahut dhe kërkon falje nga Ai, zemra e tij e arrin përsëri pastërtinë e mëparshme. Por nëse nuk vepron kështu dhe vazhdon të bëjë mëkate, pikat e zeza në zemër i shtohen. Ajeti “Jo, mëkatet që bëjnë ata ua kanë nxirë zemrat”, flet për këto pika të zeza.

LARGIMI NGA MËKATET E VOGLA

Njerëzit në përgjithësi nuk u japin rëndësi mëkateve të vogla dhe nuk e shikojnë si problematike kryerjen e tyre. Ky konceptim bëhet shkak që të shtohen mëkatet.

Shërbëtori i Pejgamberit, Enes bin Malik shpreh me keqardhje se në vitet pasi ndërroi jetë i Dërguari i Allahut s.a.v., njerëzit filluan të neglizhonin në këtë çështje dhe i shikonin si të thjeshta e të parëndësishme veprat që në kohën e të Nderuarit tonë llogariteshin si mëkate të mëdha.

Por i Dërguari i Allahut s.a.v. e këshilloi bashkëshorten e tij të dashur, Hz. Aishe që të largohej nga mëkatet që njerëzit i nënçmonin dhe i kujtoi asaj se ka ëngjëj të cilët i shikojnë dhe i rregjistrojnë mëkatet e vogla.

Ai lajmëroi se mëkatet që duken të vogla, e gëzojnë shumë shejtanin e mallkuar.

DUHET TË PENDOHEMI SA KEMI NË KOHË

Ja, për këtë arsye Allahu Teala i urren mëkatet dhe dëshiron që ne t’ua kthejmë shpinën atyre,

Dëshiron që t’i kthehemi Atij duke u penduar me gjithë zemër dhe duke ndjerë keqardhje,

Ai pret që t’i përgjerohe mi, ashtu që të na falë,

Dhe thotë se vetëm atëherë mund të na i falë veprat tona të këqija.

Sepse vetëm Allahu është ai që i pranon pendimet e robërve, që ua fal të këqijat dhe i cili e di çdo gjë që veprojnë.

Meqë e vërteta është kjo, atëherë nuk duhet të vonohemi për t’u penduar, ashtu që t’i kthehemi e t’i dorëzohemi Allahut para se të vijë vdekja.



Kur të mos veprojmë kështu, duhet të dimë se askush nuk ka fuqi ta mbrojë njeriun nga problemet që mund t'i ndodhin në të ardhmen.

Por sa keq që shumë njerëz janë tolerantë në këtë çështje, vazhdojnë të bëjnë vepra të këqija deri në çastin e vdekjes, dhe kur u vjen vdekja kërkojnë të falen, duke thënë “Tani po pendohem”.

Por Allahu Teala kurrë nuk i pranon pendimet e atyre që veprojnë kështu.

SHEMBËLLTYRA PROFETIKE

Pejgamberi ynë i Nderuar ka qënë shembull për ne edhe në këtë çështje. Edhe pse ishte përgëzuar me faljen e mëkateve, ai pendohet duke kërkuar falje nga Allahu nganjëherë **shtatëdhjetë herë në ditë** dhe nganjëherë **njëqind herë në ditë**.

Madje nganjëherë edhe në vendin ku ishte ulur i përgjerohej Allahut duke thënë njëqind herë:

“O Zoti im! Më fal mua dhe ma prano pendimin tim! Me të vërtetë Ti je mëshiruesi që i pranon pe-

ndimet”.

Njeriu duhet të turpërohet nga Allahu për të keqen që bën, duhet ta vrasë ndërgjegja dhe të pendohet për gabimin që ka bërë.

Mënyra më e mirë për t'u bërë pishman është pendimi.

Kur robi të bëjë ndonjë mëkat, duhet të lutet ‘O Zot, të lutem më fal!’

Kjo quhet **istigfar**.

Të pendohesh do të thotë të ndjesh keqardhje për mëkatet që ke bërë.

ALLAHU E DO ATË QË PENDOHET

Allahu gëzohet shumë kur robi pendohet. I Nderuari ynë këtë fakt e përngjason kështu: Kur robi pendohet, Allahu gëzohet më shumë se sa njeriu i cili e humb devenë e tij në shkretëtirë bashkë me ujin e ushqimin dhe e gjen atë ndërkohë që po ballafaqohet me vdekjen.

Përse pendimi i një njeriu e gëzon kaq shumë Allahun Teala?

Për shkak të mëshirës së madhe që ka për robin e Tij.

I Dërguari i Allahu thotë se për shkak të kësaj dashurie dhe mëshire, Allahu i Lartësuar pret tërë natën që t'ia pranojë pendimin atij që ka bërë mëkat ditën, dhe pret tërë ditën që t'ia pranojë pendimin atij që ka bërë mëkat natën.

DERA E PENDIMIT ËSHTË GJITHMONË E HAPUR

Nuk ka ndonjë kohë të caktuar për t'u pastruar duke u penduar.

Një njeri mund të pastrohet nga mëkatet duke u penduar, përderisa nuk ka filluar të japë shpirtin. Një pendim i bërë me sinqeritet i fshin dhe i shkatërron të gjitha mëkatet përveç hakut të robit.

Ndërsa haku i robit mund të falet vetëm duke u paguar apo duke u bërë hallall.

Në kohën e Pejgamberit tonë të Nderuar, një grua kishte bërë zina. Ajo u pendua shumë për atë që kishte bërë. Peshën e mëkatit që kishte bërë e ndjeu në ze-

mër, shkoi disa herë te i Dërguari i Nderuar dhe duke këmbëngulur i tha se dëshironte ta merrte ndëshkimin në këtë botë dhe se nuk dëshironte ta linte për në botën tjetër. Ajo u ndëshkua.

Njëri prej sahabëve të rëndësishëm e nënvlerësoi gjendjen e gruas. Hz. Pejgamber nuk e pa të drejtë këtë sjellje të tij. Ai tha se ajo grua është penduar me gjithë zemër dhe nëse pendimi i saj do t'u shpërndahej shtatëdhjetë banorëve të Medinës, do të mjaftonte për t'u falur të gjithë ata.

Ajo që e bën të vlefshën pendimin është:

Të të shqetësohet zemra dhe të pendohesh për shkak të mëkatit që ke bërë,

Mëkatari duhet ta lërë plotësisht atë sjellje të keqe,

Dhe të japë fjalën se nuk do ta bëjë më atë asnjëherë.

Nëqoftëse çështja ka lidhje me hakun e robit, atëherë ai duhet t'i kërkojë atij të cilit i ka hyrë në hak që ai ta falë.

TË DIMË SE KA NJË ZOT

Nëse myslimani largohet nga mëkatet e mëdha, Allahu mund t'ia falë mëkatet e vogla që ka bërë, sepse Ai është bujar në çështjen e faljes.

Të dish se ka një Zot që t'ia fal mëkatet dhe të kërkojë falje sinqerisht duke iu drejtuar Allahut, kjo mjafton për t'ia fshirë mëkatet.

Sipas asaj që na ka njoftuar i Nderuari ynë, kur një rob i përgjërohet Zotit 'O Zot! Unë bëra një mëkat, të lutem më fal!' pasi ka bërë një mëkat me dashje, Allahu Teala thotë:

“Domethënë robi im e di se ka një Zot që mund t'ia falë mëkatin apo ta ndëshkojë. Atëherë edhe unë e fal robin tim”.

Nëse ai rob jeton për një kohë pa bërë mëkate, pastaj bën mëkat përsëri dhe vepron në të njëjtën mënyrë duke iu drejtuar Zotit dhe duke i kërkuar falje, Allahu Teala kënaqet nga robi për shkak se iu drejtua Atij dhe e fal atë.

Nëse robi e kupton gabimin pasi të bëjë një mëkat, e kujton Zotin, i drejtohet Atij dhe pendohet, kjo e kënaq shumë Allahun dhe Ai thotë “Tashmë robi im



le të bëjë ç'të dojë”.

Ky përgëzim hyjnor u sjell flade mëshire zemrave besimtare dhe i ndalon mëkatat që të bien në batakun e pesimizmit.

PO NËSE NUK MË MJAFTOJNË MIRËSITË E MIA!

Allahu i Lartësuar ka premtuar se mirësive do t'u japë sevape të shumfishuara.

Ka thënë se nganjëherë një mirësi do ta shpërblejë me **dhjetëfishin** e saj.

Po ashtu ka thënë se nganjëherë do t'ia japë sevap nga **dhjetëfish** e deri në **shtatëqind fish**, madje edhe më shumë.

Kjo masë mëshire tregon se një pendim i sinqertë mund ta fshijë dhe ta zhdukë një mëkat edhe nëse është sa malet.



I singerti është edhe i ndershëm

Rrustem Spahiu

Muslimani i vërtetë ka marrëdhënie të singerta dhe të ndershme me Allahun xh.sh., me librin e tij, Pejgamberin e tij, prijatarët e muslimanëve, si dhe me muslimanët e thjeshtë. Në hadithin e transmetuar nga Muslimi thuhet se i dërguari i Allahut ka thënë: “Feja është ndershmëri e singëritet”. “Ashabët e pyetën: ndaj kujt”? U përgjigj: “Ndaj Allahut, ndaj librit të tij, ndaj Pejgamberit dhe ndaj udhëheqësve të muslimanëve dhe muslimanëve të thjeshtë”. Pra, nuk na habit fakti se muslimani është i singertë dhe i ndershëm ndaj vëllezërve të tij, që nuk i mashtron dhe nuk i gënjen ata.

Te muslimani i përsosur, singëriteti dhe ndershmëria mbështeten në themelet e Islamit, gjë për të cilën besimtarët e parë e kanë dhënë shembullin më të mirë, duke iu betuar Pejgamberit të Zotit. Këtë e vërteton edhe Xherir ibn Abdullah r.a., i cili thotë: “Kam vërejtur te Pejgamberi a.s., gjatë kohës së namazit, dhënies së zeqatit, kishte raporte të singerta dhe të ndershme me secilin mysliman”. Nga hadithi i cituar, shihet se Pejgamberi i nderuar e ka përkufizuar fenë me një fjalë, me singëritetin, kështu që është argument që tregon se marrëdhëniet e singerta janë bazë e besimit dhe e forcimit të tij, dhe se pa të nuk vlen asnjë besim dhe asnjë islam i dikujt. Këtë e vërtetojnë edhe fjalët e Pejgamberit të nderuar: “Askush nuk ka besuar prej nesh, përderisa nuk ia dëshiron vëllait të vet atë që ia dëshiron vetes”. Ai mund t’ia dëshiroj atë që ia dëshiron vetet vetëm atëherë kur e do me singëritet të plotë.

Është me të vërtetë e vështirë që të arrihet stadi në të cilin njeriu ia dëshiron vëllait të vet atë që ia dëshiron edhe vetes. Mirëpo, nuk është e pamundur që në ndjenjat e njeriut të mbillet dashuria në atë masë, sa të mund t’ia dëshirojë vëllait të vet atë që ia dëshiron vetëm vetes, e ky është një nga kush-

tet e mësimit se feja është singëritet dhe ndershmëri. Madje, kjo bëhet sjellje e natyrshme te muslimanët e vërtetë dhe të singertë, zemrat e të cilëve janë të mbushura me kthjelltësinë e Islamit. Historia jonë bashkëkohore dhe ajo e vjetër, është e mbushur plot me argumente të cilat dëshmojnë për shembujt kur muslimani ia dëshiron vëllait të vet atë që ia dëshiron edhe vetes. Kësisoj, më bie ndërmend ajo që rrëfejnë pleqtë nga brezat e kaluar në lidhje me tregtarët në qytetet e Shamit, të cilët ishin të tubuar në esnafe: esnafet e shitjes së erërave të mira, të përpunuesve të lëkurave, të rrobaqepësve, si edhe esnafe të tjera të vjetra, të cilat ishin të vendosur nëpër pazaret e mbuluara. Nëse ndonjërit prej tyre i vinte klienti dhe i blinte diçka, e pastaj i vinte edhe një tjetër, ndërkohë që fqinji i tij tregtar nuk ishte shitur ende asgjë, ai do ta luste myshteriu me dashamirësi që të kalonte te fqinji dhe ta blinte atë që i nevojitej”.

O Zot, çfarë jetë e lumtur, interesante dhe e kënaqshme do të ishte sikur të jetonim nën hijen e një vëllazërie të këtillë! Sa të lumtur do të ishin të gjallët, sikur nëpër shpirtrat e tyre të kalonte fryma islame dhe nëse nëse do të mbizotëronte dashuria islame në komunikim e në punë të tjera. Në të vërtetë ata do të jetonin nën kulmin e asaj që njeriu mund ta arrijë, nëse do të jetonin në kraharorin e fesë, e cila mëson se “Feja është ndershmëri dhe singëritet” dhe se njeriu nuk do të mund të jetë besimtar, përderisa nuk dëshiron për vëllanë e vet atë që e dëshiron për vetë.


Mbi bazat e kësaj logjike të mirë e kanë arritur dashurinë dhe singëritetin e vërtetë ashabët e dashur. Ashabi i nderuar Ebu Hurejre r.a., ka thënë: “Besimtari është pasqyrë për besimtarin, nëse sheh në të ndonjë të metë e përmirëson”.

Ebu Hurejre r.a ka deklaruar se në bazë të udhëzimeve të Pejgamberit të nderuar, “Besimtari për besimtarin është pasqyrë dhe besimtari për besimtarin është vëlla. Ai ia ruan punën dhe ia mbron shpinën. Sipas gjërave të natyrshme, muslimani i vërtetë dhe i sinqertë ka qëndrim fisnik dhe të mirë ndaj vëllait të vet, ashtu që edhe kur dëshiron të marrë ndonjë qëndrim tjetër, ai nuk do të mund ta bënte këtë. Thjesht nuk është e mundur që dikush, i cili jeton në këtë jetë të ndritshme, t’i rrëzojë pikëpamjet e tij në nivelin e individualizmit, egoizmit dhe të interesave personale. Secila enë ka erën e atij ushqimi që gjendet në të. Lulja jep erën e lules, toka pjellore jep frytet. Shumë bukur e ka thënë poeti: “A thua në tokën e Bahrejnit mund të mbijë diçka përveç palmave”.

Islami i bën pasuesit e vet që ta përqafojnë natyrshëm nderin dhe bamirësinë ndaj miqve të tyre, e kjo shtrihet edhe në miqtë e prindërve. Islami e çmon vlerën e nderit dhe e konsideron si lidhje të madhe vëllazërore e miqësore. Librat e trashëgimisë sonë janë të mbushur përplot me shembuj mbi vlerën e nderit dhe të bamirësisë, vlera të cilat paraardhësit tanë i kanë mishëruar në jetën e tyre, me moralin dhe me drejtësinë e tyre, duke u bërë populli më i mirë nga të gjithë popujt që kanë ekzistuar ndonjëherë. Për këtë që u tha më lart bën fjalë edhe hadithi i transmetuar nga imam Muslimi në Sahiun e vet, marrë prej Omerit r.a., sipas të cilit Pejgamberi a.s., ka thënë: “Bamirësia më e mirë është që njeriu ta mbajë gjithmonë lidhjen me atë që babai i tij e ka dashur”. Abdulla ibn Dinari tregon se gjatë rrugës për në Mekë, Abdulla ibn Umeri r.a. takoi një beduin. Abdulla ibn Umeri e përshëndeti dhe e hipi atë në kalin e tij, duke i vënë në kokë turbanin e vet. Ibn Dinari thotë: “Ne e kundërshtuam këtë, duke i thënë: Allahu t’i dha këto të mira, ndërsa ky është vetëm një beduin, e ata kënaqen edhe me diçka që nuk ka vlerë”. Abdulla ibn Umeri u përgjigj: “Babanë e këtij e ka dashur shumë Omer ibn Enhatab r.a., ndërsa unë e kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: “Bamirësia më e mirë është që i biri të mbajë lidhje me familjen e atij të cilin e ka dashur babai i tij”.

Pejgamberi i Zotit a.s. është kujdesur edhe për zemrat e muslimanëve dhe në to ka mbjellë fidanin e ndershmërisë e të sinqeritetit, sa herë që ka pasur mundësi që t’i udhëzojë dhe t’i drejtojë ata në rrugë të drejtë. Njëherë i erdhi një njeri nga fisi Benuseleme dhe e pyeti: “O Pejgamberi i Zotit, a ka mbetur ndonjë vepër e mirë të cilën mund ta bëj për prindërit e mi pas vdekjes së tyre?” Pejgamberi u përgjigj: “Po, bëj dua për ta dhe kërko falje, përmbushi obligimet e tyre paguaji huat, mbaj lidhjet familjare me ata me të cilët je i lidhur nëpërmjet tyre dhe shfaq respekt ndaj miqve të tyre”.

Këmbëngulja e Pejgamberit të nderuar lidhur me sinqeritetin në miqësi, nganjëherë e ka zemëruar hazreti Ajshen r.a., sepse kishte të bënte me shoqet e Hatixhes, gjë që



“Besimtari është pasqyrë për besimtarin, nëse sheh në të ndonjë të metë e përmirëson”.

ngjallte xhelozinë e saj. Kështu, hazreti Ajshja rrëfen: “Nuk kam qenë xheloze me asnjërin nga gratë e Pejgamberit sa isha xheloze ndaj Hatixhes r.a., edhe pse asnjëherë nuk e kam parë. Mirëpo, ai shpeshherë e përmendte. Sa herë që therrnim ndonjë dele dhe e ndanim, ai iu dërgonte gjithnjë pjesë mikeshave të hazreti Hatixhes, ndërsa unë e kundërshtoja duke i thënë: sikur nuk kishte grua tjetër në këtë botë përveç Hatixhes. Ai më përgjigj: “Ajo ishte e veçantë dhe nga ajo i kam fëmijët”.

Në një version tjetër thuhet “Nëse e therrnim delen, mishin ua falte mikeshave të saja”.

Kjo është ndershmëria dhe sinqeriteti islam, që nuk ka të dytë. Ajo gjendet, duke e përfshirë me mirësinë e saj sinqeritetin edhe më përtej se miqtë e prindërve dhe të bashkëshortëve të vdekur. E çka duhet të bëjmë për miqtë tanë të gjallë?

Dashuria, sinqeriteti, mirësia dhe ndershmëria në legjislaicionin islam, nënkuptojnë që njeriu duhet ta ndihmojë vëllanë e vet në çdo situatë. Nëse ai ka të drejtë, e ndihmon dhe del në anën e tij, duke e nxitur dhe duke e mbrojtur. Nëse nuk ka të drejtë, e ndihmon në atë mënyrë që ia pamundëson veprimin e keq me këshilla të sinqerta dhe nuk e lë që të mbetet në baltën e asaj që është e padrejtë, pra e pengon të bjerë në moçalin e tiranisë dhe të padrejtësisë. Në lidhje me këtë Pejgamberi a.s. ka thënë këto fjalë: “Njeriu le ta ndihmojë vëllanë e vet, qoftë nëse bën të padrejtë, ose i bëhet e padrejtë. Nëse bën të padrejtë, le ta pengojë, se edhe kjo është ndihmë, e edhe nëse i bëhet e padrejtë le ta ndihmojë”.

Muslimani i vërtetë nuk heq dorë nga vëllai i vet, edhe nëse ai bën të padrejtë, apo nëse ndaj tij bëhet e padrejtë.

Këto janë cilësitë që i ka një musliman i vërtetë, i sinqertë, i mirë, dhe i cili e ngre lart Islamin kudo qoftë dhe kurdo qoftë.

KËMBIMI I jetës së pastajme me jetën e kësaj bote

Fatmir Hadri

Një nga gabimet më të mëdha që bëjnë jobesimtarët, është bindja se do të qëndrojnë gjithmonë në jetën e kësaj bote dhe mosdija se do të sprovohen. Në këtë botë ka shumë bukuri dhe kënaqësi që i mashtrojnë njerëzit dhe i nxisin të jetojnë të papërgatitur për botën tjetër. Në shoqëritë ku shpërfillet bota tjetër, që nga fillimi i ardhjes së tyre në këtë botë, njerëzit anojnë nga lakmia për të poseduar vlera materiale vetëm për veten e tyre. Në lidhje me njerëzit që jepen me lakmi pas stolitve dhe kënaqësive të kësaj bote, Allahu thotë kështu në Kuran:

Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, por tek All-llahu është e ardhmja më e mirë. Thuaj: “A t’iu kumtoj për diç shumë më të mirë se ato (kënaqësitë e dynjasë)? Për ata që janë ruajtur, ata kanë tek Zoti i tyre xhennete nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe aty do të jenë përgjithmonë, kanë edhe bashkëshorte të pastra e gëzojnë edhe kënaqësinë e All-llahut. All-llahu është i kujdesshëm për robët”. (Ali-Imran, 3:14-15)

Sipas këtyre dy ajeteve kuranore shihet qartë se njerëzit kanë shumë dëshira. Po edhe nëse i realizojnë ato dëshira të ajeteve kuranore që u përmenden më lart, nuk duhet ta harrojmë Krijuesin duke rendur drejt këtyre dëshirave. Nëse e harrojmë Atë dhe pasojmë këto dëshira, puna jonë nuk do të jetë në rregull. Në ajetet 45-46 të sures Kehf,

All-llahu e përshkruan në këtë mënyrë gjendjen e vërtetë të njerëzve që pasojnë me lakmi jetën e kësaj bote:

E ti (Muhammed) paraqitu atyre shembullin e kësaj bote që është si një ujë (shi) që Ne e lëshojmë nga qielli, e prej tij bima e tokës zhvillohet e shpeshtohet, saqë përzihet në mes vete, e pas pak ajo bëhet byk (pas tharjes) që e shpërndajnë erërat. All-llahu ka fuqi për çdo send. Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote, kurse veprat e mira (fyti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zot yt dhe janë shpresa më e mirë.

Siç tregohet në këto ajete kuranore, të gjitha këto stoli, bukuri e kënaqësi të llojllojshme që i përkasin kësaj bote, si pasuria, bashkëshortët, xhevahiret, fama, karriera... etj, nuk janë asgjë tjetër vetëm se mashtrime që shumë shpejt do ta humbasin vlerën dhe ekzistencën e tyre.

Por një pjesë e madhe e njerëzve nuk e dijnë se këto gjëra janë të përkohshme. Ata bëjnë çmos vetëm për t'i arritur këto. Disa mundohen vazhdimisht të grumbullojnë mall, disa përpiqen të fitojnë respekt nga njerëzit, disa përpiqen që të gjejnë bashkëshortë tërheqës dhe të mrekullueshëm, ndërsa disa të tjerë mundohen të bëhen më të suksesshmit në lëmin e tyre. Ata jepen aq shumë pas këtyre gjërave që përmendëm më lart, saqë këto gjëra i bëjnë që ta harrojnë krejtësisht jetën e amshueshme. Ata e konsiderojnë vdekjen si zhdukje dhe nuk mendojnë të përgatiten për jetën pas vdekjes.

Ndërsa dijetari islam Beduizzaman Said Nursiu nuk e përshkruan vdekjen si zhdukje, por si një shpagim për punët e bëra gjatë sprovave në jetën e kësaj bote. Dhe vazhdon:

“Në këtë gjithësi është e dukshme zhdukja, humbja dhe ndarja. Ndarje të vërtetë nuk ka, por ka bashkim. Humbje, zhdukje nuk ka, por ka përtëritje. Vdekja është transferim nga kjo botë e përkohshme për në botën e përherëshme.

Vdekja nuk është edhe aq e tmerrshme sa duket. Nën dritën e Kur’anit Famëlartë, në shumë pjesë të Risale-i Nur kemi dëshmuar në mënyrën më të qartë dhe të padyshimtë se vdekja e besimtarit është vetëm shkarkim nga detyrat e kësaj jete. Është pushim nga adhurimi, që ishte udhëzim dhe ushtrim në arenën e sprovave të kësaj bote. Gjithashtu, do të thotë bashkim me shokët dhe të afërmit, me 99 përqind të tyre që kanë kaluar në botën tjetër. Ka domethënie të kalimit në vendlindjen e vërtetë dhe vendbanimin e amshueshëm së lumturisë. Është gjithashtu edhe ftesë për kopshtet e xhenetit nga qelia e kësaj bote. Është koha të marrin pagesën nga bujaria e Krijuesit të Gjithëmëshirshëm, si shpërblim për shërbimin ndaj Tij. Duke qenë se kjo është e vërteta për vdekjen, atëherë ajo nuk duhet konsideruar si e tmerrshme, por përkundrazi, si hyrje për në mëshirë dhe lumturi.¹

Me fjalë tjera, është gabim i madh nëse mendohet se kjo botë është vendbanimi ynë i vërtetë. Në krahasim me jetën e pastajme, kjo jetë nuk zgjat as një minutë i plotë. Në një vend tjetër, Beduizzaman jep një shembull se sa e pakuptimtë është kur dikush zgjedh jetën e kësaj bote, në vend të jetës së pastajme:

Gjithashtu, ai flet vërtetë për ardhmërinë, duke e krahasuar ardhmërinë në këtë botë me një vegim. Ai flet me tepër seriozitet për lumturinë, duke theksuar se lumturia e kësaj kohe është vetëm si një shkrepëtimë e shpejtë vetëtime, në krahasim me diellin e amshueshëm.²

Myslmanët që janë në dijeni për këtë të vërtetë, nuk largohen nga kjo botë me hidhërim, por largohen me kënaqësi e lumturi. Ata shpresojnë se do ta marrin atë që ua premtuar All-llahu në jetën e amshueshme. Ata jetojnë me entuziazëm, duke shpresuar në mëshirën e Krijuesit. Në lidhje me gjendjen e atyre që menduan se kjo botë është e përherëshme, në Kur’anin famëlartë thuhet kështu:

Ata janë që në vend të udhëzimit e morën humbjen dhe dënimin në vend të shpëtimit. Sa të durueshëm qenkan ata ndaj zjarrit?” (Bekare, 2:175).

Në një ajet tjetër thuhet se ata kanë bërë një gabim të madh “duke e blerë mosbesimin me çmim të besimit”. Do

të përpiqemi të japim një shembull për ta kuptuar me lehtë gjendjen e këtyre personave që gjenden në një humbje të tillë:

Përfytyroni dy njerëz! Këtyre dy njerëzve t’iu jepet një kapital i madh, kurse mënyra se si do ta shpenzojnë le të vendosin vetë. Njëri nga këta, duke e shpenzuar kapitalin pa masë në gjëra të kota, pas një kohe të shkurtër, pa dyshim, do të falimentojë dhe në dorë nuk do t’i mbetet asgjë. Pa dyshim, personi që përjeton një gjendje të tillë, kur ta kuptojë se nuk ka kthim prapa do të pendohet thellë. Kurse tjetri, nëse e shpenzon kapitalin e tij në ndihmë të të varfërve, të ngratëve, për fitimin e zemrave, për ndërtimin e ndonjë objekti me synimin që të tjerët të kenë dobi nga ai, a do të pendohet vallë? Pa dyshim që jo, sepse sa më shumë që shpenzohet për All-llahun, aq më tepër All-llahu do t’ia shumëfishojë pasurinë. Pra të gjitha këto mirësi që u janë dhënë njerëzve si: pasuri, kulturë, famë, respekt, bukuri, si dhe shumë mirësi tjera, janë të njohura si raste përgatitjeje për ahiret. Këto mundësi, besimtari i vlerëson në mënyrë korrekte.

Shembulli i jobesimtarit i përngjan personit që i shpenzon të hollat kot së koti. Ai e shpenzon jetën e tij të shkurtër pa e carë kokën, duke u dhënë pas bukurive dhe stolive të mrekullueshme të kësaj bote. Në botën e mëpastajme ata do të jenë në një humbje të madhe, sepse atje nuk do të mund t’u japin ndonjë dobi as të hollat, as shoku, as miku, as fëmija, as nëna, as babai apo ndokush tjetër, por do t’i ndihmojë vetëm ajo që kanë punuar. Kur’ani Famëlartë e përshkruan kështu gjendjen e këtyre njerëzve:

Thuaj: “A t’ju tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre?” Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se janë kah bëjnë mirë. Të tillët janë ata që nuk i besuan argumentet e Zotit të tyre as takimin (ringjalljen) e Tij, andaj veprat e tyre shkuan huq dhe në ditën e gjykimit atyre nuk do t’u jepet kurrfarë vlere.. (Kehf, 18:103-105).

Ata që janë të vetëdijshëm se kjo botë është kalimtare, do të kenë një fund të mrekullueshëm. Ngaqë e dinë se kjo botë është e përkohshme, ata nuk vrapojnë pas kënaqësive dhe stolive të kësaj bote mashtruese. Për këtë arsye, All-llahu xh sh është i kënaqur me ta, dhe si shpërblim do t’ua japë atë që u ka premtuar në ajetin 111-të të sures Teube ku thotë:

All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me xhennet. ...E kush është më zbatues i sigurt i premtimit të vet se All-llahu? Pra, gëzojuni tregtisë që bëtë me Të. Ky është sukcesi i madh. (Teube,9:111)

1. Beduizzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Dritët, Drita e njëzet e pestë, Ilaçi i nëntë.

2. Beduizzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Fjalët, Fjala e nëntëmbëdhjetë, Pikëza e dhjetë.

Shkëputet edhe nje fletë nga kalendari yt, të paktën le të jetë pa “gjynah”

Majlinda Hyseni

*T*ë zhytesh në pellgun e hirit bashkë me ujët e zymtë, është si të kesh para vetes një fletë të nxirë po nga ky hi!

Por të notosh në një ujë që pastrohet rregullisht me paisje filtruese, ndoshta veç një fletë do të lagej, ndërsa ngjyra e saj do të mbetet origjinale...

Por të thellohesh çdo ditë në shtratin e thellësirave edhe po ta ndrydhësh një letër për të mos marrë ngjyrë nga kjo papastërti, do të duhej një dorë e fuqishme!

Të jetosh çdo ditë dhe të thithësh të njëjtin ajër, të vishesh me petkat e zymtë ngjyrë hiri, që nuk kanë qepje origjinale por shthurje e moralit tënd! Ti thjesht vetëm i pranon gjërat si të servuara, pa shikuar në ambalazh nëse u ka skaduar afati, apo nëse ke të drejtë të konsumosh diçka të tillë, por noton dhe vetëm noton, pa pasur diçka në fund të detit, si-

kur kërkon margaritarë, që si duket janë edhe të rremë! Edhe nga një margaritar i mundshëm, sikur do të mund ta merrje, do të shihje një përthyeshmëri të fortë të dritës, e veç kësaj do ta shihje diku në fund të detit, ose thënë ndryshe në thellësi ku uji është më i pastërt dhe jo i ndotur nga hiri që të përcëllon ty, prandaj kuptoje se në këtë ujë s'ka margaritarë për ty. Ai margaritar do të ishte i mbështjellë me dekoratë, e cila të njofton ty se ke punë me një gur të çmuar, andaj bëj kujdes kur e hap!

Një pellg në të cilin hidhen hirat e drunjve të djegur dhe nga ti kërkohet të gjesh diçka të vlefshme aty, qoftë edhe një copë letër më së paku...

Imagjinoje sikur po flasim për ty dhe po flasim për pamjen tënde, dmth diçka që ka të bëjë me ty. Këtë pellg plehrash mund ta konsiderosh edhe si një dyqan rrobaqepësie, ndërsa petkat të cilat ndodhen aty janë veshur nga njerëz të modës dhe yje të muzi-

kës; kësisoj edhe nga ti kërkohet te shohesh diçka te vlefshme, sipas shijes dhe asaj që ty të përshtatet!

Nuk di nëse aty do të kishte diçka për ty dhe a do të pëlqenin ato gjëra për një kohe aq të shkurtër. Do ti rrëmbeje ato sikur t'ishin margaritarë, apo çfarë do të bëje, i ndikuar nga moda? Si do mund të marrësh një letër te bardhë nga një ujë i papastër, përveç nëse ke një dorë te fortë? Një dorë e fortë nuk nënkupton që me shpejtësinë e gishtërinjve të tu të kapësh gjënë më të bukur dhe më tërheqëse... jo! Por ti do ta largoje këtë llum njëherë e përgjithmonë dhe në vend të tyre kërko margaritarin e vërtetë...Por a ndodh kështu në realitet!

Nuk është se një herë në jetë të erdhi rasti të zgjedhësh disa leckë me fije peri te prodhuesve të huaj dhe të nxitosh t'i kapësh ato! Janë të shpeshta sezonet e përhitura kur vjen dallga dhe na lëshon pluhur syve! Janë çdo ditë pantallonat e ngushta që na bëjnë të ngelim të ndikuar nga dikush, nën hijen e dikujt, nën oqeanin e thellë të modës së huaj...

Sikur të ishte e mundur që vetëm një ditë të nxirrje një fletë të bardhë nga uji i zymtë!

Dhe të thuash: ja ku është! Me këtë kam vendosur të dal e veshur sot! Por ti nuk sheh dot, ngase je verbuar nga margaritarët e rremë që i janë mveshur asaj të cilën sot e quajmë mode!


Është një çështje shumë e rëndësishme ndotja e ujërave, mungesa e filtrave, posedimi i tyre që ia kthejnë jetën ujit! Dhe mbron kështu thesaret nën to!

Është e rëndësishme edhe se sa kupton, çfarë ndikimi ke tek gjinia tjetër, a bëhesh ti shkak ose një nxitëse për t'u kryer një mëkat? Sa mediton rreth dukjes tënde dhe rreth numrit të gjynaheve në ditë!?

Ti nuk je një leckë si një prodhim i një fabrike e cila për interesat e saj shitet kudo me kosto te ndryshme, por je një margaritar më vete, prandaj kërko margaritarë dhe jo leckë që kanë kualitet të dobët, ose mund të thuhet se edhe nuk kanë fare.

Mos u bëj ti shkak për t'i hapur ndokujt rrugën që shpie drejt mëkateve, po përkundrazi, mundohu ta kalosh këtë ditë pa mëkat!

Vetëm një ditë behu vetevetja dhe mos u ndiko



**Një pellg në të cilin hidhen
hirat e drunjve të djegur dhe
nga ti kërkohet të gjesh diçka
të vlefshme aty, qoftë edhe një
copë letër më së paku...**

nga hiri dhe qëndro si përmbajtja e letrës së bardhë, por jo si vet letra ! Ngase jecilësuar si margaritar!

Sot mos u zhyt ne pellgun e injorancës! Vetëm sot udhëto me mendje...

Veç sot mundohu të mos bësh të njëjtin mëkat, mëkatin e shturrjes tënde!

Mos lejo të jesh leckë, një mall i huaj që blihet e shitet për interese të përkohshme, por që nga sot ji një det paqeje, një pellg plot dritë nga reflektimi i diamanteve, mbi të gjitha ji vetvetja – me pamjen tënde njerëzore.

Vetëm sot realizoja këtë dëshirë mikeshës tënde ! E ngulfatja shpirtin armikut hileqar, sepse, nëse sot nuk mediton për veten, ky mëkat i veshjes do të të shkatërrojë!

Një ditë larg stuhisë ..larg tekstilit bashkëkohor, por nga anën tjetër afër stilit femëror, afër mirësisë që duhet ta kesh gjithmonë. Prandaj veç një ditë pa gjynah dhe ndoshta do të shpëtoje përgjithmonë. Vetëm këtë mendoje, sikur po jeton edhe vetëm sot, mendo sikur do të kalosh nesër në oqeanin e perjetshëm!

Aman! Veç sot pa mëkate, pa hir e pa imitime, cakto një rregull, ngrije me dorën tënde një një fletë të bardhë!

Kujdes nga pamja, sepse ajo pasqyron edhe brendësinë, prandaj një ditë të vetme pa mëkate, plot meditim, ndoshta do të çojë në pellgun e dijes. Për këtë kij durim.



Një Ajet

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshurshmit, Mëshurplotit!

“Ju përcillnit me gjuhët tuaja dhe flisnit me gojët tuaja diçka për të cilën nuk kishit dijeni. Ju këtë e merrnit për gjë të lehtë, por para Allahut kjo ishte një shkelje e madhe.” (Sure Nur, 24/15)

Në historinë islame, njëra nga ngjarjet më brengosëse është ajo e shpifjeve që bënë disa thashethemexhinj ndaj Hazreti Aishes. Kjo ngjarje njihet edhe si “ngjarja e përgojimit”. Hazreti Pejgamberi, i cili merrte me vete në çdo luftë njëerën prej grave të tij, kishte vendosur të merrte, këtë here Hazreti Aishen. Hazreti Aisheja po udhëtonte mbi një deve, pjesa e sipërme e samarit të së cilës ishte e mbyllur, sepse në atë periudhë kishte zbritur ajeti i mbulesës. Gjatë rrugës u vendos të bëhej një pushim. Pas pak, duke menduar se Hazreti Aisheja ishte në vendin e vet, u vendos që të vazhdohej rruga. Ishte natë. Hazreti Aisheja ishte shkëputur nga vendi ku po qëndronte ushtria, për të kryer nevojat personale, por teksa po kthehej vuri re se kishte humbur gjerdanin. Duke kërkuar gjerdanin, ajo arriti me vonesë në vendin ku ishte lënë takimi për vazhdimin e rrugës. Meqë nuk kishte ndonjë rrugëzgjdhje tjetër, ajo u ul aty dhe vendosi të priste që të vinin ta merrnin. Safvan ibni Muttali, i cili ishte preparojë e ushtrisë islame, kur e pa hazreti Aishen në stacionin e pushimit, e mori në devenë e tij dhe e shpuri tek Hazreti Pejgamberi.

Kjo ngjarje bëri që disa munafikë të përgojonin nderin e Hz. Aishes. Këto shpifje shkakuan shumë mëzë të Resulullahu dhe të besimtarët. Më pas, Allahu i Lartmadhëruar zbriti disa ajete të cilat hoqën çdo hije dyshimi në lidhje me nënën e muslimanëve, Hazreti Aishen, duke theksuar se ajo ishte krejt e pastër dhe aspak e përlyer.

T’i fajësosh njerëzit kur ata nuk kanë asnjë faj, do të thotë t’i mbytësh në planin shpirtëror. Gjithashtu, të bësh një gjë të tillë do të thotë të vësh dorë mbi disa të drejta themelore të njeriut, të cilat ia ka dhuruar Allahu i Lartmadhëruar, pra të shkatërrosh rendin që ka vendosur Allahu i Lartmadhëruar. Këtë askush nuk ka të drejtë ta bëjë. Në ajetin e mësipërm theksohet se është mëkat shumë i madh të njollosësh pa të drejtë nderin e dikujt. Një besimtar nuk duhet të flasë fare për një gjë, pa qenë i sigurtë njëqind përqind. Ai nuk duhet të bjerë viktimë e atyre injorantëve që tregojnë trimëri në kryerjen e këtyre mëkateve.

Një Hadith

Transmetohet nga Ebu Hurejra radijallahu anhu se

Resulullahu, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Mirësia është morali i pastër (i bukur). Kurse gjynahu është ajo gjë që njerëzit nuk duan ta dijnë (mësojnë) edhe pse ajo ia shqetëson zemrën.” (Muslim, Birr 14, 15. Gjithashtu shih Tirmizi, Zuhd 52)

Dy fjalë komenti:

Njëra nga veçoritë e Hazreti Pejgamberit është aftësia për të shpjeguar gjëra shumë të vështira në mënyrë koncize dhe me shprehje të thjeshta e të qarta. Këtë cilësi ai e ka quajtur “xhevamiul-kelim”.

Konceptet e së mirës dhe të së keqes nuk janë të thjeshta për t’u sqaruar me fjalë. Hazreti Pejgamberi shprehet se mirësia është morali i bukur, ndërsa në hadithe të tjera shpjegon se të kesh moral të bukur do të thotë të përballosh me durim çdo vështirësi, të mos mërzhitesh me tepri, si dhe të jesh i buzëqeshur e fjalëmbël.

Pejgamberi vendosi një masë për të kuptuar lehtësisht gjynahun dhe të keqen, duke thënë:

Në qoftë se kryerja e një vepre ta trazon shpirtin dhe ti nuk dëshiron ta marrin vesh të tjerët, atëherë ajo është e shëmtuar, është gjynah dhe e padëshiruar nga Allahu i Lartmadhëruar. Kjo, sepse pjesa më e madhe e njerëzve dëshirojnë që t’u dihet, t’u përmendet vepra e tyre e mirë, si dhe të shikohen me mahnitje dhe zili nga të tjerët. Kjo masë, e cila nuk gabon, mund të përdoret krejt thjeshtë nga gjithsecili. Mjafton të dyshosh në lidhje me një vepër, dhe kjo përbën një argument të mjaftueshëm për braktisjen e saj.

Zemrat të cilat nuk janë nxirë krejtësisht nga papëstërtitë e gjynahut janë si pasqyra, të afta ta tregojnë të mirën dhe të keqen. Për këtë arsye, kur njeriu dëshiron të bëjë diçka duhet të shikojë fillimisht nga zemra. Në qoftë se njeriu ndjen një shqetësim të brendshëm nga kryerja e një vepre, nëse fillon ta brejë dyshimi dhe shqetësimi, atëherë ai duhet të heqë dorë urgjentisht nga ajo vepër. Sepse një ndërgjegje e pastër i tregon njeriut rrugën e vërtetë.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi

- 1- Destinacioni për ku duhet të drejtohet njeriu, është morali i bukur.
- 2- Njeriu mund të bëjë dallimin ndërmjet të mirës dhe të keqës nëpërmjet një zemre të pastër.
- 3- Në qoftë se kryerja e një vepre i jep shqetësime zemrës dhe ti nuk dëshiron ta marrë vesh kush, atëherë ajo vepër është me siguri gjynah.

TË JESH VAZHDIMISHT ME ZOTIN

Ma një perceptimi dhe përjetimi me zemër i vetëdijes së lartë të të qenit vazhdimisht së bashku me Allahun (xh.sh.), të organizuarit e veprimeve tona duke ditur, duke menduar dhe duke ndjerë se Allahu i Lartmadhëruar është gjithmonë me ne.

Kjo vetëdije dhe ky perceptim është mirësia më e madhe dhe favori më i madh i Allahut ndaj njeriut. Kjo gjendje është të lidhurit e miqësisë së njeriut me Allahun (xh.sh.). Miqësia buron nga ekzistenca e veçorive të përbashkëta të dy personave. Prandaj për të krijuar miqësi me Zotin duhet shmangur nga çdo gjë që të largon prej Tij, dhe duhet pajisur zemra me veçoritë e Tij të bukura, si Rrahman (i Gjithmëshirshëm), Rrahim (Mëshirplotë), Afuv (Falës i vazhdueshëm, Mëkatfalës), Gafur (Falës i shumtë, Falës).

Të qenit shpirtërisht me Zotin dëshmon suksesin tënd në provimin e kësaj

dynjaje. E kundërta e kësaj, pra, bërja një jetë në mënyrë indiferente ndaj Hakut shënon një shkatërrim dhe pishmanllëk të përrjetshëm.

Të vërtetën e të qenit së bashku me Zotin e shpreh qartë rrëfimi i mëposhtëm, cili titullohet:

TI ME KË ISHE?

Një vaiz po fliste për Ahiretin. Atë ditë, në xhemat ishte edhe **Sheh Shibliu**.

Vaizi po fliste rreth pyetjeve që Allahu do të bëjë në Gjyqin e Madh. Ai po thoshte:

- Do të merresh në pyetje në lidhje me diturinë, si e përdore atë! Do të merresh në pyetje në lidhje me pasurinë, si e fitove dhe si e harxhove atë! Allahu do të pyesë në lidhje me jetën, si e jetove atë! Po adhurimet a i kryeve, do të jetë njëra nga pyetjet! A u kujdese për hallallin, po për haramin, do të jetë një tjetër pyetje!..

E pas këtyre, ai rreshtoi edhe disa pyetje të tjera, duke e vazhduar bisedën gjatë e gjatë.

Zotëri Shibliu që po dëgjonte, i tha vaizit me një zë të qetë:

- O zotëri vaiz! Harrove të përmendësh pyetjen më kryesore që do të na drejtojë Zoti! Allahu i Lartmadhëruar do të na pyesë shkurtimisht:

«O robi im! Unë isha kudo me ty, isha më afër teje se damari i qafës; por ti me kë ishe?! »

**“Mos u bëni si ata që e harruan
Allahun, kështu që Ai i bëri të
harronin vetveten!
Pikërisht ata janë të pabindurit
(ndaj Allahut).”
(el-Hashr, 19)**

Kjo është e gjithë ajo që duhet arritur në robërinë ndaj Allahut: kjo vetëdije, ky perceptim, kjo mendësi dhe kjo lartësi shpirtërore!..

Me të vërtetë, kur është së bashku me Zotin, njeriu është në rrugë të drejtë dhe i orientuar. Ai bie pre e kurtheve të djallit dhe të egos në masën e harresës dhe të indiferetizmit ndaj Allahut (xh.sh.). Allahu i Latmadhëruar thotë në Kuranin famëlartë:

“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).” (El-Hashr, 19)

Shpirti i njeriut që gjendet në këtë botë për t’u provuar, është si një zog i mërzitur në kafazin e lëkurës. Në thellësinë e tij zë vend mërzia e të qenit larg atdheut të tij të vërtetë. Ajo që e qetëson, e siguron dhe ia shuan vuajtjet, është shoqërimi i vazhdueshëm me Allahun. Prandaj, në sytë e ashikëve të Allahut humbet frika që ngjall vdekja dhe ajo shihet si fillimi i një ribashkimi. Sahabët ndjenin zili për ata që shtriheshin në shtratin e vdekjes, për faktin se atyre po u afrohej çasti i takimit me Zotin dhe me Resulin e tij, madje ata u kërkonin këtyre të sëmureve që t’i dërgonin selamet e tyre të ngrohta më të dashurit të botërave, Pejgamberit Muhamed a.s..

Me të vërtetë, se çfarë na pret në fundin e udhëtimit të vdekjes, qetësi xhenneti apo dënim xhehenemi, kjo lidhet tërësisht me nivelin e shoqërimit të shpirtit tonë me Allahun. Për këtë arsye, në këtë botë njeriu duhet të lidhet me Allahun e Lartmadhëruar, në mënyrë që në botën tjetër të përfitojë shpërblimin e miqësisë me Të dhe përtej kësaj, të përjetojë shiki-

min e Bukurisë së Tij.

Një besimtar i cili me zemër është vazhdimisht me Zotin, nuk e shpërdoron jetën duke u dhënë pas brutalitetit të egos; nuk e çon veten dëm pas dëfrimit dhe maskarallëqeve; nuk vrapon pas aventurave të kota; nuk zhytet në gjëra të pakuptimta, të pavërteta dhe epshore; nuk mashtrohet nga dashuritë boshe; nuk bashkëbisedon kur ndihet i provokuar nga injorantët, nuk e njollos kalendarin e jetës së tij me thashetheme; jeton me përpjekjen e të miqësuarit të tij me Allahun e Lartmadhëruar.

Një besimtar e zbukuron jetën e tij me vepra të mira. Ai pranon të udhëhiqet vetëm nga Kur’ani dhe synneti, angazhohet me punë që orientohen nga pëlqimi i Allahut (xh.sh.), e njeh Pronarin e vërtetë të çdo gjëje dhe e di shumë mirë se si duhet përdorur pasuria dhe jeta e tij. E ruan shpirtin nga vendet dhe veprat e këqija, të cilat mund t’ia zbehin rëndësinë dhe vlerat fesë dhe moralit, shton interesin ndaj adhurimeve, veprave të mira dhe bashkëbisedimeve shpirtërore. Si një dëshmitar i denjë i Zotit që lë pas vetes vetëm kujtime të mira.

ME KË MENDOVE SE JAM?

Çastet e fundit të jetës së Javuz Sulltan Selimit, pjesa më e madhe e viteve të sundimit të të cilit kaluan në fushata luftime, dhe i cili nuk u mërzit e as u lodh përballë shumë mundimeve dhe vështirësive, i përshkruan miku i tij, Hasan Khan:

“Në shpinën e Javuzit kishte dalë një çiban. Çibani u rrit dhe u bë gropë brenda një kohe të shkurtër. Ajo arriti deri në atë masë sa që ne prej kësaj plaje mund t’i



shihnim edhe mushkëritë Sulltan Javuzit. Ai ishte shumë i mërziur. Ishte si një luan i plagosur. Nuk e pranonte dot pafuqishmërinë e tij, dhe ashtu i sëmure siç ishte, vazhdonte t'ua jepte udhëzime luftëtarëve të tij heroikë. Iu afrova. Duke folur për përkeqësimin e tij shëndetësor, ai më tha:

«Çfarë më gjeti mua kështu, o Hasan Khan!? »

Unë e kisha kuptuar që jetës së tij të përkohshme po i vinte fundi, dhe se ai po i afrohej jetës së amshueshme. I mërziur i thashë:

«O padishahu im, kam frikë se të erdhi koha për t'ua bashkuar me Zotin, të qëndrosh së bashku me Të!»

Sulltani u kthye drejt meje, më vështroi me çudi e më tha:

«O Hasan, o Hasan! Deri në këtë çast, me kë ke menduar se jam unë?! A ke parë ndonjë mangësi në ndjenjën time të afërsisë me Zotin?»

Tashmë sulltani ishte zhytur në një tjetër përmasë. Ai më urdhëroi që t'ia lexoja suren Jasin. Kur mbërrita tek fjala «Selam», ai ia dorëzoi shpirtin Mikut të tij.

Ata që në jetën e tyre kanë qenë me Allahun (xh. sh.), e kanë përjetuar këtë kënaqësi deri në frymën e fundit të jetës së tyre. Përkërisht ky horizont shpirtëror është **maijeti**. Të mund t'ia zhdukësh joshjet e egos dhe dashuritë kalimtare të kësaj bote, dhe t'ia rezervosh zemrën vetëm Atij që e meriton më tepër, pra Allahut (xh. sh.). Tekembramja, një zemër që nuk ruan lidhjet me Zotin e pushton



çdo gjë tjetër veç Tij.

Një tjetër shembull na tregon:

Mirëqenien materiale të **Sulejmanit** – alejhisselam – nuk e ka arritur asnjë njeri tjetër. Por, kjo mirëqenie nuk zuri aspak vend në zemrën e Hazreti Sulejmanit, nuk e pengoi atë të ruante lidhjen e vazhdueshme me Allahun (xh. sh.).

Sipas disa transmetimeve, në ditën e kijametit do të sillet një njeri i pasur tek Allahu (xh. sh.) dhe do të pyetet:

- Çfarë të largoi nga adhurimi Im?

- O Zoti im! Më habiti pasuria e madhe që kisha në dynja.

Allahu i Lartmadhëruar e sjell shembull Sulejmanin, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, për të gjithë ne, duke i thënë:

- A ishte ti më i pasur se robi Im, Sulejman? Pse atë nuk e habiti pasuria shumë e madhe që ia dhurova? (Shih. Bursevi, *Ruhu'l Bejan*, IV, 258; Bajhaki, *Shuabu'l-Iman*, V, 202-203)

Jeta e Ejubit, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, në çështjen e provimit të njeriut me gjërat më të dashura, si pasuria, jeta dhe fëmijët, përbën një model të veçantë durimi dhe falenderimi, rrjedhoja këto të të qenit vazhdimisht i lidhur me Zotin e Lartmadhëruar.

“Allahu më dhuroi tetëdhjetë vjet shëndet. Akoma nuk kanë kaluar tetëdhjetë vjet në sëmundje. Për kaq pak vjet dhe më duket se jam mërzitur. Kam turp t’i kërkoj Zotit shëndet!”

Allahu i Lartmadhëruar e sprovoi Hazreti Ejubin disa herë. Fillimisht ia mori pasurinë. Pastaj nëpërmjet një tërmeti të madh, ia mori edhe fëmijët. Më vonë ia mori edhe shëndetin. Gjatë periudhës së sëmundjes, Ejubi, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, nuk u ankua asnjëherë. Një ditë, bashkëshortja e tij, Rahime Hatun, i tha:

- Ti je profet, të pranohet duaja. Bëj një dua që të shërohesh!

Ndërsa Hazreti Ejubi, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, i tha:

“- Allahu më dhuroi tetëdhjetë vjet shëndet. Akoma nuk kanë kaluar tetëdhjetë vjet në sëmundje. Për kaq pak vjet dhe më duket se jam mërzitur. Kam turp t’i kërkoj Zotit shëndet!”

Atëherë, kur sëmundja filloi t’i bëhej pengesë për të kryer obligimet e tij të robërisë ndaj Allahut të Lartmadhëruar, ai pranoi t’i lutej Perëndisë. Sipas disa transmetimeve, në lidhje me këtë të vërtetë, Profeti Muhamed (a.s.) është shprehur:

“Betohem në Allahun e Lartmadhëruar se Ejubi nuk ka shprehur asnjë ankesë në lidhje me fatkeqësinë që e goditi, por qëndroi në këtë fatkeqësi shtatë vjet, e shtatë muaj, e shtatë net. Dëshiroi të falë namazin në këmbë. Nuk mundi dhe u rrëzua. Pasi vërejti pafuqinë e tij për të kryer obligimet e robërisë ndaj Allahut, iu lut duke thënë: «Me të vërtetë, tani ka filluar të më

godasë sëmundja»

Pas këtij durimi dhe dorëzimi të jashtëzakonshëm që tregoi me veprën e tij Hazreti Ejubi, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, Allahu i Lartmadhëruar ia largoi të gjitha problemet që pati dhe i dha atij një jetë të ngjashme me atë të mëparshme.

Por, Hazreti Ejubi, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, në mëngjesin e parë që kaloi i shëruar, u pa i pikëlluar. Kur e pyetën për arsyen e këtij pikëllimi, ai u shpreh:

“Dikur, në çdo agim dëgjoja një zë që më thoshte: «Si je, o i sëmuri ynë?». Ndërsa në agimin e sotëm nuk dëgjoja asnjë zë të më thoshte: «Si je, o robi ynë i shëndoshë?». Për këtë arsye u mërzita dhe u pikëllova shumë.

SËMUNDJA MË E TMERRSHME

Sipas disa transmetimeve, Hazreti Isa, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, takoi rastësisht një person që kishte shenja të shumta në lëkurë dhe që i ishin mrrrolur faqet nga sëmundja. Ai person fliste me vete, si të mos e dinte se ishte i sëmurë dhe thoshte:

- O Zoti im! Falenderimet e shumta të takojnë vetëm Ty që më ke ruajtur nga shumë sëmundje që shoh tek të tjerët!..

Isa, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, për të kuptuar lartësimin e tij shpirtëror dhe konceptual, iu afrua dhe e pyeti:

- O njeri! Nga cila sëmundje të ka ruajtur Zoti ty?!”

I sëmuri iu përgjigj:

- O ti, Shpirti i Zotit! Sëmundja më e tmerrshme dhe fatkeqësia më e madhe është pasja e një zemre indiferente dhe të privuar nga i Vërteti. I faleminderit Atij që unë përjetoj kënaqësinë, lezetin dhe gjallërinë e të qenit vazhdimisht me Zotin. Përsa i përket sëmundjes që kam në trup, më duket se nuk e ndiej fare shqetësimin e saj..."

Allahu i Lartmadhëruar na urdhëron të ruhemi nga sëmundja më e tmerrshme, ajo e të qëndruarit indiferentë ndaj Hakut, dhe në shumë ajete kuranore na përkujton afërsinë e Tij ndaj krijesave:

"...Ai është me ju kudo që të gjeni..." (El-Hadid, 4)

"...Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet..." (Kaf, 16)

"...Dhe ta dini se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe zemrës së tij..." (El- Enfal, 24)

"Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni, është Fytyra (ana) e Allahut..."

Në lidhje me këtë temë, në një hadith thuhet:

"Shkalla më e lartë e imanit është të qenit i vetëdijshëm (pasja parasysh) se kudo që të jesh, Allahu është me ty" (Hejthemi, I, 60)

PRANË TË DASHURIT TË LARTMADHËRUAR...

Allahu i Lartmadhëruar është së bashku me ne, në çdo çast e në çdo vend. E rëndësishme është nëse mundemi ne të jemi afër Tij kurdo dhe kudo. Një vepër që bëhet me një vetëdije të tillë, sado e vogël të jetë, rritet e bëhet sa

"Shkalla më e lartë e imanit është të qenit i vetëdijshëm (pasja parasysh) se kudo që të jesh, Allahu është me ty"
(Hejthemi, I, 60)

një mal, ndërsa nga veprat që bëhen pa këtë vetëdije nuk ka aspak hajër (mirësi). Namazi, sadakaja, duatë, madje edhe tevbet që bëhen nga një person me zemër indiferente ndaj Zotit, janë të kota dhe kanë të gjitha nevojë për tevbe të pastër.

Ky rrëfim e shpreh shumë mirë këtë të vërtetë:

Mexhnuni, i cili dergjej ndër shkretëtira prej dashurisë ndaj Lejlasë, kalon në mënyrë krejt të pavetëdijshme para një personi që po falte namaz. Ai që po falej, pasi i jep fund namazit duke dhënë selam, i nevrikosur, i drejtohet Mexhnunit:

- A nuk e di ti akoma se nuk lejohet të kalosh para një personi që po fal namaz?!

Mexhnuni iu përgjigj:

- Unë, nga dashuria që kam për Lejlanë, jam verbuar krejt, më beso që nuk të pushë! Vetëm se po habitem se si arrite të më shohësh ti gjatë namazit, kur duhej të ishe i zhytur në dashurinë ndaj Allahut?!

Kjo tregon se dashuria ndaj një qenieje të përkohshme tek një person bën që ai të harrohet krejtësisht në objektin e dashurisë së vet. Atij nuk i sheh syri gjë tjetër. Edhe tek miqtë e Allahut (xh.sh.) manifestohet një ndjesi e tillë shoqërie me Allahun, kur ato janë duke kryer adhurimet apo obligimet e tyre shpirtërore. Njeriu është realisht në të qenit vazhdimisht me Allahun (xh.sh.), aq sa i ka cilësore adhurimet e tij për Të.



Hazreti Aishe shprehet:

“Kur Resulullahu – sallallahu alejhi ve sellem – qëndronte në namaz, herëpashere nga gjoksi i tij dëgjo-heshin zëra si të valimit të ujit në kazan.” (Ebu Davud, Salat, 157; Nesai, Sehv, 18)

Hazreti Aliu (r.a.), gjatë adhurimeve të ndryshme, hynte në një gjëndje qetësie shpirtërore të pashe-mbullt. Njëherë, gjatë një beteje i hyri në këmbë një shigjetë. Shokët e tij u munduan t’ia hiqnin, por nga dhembja që ndiente, nuk mundën t’ia nxirrnin. Hazreti Aliu u drejtua nga shokët dhe i tha:

- Unë po fal një namaz, e ndërkohë ju ma hiqni shti-zën!”

Shokët e tij bënë ashtu siç u tha ai. Ata arritën t’ia nxirrnin shtizën pa as më të voglën vështirësi. Hazreti Aliu (r.a.), pasi dha selam i pyeti shokët:

- Çfarë bëtë?

Ata u përgjigjën:

- E hoqëm!

Vëreni përqëndrimet dhe përjetimet shpirtërore të atyre që janë së bashku me Zotin.

Sigurisht, maijjeti, pra vetëdija e të qenit së bashku me Zotin, nuk lidhet vetëm me adhurimet. Ky koncept është një nivel i lartë shpirtëror që formëson gjithë jetën e besimtarit. Është një ndjeshmëri që sa

zbukuron jetën tonë të adhurimeve, aq e organizon dhe përmirëson jetën tonë familjare, shoqërore, ekonomike dhe të gjithë aktivitetet tona njerëzore.

DORËN NË QAR E SHPIRTIN NË YAR¹...

Hazreti **Muhamed Parisa**, një nga velitë e mëdhenj që ka dalë nga duart e **Hazreti Shah Nakshibendiut**, gjatë rrugës për në haxh sheh rastësisht një argjendar të ri me fytyrë të nurtë. Mërzitet, duke menduar se ky i ri po e harxhon rininë e tij duke u dhënë shumë pas punës dhe dynjallëkut, dhe thotë me vete:

- Sa keq! Në moshën më të përshtatshme për adhurim, ky djalë, qenka dhënë me kaq tepri e ambicie pas botës materiale! Në atë çast, atij iu shfaq në vegimin gjendja e atij djali. Ai pa se djali, pavarësisht ngarkesës së tij të punës, zemrën e kishte vazhdimisht me Zotin e Lartmadhëruar. I kënaqur, ai tha:

- Mashallah! Dorën e paska në qar e shpirtin në Yar...!

Kur mbërriti në Hixhaz, Muhamed Parisa vërejti një të moshuar mjekërbardhë, i cili e kishte rrokur mbulesën e Qabes dhe po qante me gjithë shpirt. Duke gjykuar nisur nga ajo që shihte nga jashtë, tha me zili:

- Ah sikur t’i kërkoja mbështetje dhe strehim Zotit tim edhe unë kështu, duke qarë!”. Më pas, atij iu shfaq sekret i të qarave të këtij njeriu dhe kuptoi se i moshuari po qante për plotësimin e një nevoje të kësaj bote. Për këtë arsye, zemra e tij e ndjeshme u mërzit shumë.

1. I Dashuri, këtu është për qëllim Zoti.



Kur njeriu është në shpirt vazhdimisht me Zotin, punët e kësaj bote nuk pësojnë ndonjë dëm. Por kur telashet e kësaj bote e zhysin njeriun në indiferentizëm e moskokëçarje ndaj Hakut, atëherë adhurimet pësojnë një dëmtim shumë të madh!..

Pasuria më e çmuar e njeriut është koha. Koha nuk mund të blihet, nuk mund të jepet, e as nuk mund të merret borxh. Pjesa më e rëndësishme e mirësisë së kohës, është çasti ndërmjet të ardhmes dhe të kaluarës, pra koha e tashme. Tekefundit dosjet që i përkasin kohës së shkuar janë mbyllur e vulosur. Tashmë është e pamundur t'i ndreqim apo t'i ndryshojmë. Ndërsa e ardhmja nuk dihet se me çfarë surprizash është e mbarsur. Për këtë arsye, kapitalin më të vyer që zotëron, besimtari duhet t'ia kushtojë më të Vyshmit. Ai duhet ta vlerësojë kohën e tij në shoqërimin e vazhdueshëm të Allahut (xh.sh.).

Hazreti **Ahmet er-Rufai** thotë:

“Mirësia e kohës për njeriun është koha në të cilën njeriu gjen afrimin me Allahun (xh.sh.)”

Hazreti **Abdullah bin Zejdi** është shquar për këshillat e tij të urta. Një ditë ai u shpreh:

“Sa i lumtur është ai që jeton njëkohësisht në dynja dhe në ahiret!”

E pyetën:

“Si jetohet njëkohësisht në dynja dhe në ahiret!”

Ai u përgjigj:

“Duke mos e nxjerrë nga zemra Allahun e Lartmadhëruar, duke jetuar vazhdimisht në gjendje lutjeje dhe duke përfituar kështu mëshirën e Tij në ahiret.”

Një ditë, një nga miqtë e Allahut (xh.sh.), **Ibrahim bin Et'hemi**, i bëri një vizitë **Ebu Hanifes**. Nxënësit që ishin pranë Ebu Hanifes, duke mos e njohur mirë Ibrahim bin Et'hemin, e panë me nënçmim. Pasi vërejti këtë situatë, Ebu Haanifeja iu drejtua Ibrahim bin Et'hemit kështu:

“Urdhëroni zotëria ynë, hyni e dhurojini nder tubimit tonë!”

Ibrahim bin Et'hemi u dha atyre selam me politesë dhe u largua menjëherë i turpëruar.

Nxënësit u habitën nga respekti dhe interesimi që



një njeri si Ebu Hanifja, i cili përfaqësonte një kulminacion juridik në nivel botëror, shfaqti ndaj një fakiri si Ibrahim bin Et'hemi.

Pasi Ibrahim bin Et'hemi u largua prej aty, nxënësit e pyetën Ebu Hanifen:

“Pse ky njeri e meritoi rëndësinë dhe interesimin tuaj deri në atë masë? Një njeri kaq i ditur sa ju, si mund t'i thotë një fakiri «zotëria ynë»?”

Hazret Imam Azami, duke treguar modestinë që aq shumë e karakterizonte, u përgjigj:

“Ai është i preokopuar në mënyrë të vazhdueshme me Zotin e tij, ndërsa ne merremi me të jashtmen e çështjeve...”

Hazreti **Ebu Bekir Shibliu** e përkufizon tasavvufin kështu:

“Të mos shohësh asgjë tjetër përveç Tij, duke qenë me Të, në të dyja botët.” Ja pra ky është niveli shpirtëror që kërkon të arrijë edukimi mistik, një vizion të tillë bashkimi me të Madhin e Vetëm.

FATKEQËSIA E TË QENIT INDIFERENT NDAJ HAKUT

Një njeri i cili gjatë jetës së tij, në vend të falenderimit, pëlqimit dhe dorëzimit shfaq mosmirënjohje, ankesë dhe injorancë, ai ka humbur ndjeshmërinë e të qenit me Allahun.

Sa më shumë që një njeri të jetë në kontakt me Zo-

“...Mos u mërzit, se Allahu është vërtetë me ne!..”

(Et-Tevbe, 40)

tin, aq më shumë i afrohet Allahut me mëshirën dhe diturinë e Tij. Një shembull të dashurisë së Allahut ndaj robëve të Tij e shpalos edhe hadithi, ku Allahu i Lartmadhëruar shprehet në atë mënyrë që ta përthithë kapaciteti i kuptueshmërisë njerëzore: Kur njeriu i afrohet Allahut (xh.sh.) një pëllëmbë, Ai i afrohet atij një kut. Nëse robi shkon duke ecur drejt Tij, Ai shkon duke vrapuar drejt robit të Tij. Kudo ku ai e përmend Atë, Allahu është me të, nuk e kursen kurrë mëshirën dhe ndihmen për robin e Tij.

Një e vërtetë absolute është fakti se njeriu i cili nuk e harron Zotin kur është në mirëqenie shpirtërore e materiale, do ta gjejë Atë shumë pranë kur të bjerë në vështirësi dhe halle. Dhe kur njeriu shpreh durim ndaj vështirësive të sprovave në jetë dhe kërkon për këtë shpërblimin e Allahut (xh.sh.), Zoti ia lehtëson durimin dhe vendosmërinë. Në qoftëse kërkon që të shpëtojë, i mjafton Allahu me ndihmën dhe mëshirën e Tij.

Allahu i Lartmadhëruar është i lirë në të vepruar. Ai i sprovon njerëzit me mirësi (bollëk), por edhe me skamje (varfëri). Të qenit me Allahun (xh.sh.) edhe atëherë kur njeriu sprovohet aty ku s’e pret, tregon besnikërinë e tij ndaj imanit. Prandaj, Allahu (xh.sh.) i ka sprovuar njerëzit e Tij më të dashur më shumë se sa të tjerët.

Në një ajet kuranor thuhet:

“Vërtet mendoni të hyni në Xhenet, pa provuar

atë që kanë provuar të tjerët para jush? Ata i goditi mjerimi dhe sëmundjet dhe, aq shumë u tronditën, saqë çdo i dërguar dhe ndjekësit e tij, thirrën: “Kur do të arrijë ndihma e Allahut?!” Ja, ndihma e Allahut është afër! (El Bekare, 214)

Për këtë arsye, kur një mysliman përballet me vështirësi dhe vuajtje, nuk ka aspak të drejtë ta zbrazë dufin e tij të brendshëm duke përdorur shprehje rebelimi që arrijnë deri në kufër (dalje nga besimi) si: “Pse Allahu, robi i të cilit jam, nuk po më qëndron afër në këto çaste kaq të vështira?”. Tekembramja, në këtë botë provimi, Allahu e sprovon njeriun! Allahu na ruajttë, e jo njeriu Allahun!

Një besimtar që përballet me vështirësitë e jetës duhet të kujtojë ajetin e maijjetit dhe të jetojë qetësinë që të dhuron qëndrimi vazhdimisht me Allahun, si dhe miqësimi me Të:

“...Mos u mërzit, se Allahu është vërtetë me ne!..”
(Et-Tevbe, 40)

Nuk duhet lënë në harresë fakti se besimtarët e mbërritur, të cilët kanë në zemër përmendjen e Allahut (xh.sh.), nuk përjetojnë as frikë e as mërzi, as në këtë dhe as në botën tjetër. Në lidhje me sihariqet dhe dhuratat që do t’i bëjë besimtarëve në çastin e fundit të jetës, Allahu (xh.sh.) thotë kështu në Kuran:

“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni e mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.” (Fussilet, 30)

Sa të lumtur janë ata që e formësojnë jetën në atë mënyrë që të meritojnë këto sihariqe dhe që përballë stuhive të egos bëjnë qëndresë duke qëndruar afër Allahut të Lartmadhëruar!

Allahu i Lartmadhëruar na e bëftë thesar lumturie të shpirtit tonë vetëdijen e të qëndruarit gjithnjë me Të, në çdo kohë e në çdo vend! Dhëntë Allahu që ta çojmë jetën tonë të kësaj bote në një atmosferë të plotë maijjeti dhe na përfshiftë në grupin e atyre fatlumëve që do të kenë nderin e mirësinë të shohin Bukurinë e Allahut në botën tjetër!

Amin!



Mr. sci. Flamur Sofiu

Financat dhe shpenzimet e arkës shtetërore-thesarit të shtetit sipas të drejtës islame

S'ka dyshim se çdo shoqëri-shtet ka nevojë për financim, me qëllim që të përballet me nevojat e llojllojshme që duhet të plotësojë shteti. Kur shikojmë historinë islame, vërejmë se shteti islam në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. nuk ka pasur nëpunës, kjo për shkak se nuk ka pasur shumë obligime, e ata që kryenin disa punë merrnin shpërblim. P.sh., ata që mbledhnin zeqatin paguheshin sapo përfundonin mbledhjen e zekatit. Ishte Pejgamberi s.a.v.s. ai i cili ua ndante hyrjet prej zekatit atyre që u takonin, prandaj nuk ishte nevoja të konsolidohej ndonjë administratë që do të kishte si qëllim sistemimin e financave dhe të shpenzimet në atë kohë. Mirëpo, me përhapjen e shtetit islam në

shumë vise, shteti islam që i detyruar të përcaktonte një administratë për kontrollimin e hyrjeve e të daljeve në arkën shtetërore. Umeri r.a. është i pari që e sistemoi administratën shtetërore islame dhe themeloi arkën shtetërore, duke pasur si qëllim ruajtjen e pasurisë së myslimanëve. Harxhimet shtetërore në kohën e Umerit r.a. ishin: rrogat e ushtarëve, të punëtorëve, të udhëheqësve etj, shpenzime këto që ishin për interesin e përgjithshëm dhe nevojat e shtetit. Ndërsat ajo që mbetej pa u harxhuar ruhej në arkën shtetërore dhe harxhohej kur paraqitej ndonjë nevojë. Arka shtetërore islame (bejtul mali) i ngjan thesarit të shtetit në ditët e sotme.

TË HYRAT FINANCIARE NË ARKËN SHTETËRORE

Si të hyra financiare të shtetit islam janë:

1. Zekati,
2. Xhizja,
3. Haraçi
4. Taksa të biznesit për jomyslimanët që jetojnë në shtetin islam dhe për ata që kanë kërkuar siguri nga shteti islam (el-ushuru)
5. Plaçka e luftës
6. Preja e luftës, e marrë prej jobesimtarëve pa luftë (el-fej'u)
7. Hyrjet e tjera

E PARA: ZEKATI

Në kuptimin gjuhësor, zekat do të thotë shtim dhe rritje, ndërsa në kuptimin e shariatit është detyrim që duhet dhënë për pasuri. Zekati është një prej pesë shtyllave dhe obligimeve të fesë Islame. Allahu i Lartësuar ka thënë: “Dhe jepeni zekatin”. Ndërsa në hadithin e të Dërguarit s.a.v.s., kur ai e dërgoi Muadhin në Jemen, tha: “Mësoji ata se Allahu ua ka bërë si obligim zekatin që u merret të pasurve e u jepet të varfërve”. Të gjithë myslimanët bien dakord se zekati është obligim-farz dhe se të gjithë shokët e të Dërguarit s.a.v.s. pajtohen me idenë se duhen luftuar ata që refuzojnë të japin zekatin. Duke u bazuar në këtë, kuptohet qartë se ai që mohon detyrimin e zekatit, ka dalë prej fesë (ka bërë kufër), e nëse refuzon ta japë atë, atëherë prijësi i myslimanëve mund t’ia marrë me dhunë dhe ta dënojë për shkak të këtij veprimi. Nëse nuk mundet t’ia marrë me dhunë, atëherë shteti islam e lufton atë, ashtu sikundër ka vepruar Ebu Bekri r.a. (me ata që kanë refuzuar të jepnin zekatin pas vdekjes së të Dërguarit s.a.v.s.), e i cili në atë rast është shprehur: “Sikur të mos më japin zekatin për kërpushin e deveve, të cilin e kanë dhënë në kohën e të Dërguarit s.a.v.s., kam për t’i luftuar ata”¹.

Zekati është obligim-farz për çdo mysliman e myslimane, po qe se arrihet sasia e duhur e pasurisë për të dhënë zekat (nisabi), nuk kihet borxhe dhe plotësohet viti, atëherë zekati është obligim si për të voglin, të rriturin, të mençurin dhe të çmendurin², nuk është

1. Ibn Kuddameh, El-Mugnij, vol. II, fq. 572 e më tej.

2. Ky mendim është marrë prej librit të Ibn Kuddames, i cili është dijetar i medh’hebit hanbelit, andaj edhe ky është mendim i hanbelitëve dhe i dy medh’hebeve tjerë, përpos hanefitëve të cilët mendojnë se fëmija dhe i çmenduri nuk e kanë obligim zekatin. Shënim i përkthyesit).

obligim zekati nëse nuk plotësohet viti. Fjala është për kafshët, arin, argjendin dhe mallrat tregtare, ndërsa viti nuk është kusht për të mbjellat, frytet dhe xehet.

E DYTA: XHIZJA

Xhizja është lloj tatimi që merret prej dhimmijut-jomyslimanit që jeton në sigurinë e shtetit islam. Ky lloj tatimi vërtetohet me Kur’an, Sunnet dhe me konsensusin e dijetarëve (ixhma). Në lidhje me këtë, Allahu i Lartësuar thotë: “Luftoni ata që nuk besojnë All-lahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar (haram) atë që e ndaloi All-llahu dhe i dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë, prej atyre të cilëve u është dhënë libri, derisa ta japin xhizjen në dorë e duke qenë të mposhtur.”³Në sunnetin e të Dërguarit s.a.v.s. qëndron ajo se vetë ai kishte marrë xhizjën prej zjarrpustitëve të Bahrejnit. Po ashtu, të gjithë dijetarët bien unanimisht dakord se duhet marrë xhizja prej jomyslimanit që jeton nën sigurinë e shtetit islam.⁴

KUSHTET OBLIGUESHMËRISË SË XHIZJES

Këto kushte janë:

1. që dhimmiju të jetë i mençur,
2. i hyrë në moshën madhore
3. mashkull.

Pra, xhizja nuk kërkohet për fëmijët, gratë dhe të çmendurit. Po ashtu, është parakusht që dhimmiju të mos jetë invalid, i verbër, apo tepër i shtyrë në moshë, d.m.th. nuk merret xhizje prej invalidit, të verbërit dhe prej plakut që është në moshë të thellë. Sipas mendimit të disa juristëve myslimanë, xhizja nuk duhet të merret as prej murgut, ndërsa sipas disa dijetarëve të tjerë, duhet të merret nëse ai përzihet me njerëzit dhe është i aftë për të punuar.

Sasia e xhizjes si tatim caktohet në fund të vitit dhe merret në fund të vitit, ndërsa sipas hanefitëve, ajo caktohet në fillim të vitit dhe merret në fund të vitit⁵.

Xhizja nuk paguhet në rast se dhimmiju bëhet mysliman apo nëse shteti islam nuk është në gjendje t’i ofrojë siguri atij.

3. Et-Teubetu: 29

4. El-Mugnij: vol. VIII, fq. 496, el-Xhesasu: vol. III, fq. 92-93, Taberiju: Ihtilaful Fukahai fq. 199

5. Sasia e xhizjes për të varfërinë që punon është 12 dërhëm, 24 dërhëm për atë që ka standard mesatar, ndërsa për të pasurinë është 48 dërhëm. Por, sipas disa juristëve myslimanë, sasia e xhizjes nuk është e përcaktuar, por atë e cakton vetë prijësi i shtetit sipas asaj që vlerëson ai me ixhtihadin e tij.

E TRETË: HARAÇI

Haraçi është tatim për ato toka që i kanë çliruar myslimanët, por që ua kanë lënë në dorë pronarëve të tyre⁶ që t'i punojnë dhe të shfrytëzojnë ato. I pari që e ka caktuar këtë lloj tatimi ishte halifi Umeri r.a., i cili u caktoi haraç tokave të Irakut pasi ato ua kishte lënë në duart e pronarëve të tyre. Ky vendim i Umerit r.a. kishte rezultuar pas një konsultimi me sahabët dhe me pëlqimin e tyre ndaj mendimit të tij. Toka për të cilën është obligim dhënia e haraçit njihet me emrin "el-Erdul Haraxhijetu", toka për të cilën paguhet haraçi.

Në përcaktimin e haraçit duhet shikuar forca e prodhimit të tokës, me qëllim që haraçi të mos jetë stërngarkesë për pronarin e tokës. Juristët myslimanë kanë disa mënyra se si mund të shikohet toka, për të përcaktuar sasia e haraçit⁷. Disa nga mënyrat janë: shikimi i plleshmërisë tokës, lloji i të mbjellave, sasia e fitimit, mënyrat e ujitjes, afërsia apo largësia e saj prej qyteteve dhe tregjeve.⁸

E KATËRTA: TAKSA TË BIZNESIT PËR JOMYSLIMANËT QË JETOJNË NË SHTETIN ISLAM DHE ATA QË KANË KËRKUAR SIGURI NGA SHTETI ISLAM (EL-USHURU)

El-Ushuru është lloj takse për biznes që u kërkohet jomyslimanëve që jetojnë nën sigurinë e shtetit islam dhe atyre që kërkojnë siguri nga ky shtet. Për dhimmijun kjo taksë është për ato pasuri që përdoren për biznes, e të cilat transportohen prej një vendi në vend tjetër brenda shtetit islam dhe sasia e kësaj takse është gjysma e 1/10. Ndërsa sa i përket atyre që kanë siguri nga shteti islam, kur ndodh që hyjnë me mall tregtie në rajonin e shtetit islam, u caktohen tatim prej 1/10 e mallit. Kjo sasi e caktimit të tatimit është si rregull i përgjithshëm. Sasia e këtij tatimi mund të pakësohet apo edhe të rritet, sipas rregullit të reciprocitetit; d.m.th., kur ky person që ka siguri në shtetin islam u merr tatim tregtarëve të tokave islame më shumë se 1/10 e mallit apo më pak, atëherë në këtë rast edhe shteti do të veprojë sipas veprimit të reciprocitetit, duke i marrë tatim të njëjtë.

KUSHTET E OBLIGUESHMËRISË SË KËTJË LLOJË TË TATIMIT

Sherhul Ez'har: vol. I, fq. 571. ¹

7. El-Maverdiu: fq. 143-144, Ebu Ja'la el-Hanbeliju fq. 151

8. Libri ynë: Ahkamu Dhimmijin vel Muste'minine, fq. 168

Për obligueshmërinë e këtij tatimi kushtëzohet që malli i dhimmijut të arrijë vlerën e nisabit të zekatit. Të këtij mendimi janë hanefitët, zejdiyet dhe disa nga hanbelitët.⁹ Imam Maliku r.a. është i mendimit se për këtë nuk është kusht që të arrihet vlera e nisabit të zekatit¹⁰ dhe se ky tatim merret një herë në vit prej dhimmijut dhe atij që është në sigurinë e shtetit islam, përveç rastit kur ai që është nën sigurinë e shtetit islam kthehet me pasurinë e tij në shtetin e vet; nëse më pas vjen prapë me atë mall në shtetin islam, atëherë prapë i merret tatim për këtë mall.

E PESTA: PLAÇKAT E LUFTËS

Plaçkë e luftës konsiderohet pasuria e marrë me luftë prej jobesimtarëve. Këtë lloj pasurie Allahu e ka emërtuar si "enfal", ngase ajo është shtesë e pasurisë së myslimanëve.¹¹

Plaçka e luftës është katër llojesh: robër, robëresha, fëmijë të zënë rob, tokë dhe pasuri të tundshme. Rob quhen ata meshkuj jobesimtarë të cilët kanë luftuar në betejë dhe myslimanët i kanë robëruar ata. Me këta, prijësi i myslimanëve ka mundësi të vendosë nëse ata të qëndrojnë në mosbesim, apo të veprojë sipas ixh-tihadit të tij; pra të veprojë ashtu si është më mirë: ose t'i mbysë, ose t'i robërojë, ose t'i lëshojë me kompensim, ose t'i lëshojë pa kurrfarë kompensimi¹². Në rastin kur robi pranon fenë islame, atëherë vendimi për mbytje anulohet dhe prijësit i mbetet të zgjedhë mes vendimit për ta robëruar, për ta liruar pa kurrfarë kompensimi, apo për ta liruar me kompensim.¹³

Si robëresha dhe fëmijë robër konsiderohen ato gra e fëmijë të cilët nuk lejohet të mbyten, por janë robër të cilët ndahen me plaçkën e luftës, ashtu sikundër dhe pasuritë e tundshme.

Toka e marrë si plaçkë lufte, ndahet në këto grupe:

1. Toka, në rastin kur pas pushtimit, pronarët e saj e kanë pranuar islamin, u takon pronarëve dhe për të mbjellat e saj jepet zekat.

2. Për tokën e cila është pushtuar, por me paqe dhe pa luftë, merret një tatim i caktuar. Ky tatim do të merret po aq sa janë pajtuar palët mes vete, jo më tepër.

9. Es-Serhasiju: Sherhu Sejrul Kebiri, vol. IV, fq. 284, Sherhul Ez'hari, vol. I, fq. 577, El-Mugnijj, vol. VIII fq. 519

10. Ebu Ubejde: El-Emvalu, fq. 535-536

11. Ibn Tejmije: Es-Sijasetu esh-Sheri'jetu fq. 30

12. Ebu Ja'la, fq. 125

13. El-Maverdiju, fq. 126

Kjo tokë është dy llojesh: a). ajo për të cilën prijësi i myslimanëve ka bërë marrëveshje paqeje, duke përcaktuar që toka të jetë pronë e të gjithë myslimanëve (vakëf). Ai që paguan tatimin për këtë tokë, do të jetë i obliguar ta bëjë këtë edhe nëse pronari i saj bëhet mysliman. b). kur prijësi i myslimanëve bën marrëveshje paqeje me pronarët e tokës, që toka tu mbetet atyre në pronësi por që ata të paguajnë tatimin e caktuar, këta pronarë të tokës kanë të drejtë ta përdorin si të duan, pra mund ta shesin e gjëra të të ngjashme me këtë, përkundër asaj që ndodh me grupimin e parë, ku një gjë e tillë nuk lejohet.

3. Pastaj është toka të cilën myslimanët e kanë çli-ruar me luftë, duke u vënë në pronësi me forcë. Për trajtimin e kësaj lloji toke juristët myslimanë kanë mendime të ndryshme: imam Shafiu r.a. është i mendimit se kjo tokë është plaçkë lufte, ashtu sikundër pasuritë e tundshme. Pra duhet t'u ndahet atyre që kanë të drejtë hiseje në këtë plaçkë lufte, pasi që 1/5 e saj t'i jepet atyre që Allahu i Lartësuar i ka përmendur, përveç rastit kur ata që kanë të drejtë hiseje në këtë plaçkë heqin dorë me vullnet, duke pranuar që kjo t'i jepet arkës shtetërore, d.m.th. të mbetet si vakëf për myslimanët. Imam Maliku r.a. është i mendimit që kjo tokë të mbetet si vakëf i myslimanëve dhe se nuk lejohet që ajo t'u ndahet atyre që kanë të drejtë në marrjen e plaçkës së luftës. Imam Ebu Hanife r.a. thotë: prijësi i myslimanëve ka drejtë të veprojë në lidhje me këtë tokë, duke ua ndarë atyre që kanë të drejtë në plaçkën e luftës, që pronarët e tyre të japin zekatin e produkteve të saj; ose ka të drejtë që këtë tokë t'ua lërë në dorë pronarëve të saj politeistë, por gjithnjë duke bërë të mundur që shteti islam marrë prej tyre haraçin; që kjo tokë është toka tatimore dhe politeistët konsiderohen në këtë aspekt si dhimmij, apo këtë tokë duhet t'ua japë të gjithë myslimanëve. Pra, duke e konsideruar edhe këtë tokë islame, pavarësisht se aty banojnë myslimanët apo kthehen politeistët në të si pronë e myslimanëve, duke mos u lëshuar pe politeistëve në asgjë në lidhje me këtë tokë. Imam Ebu Ubjede r.a. konsideron se mendimi mbizotërues në këtë çështje është se në lidhje me tokën që myslimanët e kanë fituar me luftë, prijësi ka të drejtë t'ua ndajë atyre që kanë të drejtë hiseje në plaçkën e luftës, pasi që 1/5 i është dhënë asaj që e ka përcaktuar Allahu i Lartësuar. Po ashtu, prijësi ka të drejtë që këtë tokë ta lërë si vakëf për të gjithë myslimanët. Pra, ky është mendimi i Ebu Hanifes r.a., mendim të cilin imam Ebu Ubede r.a. e ka konsideruar si mendim mbizotërues, ndaj



edhe ne anojmë kah ky mendim.

Pasuri të tundshme konsiderohen ato plaçka të luftës që janë të zakonshme dhe se këto nuk ndahen përvece pasi të mbarojë lufta dhe myslimanët të korrin myslimanët.

E GJASHTA: PREJA E LUFTËS E MARRË PREJ JOBESIMTARËVE PA LUFTË (EL-FEJ'U)

448- Me shprehjen el-fej'u nënkuptohet ajo pre e luftës që myslimanët e kanë marrë prej jobesimtarëve pa zhvilluar kurrfarë lufte. Këtë lloji plaçke lufte, juristët muslimanë e kanë futur në kuptimin e xhizjes, haraçit dhe të tatimit që paguajnë dhimmijët, si dhe ata që qëndrojnë në shtetin islam për një kohë, duke qenë nën sigurinë e këtij shteti. Kjo pre është ajo pasuri të cilën armiku e ka dhënë me rastin e marrëveshjes për paqe, apo kur jobesimtarët e kanë lënë këtë pasuri duke ikur prej luftës. Kjo pre e luftës është emërtuar si el-fej'u, për shkak se Allahu ua ka kthyer këtë pasuri myslimanëve duke ia marrë jobesimtarëve, ngase Allahu i Lartësuar i ka krijuar krijesat që ta adhurojnë Atë, dhe se e ka krijuar pasurinë me qëllim që me ndihmën e saj njerëzit të arrijnë ta adhurojnë Atë. Jobesimtari me mosbesimin e tij është shkaktar që Allahu u ka lejuar robërve besimtarë jetën dhe pasurinë e jobesimtarit, ngase jobesimtari nuk e përdor



pasurinë për ta adhuruar Allahun¹⁴. Baza e kësaj lloj plaçke lufte është në fjalën e Allahut të Lartësuar: “E atë (pasuri) që prej tyre All-llahu ia ktheu të dërguarit të vet, ju për të nuk i keni ngarë as kuajt, as devetë, por All-llahu i bën mbizotërues të dërguarit e vet kundër kujt të dojë, All-llahu ka fuqi mbi çdo send. Atë që All-llahu nga banorët e vendeve (jobesimtare) ia dha pa luftë të dërguarit të vet, ajo i takon All-llahut, të dërguarit të afërmve, jetimëve, të varfërve, kurbetçinjve. (Kështu veprohet) Që ajo të mos ndahet ndërmjet pasanikëve tuaj.”¹⁵

E SHTATA: HYRJET E TJERA FINANCIARE

449- Si hyrje të tjera financiare të arkës shtetërore, mund të përmendim edhe ato pasuri që kanë mbetur pa pronarë të caktuar, si p.sh.: nëse ka vdekur dikush prej myslimanëve dukë mos lënë trashëgimtar, pasuria e marrë me dhunë, pasuria e dhënë hua, apo pasuria e lënë në siguri të dikujt, por që mund të mos i dihet pronari i vërtetë. Në të gjitha këto raste pasuria i takon arkës shtetërore. Po ashtu është edhe çështja e pasurisë së gjetur, pronari i së cilës nuk është paraqitur etj¹⁶.

Prej hyrjeve të arkës shtetërore llogariten edhe tokat të cilat i shfrytëzon shteti, apo që i jep me qesim,

14. Ibn Tjemije: Es-Siajsetu esh-Sher’ijetu, fq. 36

15. El-Hashr: 6-7

16. Shiko studimin tone: Dispozitat e pasurisë së gjetur

andaj përfitimi dhe pagesa e qesimit bëhet në arkën shtetërore. Vetë Umeri r.a., me pëlqimin e atyre që kanë pasur hise në të drejtën e tokës si plaçkë e luftës, u kishte lënë atyre tokat e Irakut të cilat ishin pronë e Kisraut dhe familjes së tij, por që nga pronarët e këtyre tokave kishte marrë tatim. Prijësit të myslimaneve i mbetet të zgjedhë, pra të veprojë si Umeri r.a. duke u lënë tokat pronarëve por duke iu marrë tatim, ose që tokën ta shfrytëzojë vetë shteti për të mirën dhe interesin e arkës shtetërore, ashtu sikundër ka vepruar Uthmani r.a.¹⁷

Po ashtu, si hyrje financiare të arkës shtetërore konsiderohen edhe tatimet që prijësi i shtetit u cakton pasanikëve në raste të jashtëzakonshme, për të rregulluar disa çështje të domosdoshme shtetërore, tatim i cili caktohet kur nuk ka financa arka shtetërore, si p.sh. furnizimi i ushtrisë, plotësimi i nevojës të domosdoshme të jetës për ata që janë në nevojë.

SHPENZIMET E ARKËS SHTETËRORE:

Këto shpenzime janë:

E PARA: ZEKATI

Fondacionet në të cilat shpërndahet zekati janë të përcaktuar nga Allahu i Lartësuar, i Cili në Librin e Tij thotë: “All-llahu caktoi obligim që lëmosha (zekati etj.) t’u takojë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare), punonjësve (që e tubojnë), atyre që u duhen përfitur zemrat (të dobtëve në besim), si dhe duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve), në rrugën e All-llahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. All-llahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet.”¹⁸

Lejohet që zekati t’i jepet vetëm njërit prej këtyre fondacioneve, edhe nëse të gjitha këto fondacione janë prezentë Nuk lejohet t’i jepet zekati jobesimtarit, e as të afërmve të fisit Beni Hashim dhe Beni Mutalib.

E DYTA: ZEKATI I MINERALEVE, XEHEVE DHE DHËNIA E ZEKATIT NË MASËN 20% TË PASURIVE TË FSHEHURA NËN TOKË

Dhënia e zekatit për xehe-minerale dhe dhënia e zekatit 20% për pasuritë e fshehura nën tokë, dhënia e zekatit të zakonshëm siç është zekati për bagëtitë, të

17. El-Maverdiju: fq. 185-186

18. Et-Teubetu: 60

mbjellat, frytet, arin, argjendin dhe mallin e tregtisë.

E TRETË: PLAÇKA E LUFTËS

Është obligim që 1/5 e plaçkës së luftës t'i jepet arkës shtetërore, sasi kjo që duhet t'u shpërndahet atyre që Allahu i Lartësuar i ka përmendur në kaptinën el-Enfal: "Ju (besimtarë) ta dini se një e pesta e asaj që e fituat, nga ndonjë send, i takon (përkujtuesve të) All-llahut, të dërguarit të Tij, të afërmve të tij (të dërguarit), jetimëve, nevojtarëve dhe atyre në mërgim,"¹⁹

E KATËRTA: PREJA E LUFTËS QË ËSHTË MARRË NGA JOBESIMTARËT PA LUFTË

Kjo pre ndahet ashtu si e ka përcaktuar Allahu i Lartësuar në kaptinën el-Hashr: "Atë që All-llahu nga banorët e vendeve (jobesimtare) ia dha pa luftë të dërguarit të vet, ajo i takon All-llahut, të dërguarit të afërmve, jetimëve, të varfërve, kurbetçinjve. (Kështu veprohet) Që ajo të mos ndahet ndërmjet pasanikëve tuaj. Cka t'ju japë Pejgamberi, atë merreni, e çka t'ju ndalojë, përmbajuni dhe kini frikë All-llahun, se All-llahu është ndëshkues i ashpër. (Ajo pronë) U takon muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe prej pasurisë së tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë prej All-llahut, dhe që ndihmojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij, të tillët janë ata të singertit. Edhe ata që përgatitën vendin (Medinen) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër gjë) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), aq sa edhe sikur të kishin vetë nevojë për, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar. Edhe ata që kanë ardhur pas tyre, e thonë: "Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë, Ti je i butë, mëshirues!"²⁰

Juristi El-Maverdiju ka thënë: Merret 1/5 e kësaj plaçke dhe ndahet në pesë hise të barabarta: një hise i takon të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., i cili gjatë jetës së tij e ka shpenzuar këtë për veten, gratë dhe interesat e përgjithshme, hise e cila pas vdekjes së të Dërguarit s.a.v.s. shpenzohet në interesat e përgjithshme të myslimaneve si: furnizimi me ushqim i ushtrisë, armatim, ndërtimi i fortifikatave, ndërtimi i urave, dhënia e

rrogave për gjykatësit, nëpunësit, si dhe në të gjitha çështjet që janë në interesin e përgjithshëm të myslimanëve. Hisja e dytë u takon të afërmve të Dërguarit s.a.v.s., të cilët janë janë Benu Hashimet dhe Benu Abdulmutalib, pra bijtë e Abdumenaftit. Hisja e tretë u takon jetimëve dhe atyre që janë në nevojë. Hisja e katërt u takon të ngratëve që nuk kanë me çka t'i plotësojnë nevojat e domosdoshme të jetës. Hisja e pestë u takon udhëtarëve të cilët nuk kanë me çka të furnizohen. Ndërsa për shpërndarjen e 4/5 së kësaj plaçke, dijetarët ndahen në dy mendime: disa mendojnë se kjo i takon posaçërisht ushtrisë, ndërsa disa tjerë janë të mendimit se kjo duhet të shpërndahet në atë që është interes i përgjithshëm i myslimanëve, dhe në interesin e përgjithshëm përfshihet edhe furnizimi i ushtrisë me ushqime e me gjera tjera të nevojshme²¹.

Ata që meritojnë prene e luftës, Umeri r.a. i ka ndarë në katër grupe:

Njeriu i cili ka trashëguar pasuri nga të parët e tij, të cilët ishin bërë myslimanë,

Ata që kanë marrë shpërblim prej myslimanëve për shkak të angazhimit të tyre në dobi të myslimanëve, si p.sh. udhëheqësit dhe dijetarët, të cilët janë angazhuar për të mirat e myslimanëve, si për këtë botë ashtu edhe për ahiret.

Ata të cilët janë angazhuar për mbrojtjen e myslimanëve, siç janë muxhahidinët, ushtarët etj.

Ata që kanë nevoja të domosdoshme për jetë.

Po ashtu, transmetohet se Umeri r.a. ka thënë: "Pasha Allahun, nëse mbetet nga kjo pre, do t'i jepet edhe bariut që është në kodrën San'a, ngase ai po kujdeset për vendin e tij"²². Nga e gjithë kjo kuptohet se të gjithë myslimanët kanë hise në këtë lloj preje të luftës. Nga kjo pre plotësohen më së pari të gjitha nevojat e domosdoshme të shtetit, siç është furnizimi i ushtrisë, pagesat e nëpunësve etj. Kjo pra është ajo që argumenton ajeti fisnik. Pas kryerjes së nevojave të domosdoshme të shtetit, u jepet përparësi atyre që kanë nevoja të domosdoshme të jetës.

Në aspektin e shpenzimeve, kësaj preje të luftës i bashkëngjiten edhe ato pasuri që nuk kanë pronarë, si p.sh. në rastin kur dikush vdes e nuk lë trashëgimtarë, si dhe shumë lloje të tjera të pasurisë, të cilave për arsye të ndryshme nuk u dihen pronarët²³.

21. El-Maverdiju: fq. 122-123

22. Ibn Tjemiju: Es-Sijasetu esh-Sher'ijetu fq. 44-46, Ibnul Kajjimi : Zadul Mead vol. III, fq. 221-222

23. Ibn Tjemije: Mexhmu'ul Fetava, vo. VIII, fq. 276-277

19. El-Enfal: 41

20. El-Hashr: 7,8,9,10



Fatihaja e jetës

Ymit Shimshek

Në mbrëmje shejtani nuk u kthye. As në ditën tjetër. As një ditë më pas. Edhe Xhemi, që prej asaj mbrëmjeje nuk u kthye më. Kishte shkundur ndyrësitë e mbetura nga diskutimi i vilitshëm që kishte pasur me shejtanin, kishte hapur melekët e mendjes aq sa kishte pasur mundësi.

Shpesh, kudo që të ndodhej, Xhemi i mbyllte për një çast sytë e tij, priste që çdo gjë të errësohej dhe të humbiste, përpiqej të harronte botën ku jetonte, si të donte t'i fshinte nga truri të gjitha dhe dalëngadalë mësohej me errësirën dhe varfërinë, duke përdorur të gjithë forcën e tij. Më pas, kur ndodhej në mes të errësirës, të dhunës, varfërisë, i çelte sytë sërish.

Përsëritje botë!

Por, një botë e huaj. Xhemi ndodhet mbi një planet të çuditshëm. Përpara tij qëndronte një diell që lindte për herë të parë, mbi detin që e shihte për herë të parë. Mbi një anije në të cilën hipte për herë të parë. Frymëmarrje e parë. Shikim i parë.

Filizi i çajeve!

Nuhatja e parë. Gëlltitja e parë. Një kontrollim një për një i shijes së secilës, duke e numëruar gllënjken pikë për pikë dhe pikën grimcë për grimcë.

Përpara Xhemit ka fytyra. Dy të mëdha, një të vogël. Por para së gjithash, ç'fytyrë?

Foshnja që është në prehrin e nënës po luan me babain. Duart e njoma të foshnjës lënë shenja gishtërinjsh në syzet e të atit. Po shenja e duarve?

Babai luan me duart e njoma. I puth... i puth... Por, puthje ç'do të thotë? Vetulla që rrethojnë buzët dhe që nuk kanë asnjë lidhje me kockat. Lëviz me nervat e fytyrës. Nervat e fytyrës merr sinjal nga mendja. Vetullat rrudhen. Buzët rumbullakosen, mbyllen dhe hapen me një lëvizje të çastit. Më pas diçka përhapet prej anëve të buzëve drejt thellësive të shpirtit. Nuk është aspak diçka e nevojshme për të jetuar. Po sikur të mos ishte puthja në jetë?

Nëna qesh... Babai qesh... Foshnja qesh... Foshnja?... Të qeshësh?...

Foshnja akoma nuk di të flasë. Foshnja nuk di të ecë. Por të qeshurën e di. Foshnja di të qeshë që kur lind!

Pse nuk mund ta shoh unë, për të gjetur këtu një emërues? Zëri i shejtanit oshëtin në veshët e Xhemit. Një drithërimë nga debati i disa ditëve më parë. Bota po errësohej përsëri. Ngjyra e fytyrës së foshnjës po humbiste, muskujt e poshtëm mbetën prapa... muskujt dhe gjaku. Më pas edhe ato ikën, në mes mbeti vetëm një kokë e tharë me gjithë anët e frikshme të saj.

Telefoni celular i Xhemit jep alarmin. Fillim ore. Ushtrimet e meditimit fillojnë përsëri. Xhemi mbyll sytë. Bota errësohet. Përsëri dhunë, varfëri, dhunë, varfëri... Pastaj, çilembyll sytë, një lindje e çastit.

Shiko tani kockat, si e ndërtojnë, më pas e veshin atë me mish.

Në një anë kocka e çenes së poshtme të foshnjës që ulet e çohet si një menteshë, dhe koka e tij që sillet herë tek nëna

dhe herë tek babai.

Vetullat mblidhen përsëri mbi kocka. Majat lidhen për eshtra. Mes vetullave dhe trurit rreshtohen malet e nervave të fytyrës. Damarët shtrohen, ndërse gjaku pompohet deri në qoshet më të largëta. Në gropat e syve vendosen një çift sysh blu, sy që lëvizin brenda vendit të tyre, sy që shndrisin. Sytë fshihen me një pastrues lens nga pjesa e sipërme, në pjesën e poshtme përgjatë së cilës shtrihen tubat e kullimit dhe pjesa tepruese kalohet në boshllëkun e tubit të nxehtësisë. Sipër tyre zgjaten kapakët e syve, sipër me qerpikë që vazhdimisht fshihen, pastrohen dhe shndrisin pjesën ngjyrë blu më të bukur në botë. Më pas, e gjithë fytyra vishet dhe zbukurohet me një lëkurë të butë si pambuku,

Faqet topolake, buzët trëndafil, sytë e vegjël. Foshnja qesh.

Foshnja nuk di të ecë. Nuk di të flasë. Por të qeshë di.

Foshnja, ashtu sikurse di të qeshë, ashtu di të lexojë edhe buzëqeshjen.

Nëna qesh, foshnja jep përgjigje.

Babi qesh, foshnja jep përgjigje.

Qeshin.

Tani fillon edhe pjesa më e bukur e bisedës, kështu pati thënë Xhemi, por në mes kishte hyrë namazi, më pas Shejtani ishte zhdukur dhe nuk shihej. Xhemi donte ta merrte përpara, ta kapte për jake, ta godiste në kokë dhe t'i fliste.

- Kush të bën të qeshësh?

Kot është koka me shumë vetulla? Kot shtrihen rrjetet e nervave? Kot zbukurohen të gjitha këto në lëkurën e fytyrës së foshnjës? Kush e krijoi kokën? Kush i ngjyrosi sytë bojë-qielli? Kush e krijoi këtë buzëqeshje mbi gjak dhe vetulla?

Le të vijë Shejtani të mbledhë të gjithë ndihmësit e tij prej xhindëve dhe të gjejë një emërues të të gjitha këtyre punëve!

Mos ato gjetën krijues si Allahu dhe ato gjëra ia përngjasuan krijimit të tij?

Dy pika loti rrodhën nga syve e Xhemit.

Ai është që të bën të qeshësh, por edhe të qash

Nuk mjafton të gjesh emëruesin, ka edhe një pyetje që pret përgjigje.

Pse?

Pse një foshnjë mëson të qeshë para se të flasë, para se të ecë, para se të mësojë çdo gjë në këtë botë?

Pse e bën një gjë të tillë Ai që e bën të qeshë atë? Pse i bën të qeshë nënën dhe babain? Pse para së gjithash mësohet të qeshësh në këtë botë? Le të shkojmë edhe më tej. Përse Ai qe e sjell njeriun në këtë botë, në fillim ia mëson të qeshurin dhe më pas e sjell në jetë?

Në kujtesën e Xhemit vegoi dita kur vajza erdhi në jetë. Ishin në spital. Foshnja kishte ardhur në këtë jetë me ope-

racion dhe flinte ëmbëlsisht nën ndikimin e ilaçit. Në fytyrë i lexohej qartë një buzëqeshje. Kishte gjysëm ore që kishte lindur dhe sigurisht që për këtë gjysmë ore s'kishte se kush t'ia mësonte të qeshurën!

Xhemi filloi t'i jetonte përsëri ato ndjenja që i kishte shfaqur ajo buzëqeshje. Një qenie e paqenë deri para gjymë ore, kishte hyrë në botën e Xhemit dhe të së shoqes dhe i kishte përqafuar ata me gjithë ngrohtësinë e saj. Ajo qenie që nuk kishte qenë para gjysëm ore, tani ishte në botën e të dyve. Ajo buzëqeshje e vogël u jepte atyre atë që e gjithë bota nuk ia jepte dot.

Ditët e mëvonshme kishin kaluar pothuajse si në një garë për të qeshur dhe për të bërë të qeshësh.

- E sheh? Shiko si po qesh babai yt, ty po të qesh.

- Eja e shiko, përsëri po qesh!

- Eja e jepi një buzëqeshje nënës tënde

Kur foshnja i përgjigjej buzëqeshjeve të tyre, ata çuditëshin.

Më parë këtë e kishin quajtur një rastësi, por sapo ngjarja përsëritej nuk mbeti asnjë dyshim për ta. Tani foshnja jo vetëm qeshte, por edhe u përgjigjej buzëqeshjeve. Ajo e ndjente kur të tjerë i buzëqeshnin.

Foshnja që nuk dinte asgjë, edhe sikur ta kishte mësuar buzëqeshjen në një botë tjetër, si mund ta dinte se çfarë pamje do te merrte fytyra e tjetrit? Si ishte e mundur që foshnja e lindur vetëm para gjysmë ore dinte ta lexonte si një libër fytyrën e njeriut?

Xhemi nuk priti orën. Mbylli përsëri sytë dhe provoi të vinte përsëri në jetë. Këtë herë nuk do të vinte në këtë jetë, por do të provonte të dërgonte veten.

Çdo gjë u errësua dhe humbi. E gjithë bota u zhduk. Në mendjen e Xhemit ishin vetëm errësitat shumëkatëshe. Pastaj, në mes errësirash u duk një botë blu.

Xhemi nuk hyri në brendësinë e botës. Ai solli në kujtesën e tij vetëm një botë blu ku donte të futej. Mendoi sikur po hidhte hapin e parë në këtë botë si një foshnjë, dhe pastaj u mundua të bënte një listë të gjërave që i duheshin.

Ka të ftohtë, mërdhin, ka temperature, uri. Sëmundje, ngriçë, shi, furtunë, qenie të gjalla, të vdekura...

U mundua të mendonte, që të merrte masa për të përballuar çdo lloj rreziku.

Xhemi nuk mund të mendonte asgjë nga këto me një mendje të boshatisur, pastaj u kthye në botën tonë pa asnjë zgjidhje.

Ja pra, ishte pa një foshnje të ardhur në këtë botë. Kishte një nënë, një baba, si dhe një të qeshur, kaq ishin të gjitha.

Në atë çast Xhemi kujtoi ato që këndonte në namaz. Edhe fatihaja e jetës, si ajo e Kur'anit, fillonte me emrat Rahman dhe Rahim.

Ebu Hamid El-Gazzali

Ma. Artur Tagani

Gazzali lindi në vitin 1058 (Hixhri 450) në Tus të krahinës së Horasanit, në vendin që sot në Iran quhet Meshhed. Në skollastikën mesjetare njihej si Abuhamet dhe Algazel.

Sa do që të mendohet se me origjinë është pers, ka informacione të pakta lidhur prejardhjen e familjes së tij. Ai kishte disa motra dhe një vëlla më të vogël që quhej Ahmed

Gazzali, i cili më vonë do të ishte një sufi mjaft i njohur.

Gazzali edukohet mirë, falë vullnetit të babait të vet për t'i formuar sa më mirë fëmijët. Krahas diturive teologjike ai mori mësimë edhe mbi gramatikën, aritmetikën, logjikën, si dhe shkencë tjera të ndryshme. Mësimet e para i mori në qytetin Tus, nga Ahmed Ibn Muhammed er-Radegani, më pas në qytetin Xhurxhan, ku merr mësimë nga Ebu Nasr el-Ismaijle, ndërsa deri në moshën 28 vjeç ai studioi në Nishabur, te kelimisti i njohur i asaj kohe, Imam-ul Haremejn el-Xhujeni.

Në vitin 1091, Nidhamul Mulku, një kryeqeveritar i Selçukëve, e emëron Gazzalin drejtor të Medresesë Nidhamije, në Bagdat. Më pas, me vvarjen e Nidhamu'l-Mulku, Gazzali tërhiqet nga Medreseja për të bërë haxh, dhe në vitin 1106 kthehet sërish në Medresenë Nidhamije, këtë radhë në filialin e Nishaburit, ku jep mësimë. Në vitin 1111 (Hixhri 505) ai rikthehet në vendin e tij të lindjes, në Tus, ku edhe

ndërroi jetë brenda një kohe shumë të shkurtër.

Gazzali është një nga mendimtarët myslimanë, i cili i ka dhënë shumë vepra botës Islame. Tiflisi, mësuesi i Neveviut, tregon se sipas një përlogaritjeje të tij, i bie që Gazzali të ketë shkruar afro dyzet faqe në ditë. Muorice Bouyges mendon se Gazzali ka shkruar 404 vepra, ndërsa Bedeviu numëron 450 vepra të Gazzalit.

Veprat më të njohura të Gazzali janë:

Ihja' 'ulumuddin (Gjallërimi i shkencave Islame), Kimja-ji Sa'ade (Eliksiri i lumturisë), El-Munkidhu mine'd-Dalale (Qortues për rrugën e shtrembët), Mishkatu'l-envar (Feneri i ndriçuesve), Makasidu'l-felasife (Qëllimet e filozofëve), Tehafutu'l-felasife (Paradokset e filozofëve), etj.

GAZZALI DHE SHKENCA E KELAMIT

Në librin e tij El-Munkidhu mine'd-Dalale, Gazzali shpreh rezerva ndaj metodës së Kelamit dhe kelimistëve. Ai i shikon kelimistët si të pamjaftueshëm për të mbrojtur parimet Islame. Ndërsa metodën e diskutimit (*xhedel*) e vlerëson si qorrsoak për të arritur tek e vërteta. Gazzali ka përshtypjen se kelimistët, në momentin kur kanë dashur të kritikojnë mendimet e grupeve të devijuara, nuk kanë mundur të shpëtojnë nga ndikimi i mendimeve të kundërshtarëve. Një tjetër gabim i tyre, sipas Gazzalit, është se kelimistët dolën jashtë qëllimit të shkencës së Kelamit.

Pavarësisht disa detajeve, Gazzali mbetet në rrugën e Esh'arive. Me reformimin që ai i bëri shkencës së Kelamit, ai mundësoi fillimin e një tjetër periudhe të Kelamit: periudha e Kelamit të ri.

GAZZALI DHE FILOZOFIA

Kaotizmi mendimor dhe metoda skeptike e Gazzalit përbëjnë rëndësi të veçantë për Historinë e Filozofisë Islame. Kjo veçori përbën dallimin kryesor mes tij dhe mes kelamistëve e filozofëve të tjerë. Mënyra e tij skeptike ndahet në dy etapa: Etapa e lehtë e dyshimit dhe etapa e avancuar. Në etapën e parë bën pjesë kritika ndaj besimit imitues, ndaj atij besimi që krijohet nga imponimi familjar e më gjerë. Më pas, Gazzali zgjedh një dozë të rëndë dyshimi, gjë e cila përbën edhe etapën e dytë, atë të skepticizmit të tij. Kundërshtimi i të gjitha formave mendimore tradicionale, me qëllim arritjen tek e vërteta. Sipas tij, vetëm kjo teknikë mund ta çonte atë tek dituria e sigurtë (*ilmu'l-jakin*). Me një përjasje plotësisht filozofike, Gazzali kundërshton çdo dituri që fitohet nëpërmjet arsyes dhe shqisave, pasi nuk i vlerëson si të sigurta dhe bindëse dituritë që përftohen nëpërmjet tyre. Fjala vjen, syri jep informacion të gabuar kur e paraqet aq të vogël yllin në qiell, hijen si të palëvizshme, etj. Gjithashtu, dukja si e vërtetë e gjithçkaje që njeriu sheh në ëndërr, ia shton Gazzalit edhe më tepër pasigurinë ndaj arsyes, e bën edhe më konfuz.

Pas një sipërmarrje vetjake, duke lexuar për afro dy vite me radhë vepra filozofike, kryesisht të Farabi-ut, Ibn Sina-së dhe Ihvani Safa-së, Gazzali shkruan filli-

misht librin Mekasidu'l-Felasife dhe më pas Tehatu'l-Felasife. Me mendimet se gjithësia është e pafundme, Allahu di tërësitë dhe jo hollësitë dhe se ringjallja pas vdekjes do të jetë vetëm shpirtërore e jo trupore, sipas Gazzalit, filozofët kanë ranë në mohim (*kufër*). Sidoqoftë, Gazzali ka dhënë një kontribut të vyer në filozofi me karakterin e tij kritizer.


GAZZALI DHE MISTIKA ISLAME (TASAVVUFI)

Gjithë ajo errësirë që krijohet brenda Gazzalit gjatë kërkimit të dijes së vërtetë, sipas tij u ndriçua në momentin kur Allahu i dha dritë (*nur*) zemrës së tij. Sipas Gazzalit, e vërteta e padyshimtë, e cila nuk ka nevojë për argumente, madje as për fjalë, arrihet përmes *keshf*-it, që do të thotë, përmes asaj drite që ta dhuron Allahu.

Gazzali njihet si mendimtari-sufi i cili bashkoi ezoterizmin me ekzoterizmin, sheriatin me hakikatin. Me përpjekjet e tij restauruese, ai ka fituar simpatinë si të ezoteristëve, ashtu edhe të ekzoteristëve.

Referencat:

- Imam Gazzali, Arayislar Kitabı (*El-Munkidhu mine'd-Dalale*), përkth. turqisht Osman Güman, Shtëpia botuese İlke, Stmaboll 2008
- Imam Gazali, Filozofların Tutarsızlığı (*Tahatut el-felasife*), përkth. turqisht Bekir Sadak, Shtëpia botuese Ahsen, Stmaboll 2002
- İslam Ansiklopedisi, "Gazzali", Vol. 13, Türkiye Diyanet Vakfı, Stmaboll 1996
- H. Ziya Ülken, *İslam Felsefesi*, Shtëpia botuese Ülken, Bot. 6, Stmaboll 2004
- Necip Taylan, *İslam Felsefesi*, Shtëpia botuese Ensar, Bot. 4, Stmaboll 2000.



Një herë, teksa Gazzali kthehej nga Xhurxhani për në Tus, karvanit me të cilin po udhëtonte i dalin përpara disa hajdutë, të cilët plaçkisin çdo gjë. Gazzali u vihet mbrapa hajdutëve dhe u kërkon që t'ia kthenin të paktën shënimet e mësimëve, duke u thënë se në Xhurxhan shkonte vetëm për të marrë ato shënime. Kryetari i hajdutëve tallet me faktin që Gazzali, në vend që t'i fuste në kokë ato shënime, i mbante të shkruara në letër. Gazzali e merr këtë kritikë si një vërejtje nga Allahu dhe më vonë, pas tre viteve, i mëson përmendësh të gjithë shënimet.

Xhami në vilajetin e Janinës

Të dhënat në lidhje me objektet e kulteve janë marrë nga regjistrat protokollarë të vilajetit të Janinës. Të gjitha shënimet pa përjashtim në të cilat ceken këto objekte kulti kanë të bëjnë me ankesat e dërguara qendrës së meshihatit në lidhje me personelin fetar në këto zona ose kërkesa me natyrë ekonomike. Më poshtë po paraqesim të dhënat e nxjerra nga këta regjistra:

XHAMIA E VUSHTËS

Vushta ka qenë një kasaba që varej nga kazaja e Pogonit. Sipas dokumentit të datës kanuni I 1315 që gjendet në regjistrin protokollar Mehmet Shaqir efendi, naibi i mëparshëm i Kërkkilises rrugës tek kthehej për në Pogon kishte ndalur në Vushtë dhe kishte marrë 600 kurushë nga të ardhurat e ambarit të lënë vakëf, që gjendej poshtë mektebit të kasabasë. Ngaqë këto të ardhura i takonin kujdestarëve të xhamisë së Vushtës kërkohej nga qendra ta urdhëronte naibin ti kthente sa më parë ato para.

XHAMIA E SYLEJMAN PASHËS

Kjo xhami ndodhej në kasabanë e Beratit. Sylejman pasha rridhte nga familja e vrionëve. Në shkresën e datës temmuz 1324 dërgohet një ankesë në lidhje me myftinë e beratit Mehmet efendinë i cili një herë e një kohë kishte qenë kujdestari i kësaj xhamie, por për të mbuluar të ardhurat e vakfit të kësaj xhamie që i kishte kaluar në pronësi të tijën ai kishte zgjedhur si administrator një tjetër person.

XHAMIA E HAXHI MEHMET ABASIT

Kjo xhami gjendej në kasabanë e Delvinës. Nga burimet mësojmë se është ndërtuar në vitin 1872, por në lidhje me themeluesin e saj nuk ka të dhëna. Në shkresën e datës 29 Haziran 1326 kemi një ankesë në lidhje me myezinin e kësaj xhamije Mehmetin, se nuk paraqitej rregullisht në detyrën e tij si myezin.

XHAMIA E FSHATIT NIKOLIÇ (NIKOLIC)

Në regjistrin protokollar ky fshat shënohet nën varësinë e Ajdonatit (Paramithisë), por sipas vjetarit të Janinës ai varej nga Margariti dhe kishte 58 shtëpi me 383 banorë.

Në shkresën e datës kanuni sani 1314 shohim një ankesë në lidhje me hafiz Muhidin efendiun i cili akuzohet se ka shpërdoruar për arsye personale të ardhurat vjetore për meremetimin e xhamisë që kapin vlerën 80 lira turke.

XHAMIA E XHEDDI SINAN ÇAVUŞZADE MEHMED BEG

Kjo xhami ndodhej në tregun e kasabasë së Gjirokastrës. Në shkresën e datës kanuni evvel 1314 Ismail Haki i Hasan begut kërkonte të jepej gjykimi në lidhje me truallin vakëf të kësaj xhamie që gjendej në këtë treg dhe në lidhje me të cilën disa persona pretendonin kujdestarinë.

XHAMIA E SYLEJMAN BEUT

Në lidhje me themeluesin e saj Sylejman beun



nuk dimë gjë tjetër përveç se ka qenë nga Frashëri. Në një ankesë të banorit të këtij fshati të dërguar me telegraf qendrës shkruhet se Qazim beu nga fshati frashër e ka dëmtuar këtë xhami duke marrë prej saj gurët e vjetër rrethues dhe vjel për llogari personale të ardhurat e kësaj xhamie që mblihdeshin nga mulliri i fshatit.

XHAMIA E SALIH BEUT

Kjo xhami ndodhej në Përmet dhe kishte të ardhura vjetore deri në 8000 kurushë, por ato shpërdoroheshin nga kujdestari i xhamisë Mehmet aga shehu.

XHAMIA E FSHATIT GARDHIQ

Në vitin 1894 në këtë fshat kishte 156 shtëpi me 780 banorë. Xhamia ndodhej në lagjen Koçana të fshatit. Detyrën e hatipit e kryente Mehmet

efendiu. Pasi caktohej në detyrë imami ishte i detyruar ti paraqiste qendrës në Stamboll ilamin që jepte sherija nga e cila varej, në rastin tonë, sherija e Paramithisë në mënyrë që ai të caktohej zyrtarisht.

XHAMIA E FSHATIT ISMARTO

Fshati Ismarto varej nga kazaja e Filatit. Në shkresën e datës 14 Haziran 1328 thuhet se në detyrën e imamit këtu është caktuar Shuajb efendiu i biri i Ibrahim agait.

XHAMIA E FSHATIT GOLEM

Në një shkresë lexojmë ankesën në lidhje me sheh Fevriun, imamin e xhamisë dhe mësuesin e mejtepit se nuk është duke i mësuar fëmijët si duhet.



Gruaja në Islam të drejtat dhe përgjegjësitë e saj

Në kohët e sotme njerëzit mendojnë se gratë u bënë të lira vetëm në perëndim, dhe se lirimi i grave si lëvizje shoqërore filloi në shekullin e XX.

Në të vërtetë kjo lëvizje për lirimin e gruas nuk është filluar nga gratë, por u shpall nga Zoti përmes të Dërguarit të Tij – Muhammedit a.s, që në shekullin VII.

Kur’ani dhe tradita e Profetit a.s, janë burime në të cilat çdo grua muslimane gjen të drejtat dhe detyrat e saj.

TE DREJTAT NJERËZORE: Katërmbëdhjetë shekuj më parë, Islami e bëri gruan njëllë përgjegjëse para Zotit në madhërim dhe adhurim për Të, duke mos vendosur asnjë kufizim në progresin e saj moral. Gjithashtu, Islami vendosi ba-

razinë e gruas në humanitetin e saj me burrat. Në Kur’an, në ajetin e parë të sures En-nisa, Allahu thotë: **O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej nje veteje dhe nga ajo krijoi palën e saj, e prej atyre u shtuan shume burra e gra. Dhe kini frikë Allahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisën, se Allahu është mbikqyrës mbi ju.** (4:1)

Duke qenë se burrat dhe gratë u krijuan nga e njëjta esencë, ata janë të barabartë në humanitetin e tyre. Në mënyrë të ngjashme, asnjë gjini nuk mund të jetë superiore, sepse do të ishte në kontradiktë me barazinë mes tyre.

TE DREJTAT CIVILE: Në Islam gruaja gëzon të drejtën bazë të zgjedhjes dhe të shprehjes, që ba-

zohet në njohjen e personalitetit të saj individual. Së pari ajo është e lirë të zgjedhë fenë e saj.

Ne Kur'an thuhet: **Ne fe nuk ka dhunë. Eshte sqaruar e verteta nga e kota.** (2:256)

Gratë inkurajohen në Islam që të kontribuojnë me opinionet dhe idetë e tyre. Në kohën e Profetit a.s, gratë kanë dhënë opinionet e veta në lidhje me fenë, ekonominë dhe çështjet shoqërore.

Gruaja muslimane ka të drejtë të vendosë për bashkëshortin e saj, ajo mund ta mbajë mbiemrin e saj nëse dëshiron. Dëshmia e gruas është e vlefshme në çështjet ligjore.

TË DREJTAT SOCIALE: I Dërguari i Allahut a.s ka thënë: *Kërkimi i diturisë është detyrë për çdo musliman (burrë dhe grua).* Kjo përfshin diturinë fetare, si dhe dituri të tjera. Si burrat ashtu edhe gratë, kanë kapacitet për të mësuar dhe kuptuar gjërat. Po ashtu, meqenëse gratë e kanë për detyrë të përkrahin sjelljet e mira dhe të dënojnë ato të këqijat në të gjitha fushat e jetës, gruaja muslimane duhet të marrë edukimin e përshtatshëm për të kryer këtë detyrë në përputhje me talentin e saj. Mirëmbajtja e shtëpisë, mbështetja e burrit, si dhe rritja e mësimi i fëmijëve, janë ndër rolet

më të rëndësishme dhe me shpërblim të madh te Zoti. Nëse ajo ka mundësi, mund të punojë jashtë shtëpisë për të mirën e komunitetit, përsa kohë i realizon detyrat e saj në familje.

Profeti a.s ka thënë: *"Xhenneti është nën këmbët e nënës"*. Kjo nënkupton se suksesi i një shoqërie mund të kërkohet tek nënat që e rriten atë shoqëri. Influenca e parë dhe më e madhe mbi një person vjen nga ndjenja e sigurisë, dashurisë dhe mësimi që merr nga nëna. Prandaj, një grua e mirë që ka fëmijë, duhet të jetë e arsimuar dhe e ndërgjegjshme për të qenë një prind i mirë.

TE DREJTAT POLITIKE: E drejta për të votuar i është dhënë grave muslimane nga Zoti që para 1400 vjetesh. Per çdo çështje publike, një grua mund të shprehë mendimet e saj dhe mund të marrë pjesë në politikë. Në një rast, në Kur'an i thuhet Profetit a.s se kur gratë besimtare të vijnë tek ai dhe te japin betimin e tyre për Islamin, ai duhet ta pranojë atë. Kjo vendosi të drejtën e grave për të zgjedhur udhëheqësit e tyre dhe ta deklarojnë këtë në publik. Islami nuk e ndalon një grua për të pasur pozitë të rëndësishme në qeverisje.

TË DREJTAT EKONOMIKE: Cdo anëtar ka detyra të ndryshme. Në përgjithësi Islami i jep gruas





rolin përkujdesës, dhe burrit rolin e kujdestarit. Prandaj gruas i është dhënë e drejta e mbështetjes financiare tek burri. Përgjegjësia për mbrojtje, kujdestaria dhe përgjegjësia financiare i është dhënë burrit, çka do të thotë se burrat duhet t'u sigurojnë grave jo vetëm mbështetjen financiare, por edhe mbrojtjen fizike, si dhe të sillen mirë e me respekt ndaj tyre. Gruaja muslimane ka të drejtë të fitojë para, të ketë pasuri, të hyjë në kontratë ligjore dhe t'i menaxhojë gjithë pasuritë e saj ashtu siç dëshiron. Ajo mund të ketë biznes të vetin, dhe askush nuk ka të drejtë mbi të ardhurat e saj, përfshi këtu edhe burrin. Në Kur'an thuhet: "Mos lakmoni në atë që Allahu gradoi disa nga ju mbi disa të tjerë.

Burrave u takon hise nga ajo që fituan ata dhe grave u takon hise nga ajo që fituan ato. Allahut kërkojini nga të mirat e Tij. Allahu është i dijshtëm për çdo send."

TË DREJTAT E GRUAS: Në Kur'an thuhet :
"Dhe nga faktet e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj gratë, ashtu që të gjeni prehje te ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit. (30:21)

Prandaj martesë nuk është vetëm një nevojë fizike dhe emocionale, por në të vërtetë një shenjë nga Zoti. Është një marrëdhënie e të drejtave dhe e detyrimeve të ndërsjellta, që bazohet në një udhëzim të shenjtë. Zoti krijoi burrat dhe gratë që të plotësojnë njëri-tjetrin, dhe në Kur'an Allahu zbriti një sistem ligjesh që mbështesin bashkëveprimin harmonik mes dy gjinive. "...ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato..." (2:187)

Për të ushqyer dashurinë dhe sigurinë që vjen me martesën, gratë muslimane kanë një sërë të drejtash. E drejta e parë e gruas është ndaj meherit, dhurata nga burri, e cila është pjesë e kontratës së martesës dhe kërkohet që martesë të ligjërohet. E drejta e dytë e gruas është mirëmbajtja. Edhe në qofte se ajo mund të ketë pasurinë e vet, burri i saj e ka për detyrë ta sigurojë atë me ushqim shtëpi dhe veshmbathje. Por ai nuk detyrohet ta bëjë këtë përtej mundësive të tij dhe gruaja e tij nuk ka të drejtë të kërkojë gjëra që nuk janë të arsyeshme.

DETYRAT E GRUAS: Gruaja duhet të ruajë sekretet e burrit të saj dhe të mbrojë jetën private martesore. Çështjet që janë private, ose gabimet e burrit, të cilat mund ta çnderojnë atë, nuk duhet të ndahen me të tjerët, ashtu sikundër burri pritët të mbrojë nderin e së shoqes. Po ashtu, gruaja duhet të kujdeset për mbrojtjen e pasurisë së burrit të saj. Ajo duhet të ruajë shtëpinë dhe pasurinë e tij me sa mundet, që të mos vidhet apo të mos dëmtohet. Ajo duhet të menaxhojë punët e shtëpisë me kujdes. Gjithashtu, ajo nuk duhet të lejojë në shtëpi asnjë njeri të cilin burri i saj nuk e pëlqen, apo të bëjë shpenzime të cilat burri i saj nuk i miraton. Gruaja muslimane duhet të bashkëpunojë dhe koordinojë punët me burrin.

Këshillat e një nëne për bijën e saj

Këshillat që mund t'i jepen rinisë, e cila do të krijojë fole në saj tashmë larg familjes në të cilën është rritur, përbëjnë ndoshta themelet kryesore të një familjeje të lumtur. Edhe neve na duhet t'ua përcjellim këshillat më të vlefshme islame këtyre të rinjve, këshilla të cilat na janë trashëguar nga paraardhësit tanë.

Ejani të gjithë së bashku, që të depërtojmë në thellësitë e historisë dhe të dëgjojmë me ëndje këshillat të cilat një nënë ia drejton vajzës së saj, këshillat e një nëne që të imponon aq shumë mirënjohje e respekt, sa meriton t'ia puthësh duart.

Kur do të martonte vajzën e saj Unasën, Umame bint-i Harith e kishte këshilluar atë:

“Bija ime! Nëse këshillat do ishin të tepërta për një njeri me edukatë dhe moral të lartë, atëherë unë s'do kisha fare nevojë të të këshilloja ty. Por ta dish që këshillë do të thotë ta bësh të rikujtojë njeriun që di, dhe ta mësosh njeriun që s'di. Prandaj, këshilla është e dobishme për gjithkënd.

Bija ime! Nëse një vajzë nuk do ishte nevojtare për bashkëshortin e saj nga pasuria e trashëguar nga prindërit, atëherë ti do ishe e privilegjuar më shumë se askush tjetër. Por ta dish se, ashtu sikur ndër burrat janë krijuar për ne, edhe në jemi krijuar për burrat.

Bija ime! Tani ti po largohesh nga një fole ku je lindur dhe ke mësuar të ecësh, për të shkuar drejt një foleje tjetër që nuk e njeh aspak.

Atëherë mësohu t'i shërbesh atij si një robëreshë, në mënyrë që edhe ai të të bëhet shërbëtor, të të dojë dhe të mundohet të bëjë gjithçka për ty.

Tani do të të them 10 këshilla. Mësoji mirë dhe zbatoji në jetën tënde, në mënyrë që të kalosh një jetë të lumtur.

1. Duhet të pranosh me shpirt çdo të mirë që ai të sjell në shtëpi.

2. Duhet të mësohesh t'ia dëgjosh fjalën.

3. Ta mbash të pastër veten dhe shtëpinë.

4. Të largohesh nga gjërat e shëmtuara apo nga gjërat që nuk kanë erë të këndëshme, në mënyrë që të mos neveritësh veten.

5. Të ndjekësh me kujdes kohët kur bashkëshorti yt fle, apo kur ushqehet. Nëse ai ka një rregjim të tijin, duhet të mundohesh ta respektosh atë, sepse uria e nxit për keq njeriun, ndërsa pagjumësia e nervozon.

6. Duhet ta ruash pasurinë e bashkëshortit nga humbja apo nga dëmtimi.

7. Duhe ta ruash personalitetin e bashkëshortit dhe t'i respektosh të afërmit e tij.

8. Nuk duhet t'i dalësh kundër në asnjë rast.

9. Nuk duhet të nxjerrësh në shesh të fshehtat e familjes tënde. Nëse kundërshton fjalën e tij, krijon pakënaqësi, nëse tregon të fshehtat e familjes, nuk mund të shpëtosh nga ashpërsia e tij.

10. Bija ime! Të kesh kujdes që, kur bashkëshorti yt të jetë i mërzitur, të mos rrish e lumtur dhe e qetë pranë tij, dhe kur ai të jetë i gëzuar, të mos rrish e vrenjtur pranë tij.





Fëmijë të zgjuar? Evitoni ëmbëlsirat në shtatzani



FINLANDE- Fëmijët e lindur nga gratë që gjatë shtatzënisë nuk kanë qenë në gjendje t'i rezistojnë tundimit për të ngrënë ëmbëlsira dhe karamelle në sasi të mëdha, mund të paraqesin në shkollë një koeficient inteligjence nën mesataren.

Ky është rezultati i një studimi të kryer nga Universiteti i Helsinkit e Universiteti i Edinburgu, dhe pu-

blikuar në "Amerikan Journal of Epidemiology", i cili shqyrtoi 321 fëmijë tetëvjeçarë të lindur në Finlandë, ku konsumi i jamballit, ëmbëlsirave të nënat e tyre ishte e ndryshme.

Kjo tregoi se femrat të cilat gjatë shtatzënisë kanë marrë një sasi të konsiderueshme të glicerines (një substancë që gjendet tek ëmbëlsirat) kishin më shumë gjasa të lindnin fëmijë me deficite intelektuale. Studiuesit kanë evidentuar në disa fëmijë edhe parregullsi të tilla si ulja e përqendrimit, vëmendjes.

Përgjegjësia është e gjitha e kësaj substance, pikërisht glicerines, e cila vepron në placentë modifikuar atë në mënyrë që hormonet e stresit të nënës mund të kalojnë dhe të fëmija duke ndikuar negativisht në zhvillimin e tij.

Konsumi i tepruar i jamballit, mund të rrisë edhe rrezikun e lindjes para kohe.

Studimi:

Për lindje pa dhimbje hani shegë



LONDER-Shega është fryt i cili përveçse vlerave shëndetësore që mban, paska edhe vetinë e lehtësimit të dhimbjeve të kontraktiveve të mitrës tek një grua gjatë procesit të lindjes së një fëmije. Një fakt i tillë pohohet në një studim të fundit sipas të cilit, nga farat e shegës fitohet një lehtësim i lëvizjeve të muskujve të butë të mitrës.

"Një studim i mëparshëm sugjeroi se antioksidantët dhe vetitë nxitëse të shegës, duket se kanë një ndikim pozitiv mbi shëndetin. Por ne kemi kërkuar të kup-

tojnë edhe efektet e saj mbi kontraktimet e mitrës për të na ndihmuar eksplorimin e rrugëve të reja për trajtimin e grave me probleme gjatë lindjes natyrale", tha lidhur me një fakt të tillë profesor Sue Uray, i cili ka ndërmarrë studimin e lartpërmendur.

Sipas tij, grupi i studiuesve ka faktuar se beta-sitosterol është komponenti kryesor i ekstraktit të shegës dhe se qelizat e muskujve të mitrës kanë rritur aktivitetin e tyre pas kontaktit me të tilla substanca.

Mrekullia me 3 vjecaren, i zhduket menjëherë tumori në tru

LONDER-Një mrekulli është shënuar me një vajzë të vogël 3 vjecare në Britani. Kur Liberti Rose nuk mund të merrte më kimioterapi për shkak të fizikut dhe moshës së vogël, dhe prindërit po vuanin frikën më të madhe se sëmundja do përparonte, ndodh një mrekulli, tumori në tru shërohet dhe asnjë shenjë e tij nuk vihet më re në tru.

Vogëlushja prej tumorit kishte humbur dhe shikimin ndërsa zhvillimi i saj mendor sa vinte e zvogëlohej në vend që të përparonte me rritjen e trupit.

Por, skaneri tregoi se masa tumoriale në tru ishte zhdukur, vajza ka rifituar gati plotësisht shikimin dhe po e merr veten përditë mrekullisht.

Liberti ka dhe një motër binjake dhe kanë lindur shëndoshë e mirë në dhjetor të vitit 2006.

Por, 6 javë më pas prindërit e saj Karl dhe Daun vunë re së vajzës i iknin sytë mbrapsht here pas here dhe i rrotulloheshin në mënyrë të çuditshme.

Një mjek diagnostikoi me Nistagmus, një lëvizje e pavullnetshme e syve.

Por analizat e mëtejshme treguan se vajza vuante nga një sëmundje tumoriale që kishte prekur rrethuar nervat në trurin e vogël të Liberti.

Në Tetor të vitit 2007 kur vajza mbushi rreth 8 muajsh, nisi kimioterapia dhe një koktejl me drogëra që iu rekomanduan vajzës nga Spitali Onkologjik i Pediatriisë.

Por, kur programi me kimioterapinë përfundoi vajza ishte po aq sëmurë.

Vajza po rrezikonte jo vetëm shikimin, por jetën nëse tu-



mori vazhdonte të rritej sërisht.

Dhe prindërit të shqetësuar shkuan javën e kaluar në spital dhe pas një skanimi që iu bë vajzës u vërejt se tumori ishte zhdukur plotësisht, dhe shkak sipas mjekëve është bërë por, një kombinim i 'regresionit spontan dhe pas-efektet e trajtimit.

Mjekët thonë se vajza ka qënë me shumë fat dhe ka reaguar pozitivisht ndaj këtij lloj tumori, pasi kimioterapia nuk funksionon plotësisht në rastet e tumoreve që kapin trurin.

Asnjë rrezik për sigurinë në Kosovë

Për sa i përket ndërtimit të bazës ushtarake ruse në Serbi, komandanti i forcave amerikane në kuadër të KFOR-it, gjenerali Alham Dohrman, shprehet se nuk ka informacionet e duhura. Por sipas tij nuk ka ndonjë rrezik nga jashtë për Kosovën.

“Nuk shohë ndonjë rrezik dhe përkeqësim të situatës së sigurisë në Kosovë. Sa i përket ndërtimit të bazës ushtarake ruse nuk kam shumë informacion dhe nuk dua të spekuloj lidhur me këtë sepse pas informacioneve që kam dëgjuar në media nuk di diçka më shumë lidhur me këtë”, tha Dohrman.

“Një herë në muaj ne bëjmë ushtrime pa paralajmërim dhe me këtë e bëjmë testimin e aftësive të ushtareve tonë. Me këtë në vazhdojmë të dëshmojmë se jemi të gatshëm të ndërhyjmë nëse ka nevojë në çdo kohë dhe kudo”- tha gjenerali amerikan Alhan Dohrman.



Emigrantët, parlamenti grek kthehet në arenë përplasjesh



Papandreu: “Me integrimin e plotë të emigrantëve i jepet fund një politike shqetësuese 28-vjeçare”

Si të mos mjaftonte gjendja e rëndë ekonomike, për politikën greke lind një tjetër shqetësim. Pas dërgimit në Parlament të projektligjit për dhënien e nënshtetësisë për emigrantët kanë reaguuar ashpër udhëheqësit e partive parlamentare. Për më tepër se katër orë e gjysmë institucioni ligjvënës është shndërruar në një arenë debatesh të ashpra. Kryeministri Jorgos Papandreu shprehu pakënaqësinë rreth situatës së krijuar, duke u shprehur se të gjithë emigrantëve duket t’u jepet e drejta të bëhen shtetas me të drejta të plota, pasi nëse nuk lind grek, mund të bëhesh. “Për ne përgjigja është e qartë: Grek edhe lindesh edhe bëhesh, ashtu siç ka ndodhur vazhdimisht në historinë e helenizmit. Edhe unë kam qenë emigrant, megjithëse

nuk përjetova këto gjendje turpi dhe trafikimi të njerëzve, ashtu siç ndodh në kufijtë tanë”, u shpreh kryeministri Papandreu. Më tej ai theksoi se me projektligjin e propozuar i jepet fund një problemi që ekziston në shoqërinë greke prej 28 vjetësh. “Përfundojmë një problem që shfaqet për më se 28 vjet dhe që ka shqetësuar shoqërinë tonë, integrojmë në këtë shoqëri ata që duan të hyjnë në të, duke shmangur izolimin e tyre, ksenofobinë, idetë se po rrëzohet kombi” ka theksuar Papandreu. Mendim krejt të kundërt kanë shprehur sërish ultranacionalistët grekë, të cilët kanë kërkuar shpalljen e një referendumi popullor për aprovimin e këtij projektligji, ndërsa udhëheqësi i tyre Jorgos Karatzaferis është shprehur përsëri hapur kundër dhënies së nënshtetësisë së emigrantëve shqiptarë. “Po thoni pra që t’i bëjmë shtetas grekë. Jo z.Kryeminister! Dhe gjithsesi, jepuni nënshtetësinë pakistanezëve dhe afganëve që doni. Shqiptarëve dhe ballkanasve të tjerë për-

se doni t’ua jepni? Për 4-5 vjet ata do të jenë në Europë, do të kenë pasaportë europiane, pse duhet t’i bëjmë grekë?”, thotë Karatzaferis. Edhe udhëheqësi i Demokracisë se Re është shprehur se dhënia e nënshtetësisë greke rreth 500.000 emigrantëve të huaj do të krijojë kushte të një revolte shoqërore dhe një ksenofobie të paparë, ndërsa ka premtuar se kur të vijë në pushtet partia e tij do ta anulojë ligjin. “Dhënia e nënshtetësisë automatikisht shndërrohet në një magnet të vërtetë për një valë masive legalizimi prej mijëra emigrantësh të rinj ilegalë. Dhe këtë temë ne nuk e duam”, thotë Andonis Samaras kryetar i Demokracia e Re. Me gjithë përpjekjen pozitive të socialistëve, opinioni publik është i ndarë përsa i përket këtij projektligji, ashtu siç përshkruajnë edhe sondazhet e shumta, ku mbizotëron një pasiguri për humbjen në të ardhmen e identitetit etnik, një tezë që e theksojnë çdo ditë e më shumë ultranacionalistët dhe jo vetëm.

Kina reagon ashpër ndaj SHBA-ve për tregtinë

Kina i ka hedhur poshtë kërcënimet nga presidenti amerikan Barak Obama se do të ndërmarë një linjë të ashpër për të siguruar që tregu kinez është i hapur për eksportet amerikane. Një zëdhënës i Ministrisë së Jashtme në Pekin, Ma Zhaoxu, i hodhi poshtë akuzat e zotit Obama që niveli i

kursit të këmbimit me monedhat e huaja jepte një avantazh jo të drejtë ndaj dollarit. Ditën e mërkurë zoti Obama tha se do të vendoste një presion të vazhdueshëm mbi Kinën dhe vendet e tjera që të respektonin anën e tyre të marrëveshjeve tregtare. Pekini iu kundërpërgjigj Uashingtonit duke thënë se akuza me të padrejtë dhe presioni nuk mund ta zgjidhnin problemin. Sektorët ku ka pakënaqësi përshijnë monedhën kineze dhe shitjen e armëve Tajvanit. Përsa i takon monedhës kineze, Ministria e Jashtme kineze këmbënguli që juani, ishte i vlerësuar në nivelin e duhur me gjithë akuzat amerikane se është e kundërta. Zëdhënësi përsëriti kërcënimin e Pekinit për të vendosur sanksione të paspecifikuara mbi firmat amerikane që i shesin armë Tajvanit. Ky është një kërcënim që ka disa ditë që është bërë. Ky është shqetësim në mënyrë të veçantë për kompaninë amerikane Boeing, që i shet armë Tajvanit, dhe për të cilën Kina është tregu më i madh ndërkombëtar. Presidenti Obama foli për presion ndaj Kinës për marrëveshjet. Uashingtoni thotë se kjo ndodh pjesërisht, sepse Kina e ka mbajtur në mënyrë artificiale të dobët monedhën e saj, duke i bërë produktet e saj më të lira jashtë vendit.





Disa shkencëtarë arrijnë t'ua ndryshojnë aromën luleve

Tashmë është bërë e mundur t'i jepet një luleje aroma që nuk e ka, ose të bëhet më e ëmbël aroma e saj, duke manipuluar gjenet, njoftuan sot disa shkencëtarë amerikanë.

Një ekip shkencëtarësh të institutit të Ushqimeve dhe shkencave bujqësore të Universitetit të Floridës zbuluan gjenet e esencave kimike që përcaktojnë aromën e një luleje, duke hapur kështu rrugë të reja për "ndryshimin" ose "forcimin" e përbërësve të një arome.

"Për shumë kohë, kultivuesit janë përqendruar në pamjen e lules, madhësinë, ngjyrën dhe kohëzgjatjen e lulëzimit të saj, por aroma është lënë mënjanë", deklaroi David Clark, profesor i hortikulturës (shën i përkth. degë e bujqësisë që

përfshin kulturën e perimeve, luleve, pemëve dhe shkurreve dekorative) në universitetin e Floridës.

Në të ardhmen, mund të zgjedhim mes një shumëllojshmërie aromash ose edhe të rrisim lule pa aromë, shpjeguan shkencëtarët.

Clark dhe shkencëtarë të tjerë analizuan për më tepër se 10 vjet gjenet e ... ^ luleve petunia gjë që u bëri të mundur të zbulonin se gjeni i aromës së vajit të trëndafilit është i njëjti që i jep shijen e këndshme domates.

Duke manipuluar këtë gjen, shkencëtarët kanë arritur të krijojnë domate me një shije më të mirë, si dhe trëndafila me një aromë më të qëndrueshme.

Rusët testojnë avionin që i shpëton radarëve

MOSKE- Rusia ka testuar një avion Sukoi T50, mjaft modern, që është i pakapshëm dhe i padukshëm nga radarët. Avioni është gjithashtu i përshtatshëm për të fluturuar në gjithë kushtet e motit. Forcat ajrore ruse shpresojnë që ta kenë në përdorim këtë avion në vitin 2015. Avioni është prodhuar në partneritet me Indinë dhe konsiderohet një arritje e madhe për të modernizuar ushtrinë e erës sovjetike.

Drejtori i avionëve Sukoi, Mikhail Pogosjan tha

se ai është i bindur se projekti lë pas rivalët përrëndimorë përse i përket efektivitetit dhe kostos së prodhimit të këtij tipi avioni dhe nga ana tjetër forcon mbrojtjen e forcave ajrore dhe indiane. Avioni i ri luftarak, mund të kryejë sulme ajrore dhe tokësore. Rusia po përpiqet së fundi të investojë shumë në ushtrinë e saj të cilën e ka ende në gjendjen e luftës së ftohtë. Gara e armatimeve vazhdon, pavarësisht se SHBA dhe Rusia janë në prag të nënshkrimit të marrëveshjes së re për reduktimin e armëve strategjike.